

Revistë edukative-kulturore

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den
Europa: 2 Euro

Janar 2010 • Numri: 22 • E përmuajshme



RRUGËTIMI I HESHTUR I KOHËS

EDITORIAL

Të dashur lexues.

Të dy së bashku të ndajmë kënaqësinë që këtë vit revista Etika të bëhet e përmuajshme. Kjo u arrit falë interesimit të gjerë që revista Etika ka gjetur tek lexuesit tanë në trevat shqiptare në Ballkan, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, por edhe në shtete të ndryshme të Evropës sin ë Gjermani dhe në Zvicër.

Ishte mbështetja juaj që na dha kurajën dhe forcën që stafi i revistës të shtonte angazhimin e tij në mënyrë që ne të mund të takohemi dhe të bashkëbisedojmë me njëri-tjetrin që sot e tutje nga një herë në muaj.

Ky numër ka në qendër të analizës së tij kohën që rrjedh herë pa zhurmë, herë me rrapëllimë marramendëse, por në të dy rastet duke lënë pas njeriun që numëron momentet e fundit të jetës që mund t'i kenë mbetur.

Në pikëpamjen e fesë dhe të punës, koha e lirë është një mirësi që humbet dhe është e vështirë të rigjehet. Sidomos në qytetet e mëdha, ku jeta është e zhurmshme, e shpejtë, e përfshirë në lëvizje të paretur dhe e lodhshme, njerëzit ia dijnë shumë më mirë vlerën kohës së lirë. Njeriu i këtij shekulli, i cili ditën e kalon duke ngarendur ndërsa natën e përqendron vëmendjen te televizioni, ka shumë nevojë ta shfrytëzojë kohën e lirë për zhvillimin e tij shpirtëror.

Koha përmban të gjitha gjërat e çuditshme dhe të mahnitshme, prandaj ajo është quajtur “babai i çudisë”. Çdo situatë e ngjarje e përgjithshme ose e përveçme, e njohur ose panjohur, e hidhur ose e ëmbël, ndodh pikërisht në të. Shtetet, popujt, të mirat, fatkeqësitë shfaqen në kohë, rriten në të dhe pikërisht aty shuhet dhe mbesin. Koha është “gjëja më e çuditshe ndër të gjitha gjërat e çuditshme”. Ajo është parametri i ndryshimit që lëvizë dhe ecën pa u ndalur, si kontekst i çdo gjëje, por që në të njëjtën kohë është edhe një proces qëndrimi dhe konstanteje.

Sa më shumë që kalon koha, aq më tepër njeriu i afrohet humbjes, nëse nuk plotëson katër kushte që kanë të bëjnë me përsosjen e tij personale dhe përsosjen e të tjerëve: besimi tek Allahu dhe te gjithçka që Ai ka urdhëruar të besohet; kryerja e veprave të mira, qofshin këto fizike apo shpirtërore; këshillimi i të tjerëve me këtë të vërtetë dhe këshillimi që të durojnë në përpjekjen e tyre për t’iu përmbajtur urdhërave të Allahut dhe për të duruar sprovat e dhembshme dhe të vështira që mund të ketë përcaktuar Ai.

Në këtë numër nuk do të mungojnë edhe këndet e revistës aq të kërkuara prej jush.

Ju urojmë lexim të këndshëm.

Do të lexoni:



- Xhafer Durmush / 4** Pse Zoti betohet në kohën?
Gençer Dervari / 6 Marrëdhënia kohë-adhurime në jetën fetare islame!
Hamdi Nuhiju / 8 Mos e shani kohën!
Nesrin Kaja / 10 Ç'mund të bëni në një orë?
Fatjon Hamzi / 14 Rëndësia e kohës në islam
Zymer Ramadani / 16 Njeriu përballë kohës dhe vetvetes
Abdulkadër Durguti / 20 Begatitë e kohës
Sejfetin Ismaili / 22 Kujdesi gjatë faljes së namazit!
Naim Drijaj / 26 Vlerësimi i kohës në traditën islame
Hivzi Zeqiri / 29 Loti që nuk u pa
30 Një Ajet

Hamdi Nuhiju /
Mos e shani kohën!

8




Zymer Ramadani /
Njeriu përballë kohës dhe vetvetes

16



Naim Drijaj /
Vlerësimi i kohës në traditën islame

26



Viti: V | Numri: 22 | Janar 2010

Administrator i Progresi botime:

Shuajip Bashhan

bashan43@hotmail.com

+355 69 20 76768

Drejtor i revistës:

Ermal Nurja

ottoman-script@hotmail.com

+355 67 20 86767

Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 69 24 23989

Përkthyesit:

Arjan Ymeri

Evans Drishti

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

Redaktor:

Shpëtim Kelmendi

Dizajn - Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

Janar 2010

32

Osman Nuri Topbash /
Shpërdorimi i kohës



41

Adelina Muça /
Hixhabi



42

Dhurata Kazazi /
Menaxhimi i stresit



31 Një Hadith

Osman Nuri Topbash /32

Shpërdorimi i kohës

Mr. sci. Flamur Sofju /38

Qëndrimi i shariatit islam
ndaj klonimit të njeriut

Adelina Muça /41

Hixhabi

Dhurata Kazazi /42

Menaxhimi i stresit

Evans Drishti /46

Faleminderit profesor!

Mag. Ermal Nurja /48

Myftijtë dhe myderizët e
vilajetit të Janinës sipas
regjistrimit protokollor
Janinë-Meshihat i Stambollit

Familja /52

Cilat janë gabimet më të më-
dha të prindërve?

Shëndeti / 54

Kuroni diabetin
duke rregulluar gjumin

Teknologji / 56

Shpikjet më të mëdha
të vitit 2009

Aktualitet / 58

Presidenti turk Abdullah Gyl
viziton Shqipërinë

PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 534
Fax: +355 22 254 533

Zyra e përfaqësimit Maqedoni


Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë
Abonim (një vjetor) : 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN
Abonim (një vjetor): 600 DEN
Europë: 2 Euro
Abonim (një vjetor): 24 Euro



Pse Zoti betohet në kohën?

Xhafer Durmush

Në Kuran Zoti betohet për kohën e mëngjesit, për ditën, natën si dhe për diellin dhe hënën si tregues të saj. Kërkohet që njeriu të jetë i vetëdijshëm për ta shfrytëzuar me kujdes kohën që rrjedh si uji. Ndërsa në suren Asr thuhet:

“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.” (Asr, 1-3)

Fjala Asr do të thotë të burgosësh, të pengosh dhe të shtrydhësh për të nxjerrë ujin. Ndërsa si emër do të thotë kohë e plotë, koha e iqindisë, koha në të cilën jemi dhe koha e njëqind viteve.

Duke u betuar në kohën, Allahu i Lartmadhëruar tregon se njeriu është padyshim në humbje, me përjashtim të atyre që do t’i dalin përkrah këtyre katër gjërave. Tani të përpiqemi t’u japim përgjigje këtyre

pyetjeve: pse bëhet ky betim në kohën dhe pse thuhet me këtë betim njeriu është në humbje. Sipas tefsirit, kur Zoti betohet në diçka, kjo nuk përbën një fakt të madhështisë së Tij, por është një tregues i vlerës së asaj që Ai betohet.

Pse theksohet atëherë se njeriu është në humbje, me përjashtim të rasteve të veçanta?

Lidhur me përgjigjen e kësaj pyetjeje, mund të mendojmë kështu: Njeriu është një qenie konsumatore për sa kohë që jeton. Nga njëra anë merret me sigurimin dhe shpenzimin e nevojave dhe e kërkesave materiale që mund të merren të reja, ndërsa nga ana tjetër jeta ikën me të shpejtë. E vërteta është se ndërkohë që pandeh se po rritet, shkon drejt exhelit, dhe ndërkohë që pandeh se po shtohet e pasurohet, konsumon jetën.

Një gjë është e sigurt: koha nuk i ngjan gjërave të tjera që njeriu konsumon në jetë. Kjo sepse koha e

harxhuar nuk mund të rimerret asnjëherë, nuk mund të blihet, nuk mund të ndryshohet dhe as të merret hua. Nisur nga kjo, njeriu konsumon vazhdimisht një thesar vlera e të cilit është e panjohur për të. Elmalli Hamdi thekson: Nëse nuk është fituar një e mirë pas atij që shkoi, ajo mangësi është një humbje.

Ja pra, kjo është edhe e vërteta që na shpalos kjo sure, e cila pothuajse i thotë njeriut: “Nëse nuk je i vetëdijshëm kur përdor pasurinë e jetës, je në një humbje të plotë.” Rrugëzgjdhjen për të shpëtuar nga kjo humbje e përmend në këshillat për besim, vepra të mira, drejtësi dhe durim.

Fakti që besimi përmendet në krye të kësaj rruge, është kuptimplotë për ne. Kjo do të thotë se pa qenë besimi nuk do të kenë asnjë dobi për individin mirësitë e shfaqura. Për shpëtimin nga humbja është e nevojshme që fillimisht të pranohen pa mëdyshje bazat e besimit Islam.

Së dyti vijnë veprat e mira, punët e mira dhe me vlerë... çështja e parë që tërheq vëmendjen këtu duhet të jetë kuptimi gjithëpërfshirës i “punës”. Kjo sepse vepra nuk është emri i një adhurimi të posaçëm. Ajo do të thotë veprim i bërë në kuptimin më të gjerë të tij. Atëherë çdo punë e myslimanit duhet të jetë aq e qartë, sa të arrihet të bëhet dallimi mes së dobishmes dhe së mirës. Çdo punë, çdo fjalë dhe çdo mendim duhet të jetë stolitur mirë. Asnjëri prej nesh nuk duhet të ketë anë të turpshme. Të gjitha duhet të jenë në atë formë që të mund të dalim faqebardhë. Duhet të jetë filtruar nga besimi dhe mendja, për të dalë e qartë para Allahut... Ne besojmë se ajo që kërkohet i përfshin të gjitha këto.

Në rendin e tretë është këshillimi për tek Zoti. Mund të shprehemi në këtë mënyrë: atij që beson dhe bën vepra të mira, do t’i njihet edhe e drejta e fjalës. Por nuk do mjaftohet me kaq dhe do të këshillojë të drejtën. Kudo që të ndodhet, do bëhet komentues i realitetit. Do të përpiqet që e vërteta të gjejë prehje. Në këtë mënyrë do përpiqet të dallojë të drejtën nga e shtrembëta.

Së katërti është këshillimi për durim. Edhe atë njeriu do ta përqafojë fillimisht tek vetvetja, siç thotë Elmalli Hamdi: “Fillimisht do ta mësojë veten që të jetë i kujdesshëm në bindje, duke shfaqur durim ndaj çdo dhimbjeje, si dhe të ketë kujdes nga haramet duke duruar çdo lloj kënaqësie epshore.” Më pas, këtë disiplinë do t’ua këshillojë njerëzve të tjerë.

“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”



Në lidhje me dy të fundit, mund të shtojmë edhe këtë: Ky lloj këshillimi nuk është i kufizuar në kohë apo vend. Prandaj ajo që i shkon myslimanit, është altruizmi dhe jo egoizmi. Ta kuptojë shoqërinë ku jeton dhe ta bëjë të veten kënaqësinë që i jep shërbimi për atë ditë.

Sureja Asr është e shkurtër, por thelbësore për të gjitha këshillat. Kjo është edhe arsyeja që transmetohet se dy persona që kanë lexuar suren Asr nuk janë ndarë nga njëri tjetri. Ndërsa Imam Shafi thotë: “Sikur të mos ishte zbritur asnjë ajet tjetër në Kuran, sureja Asr do kishte mjaftuar”. Kjo sure është gjithëpërfshirëse për të gjitha shkencat e Kuranit. Nëse njeriu do mendonte të hynte më thellë, do i mjaftonte vetëm kjo sure për t’u udhëzuar.

Imam Razi transmeton fjalën e një personi që shiste akull në Pazar dhe shton: Tani e tutje e kuptova domethënien e sures Asr. Shitësi po u thoshte njerëzve: Kini mëshirë për këtë njeri pasuria e të cilit po shteron!

Në fakt, nuk ishte vetëm ai të cilit po i shterohej pasuria. Për çdo njeri që ka besuar dhe nuk e shfrytëzon kohën e tij si duhet, me vepra të mira, me këshilla për drejtësi dhe durim, koha e tij e vlefshme do të jetë e humbur.

Marrëdhënia kohë-adhurime në jetën fetare islame!

Gençer Dervari

Koha në gjuhën Arabe quhet “vakt”, dhe rrjedh nga fjala “vekate-jekitu”, që do të thotë vendosje e kohës, caktimi i kohës. Fjala “vakt” si një emër do të thotë koha, afat etj. dhe shumësi i kësaj fjale është evkat.

Koha është prej begative më të çmueshme të dhuruara nga Allahu (xh. sh) dhe Islami kërkon nga ne që ta vlerësojmë atë në mënyrë të mirë, sepse jeta e njeriut vetëm një herë do të përdoret. Për rëndësinë e kohës pohon edhe fakti se te shumë ajete Kuranore, Allahu xh.sh. betohet në gjërat të cilat lidhen me kohën, me qëllim që të na tërheqë vërejtjen në lidhje me këto gjëra dhe të na tregojë se këto janë shume të rëndësishme për njeriun. Allahu xh. sh. thotë:

“**Pasha kohën!** nuk ka dyshim se njeriu është në humbje të plotë. Përveç atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që i përmbahen të vërtetës, dhe që këshilluan njëri-tjetrin për durim.” (Asr, 1-3)

Po ashtu, në Kuranin famëlartë Ai thotë: Pasha agimin! Pasha dhjetë netët! (dhjetë ditët e para të Dhulhixhes). (Fexhr, 1-2) Pejgamberi (a.s) tregon për vlerën e dhjetë ditëve të para të Dhulhixhes:

“Asnjë nga veprat e mira të kryera në ditët e tjera nuk janë aq të larta sa ato të kryera në këto ditë. Pastaj disa shokë të Pejgamberit a.s thanë: As edhe Xhahadi? Ai u përgjigj, “As edhe xhahadi, përveç, atij i cili e bën atë duke vënë në rrezik vetveten dhe pasurinë, e që nuk kthehet më me asnjërin prej atyre dy gjërave. (Buhari, 969) Edhe i Dërguari i Allahut, Muhammed (a.s), në disa hadithe ka treguar vlerën e kohës, duke na porositur që ta shfrytëzojmë atë veçanërisht në moshën e re, sepse kjo moshë është moshë e fuqisë.

Allahu (xh. sh.) thotë: “**(Beto hem)** për paraditen (koha pas lindjes së diellit). Për natën kur qëndron (në errësirën e saj)”! Për vlerën e kohës se duhas, tregon Ebu Hurejre (r.a) se miku im (Pejgamberi a.s) me këshilloi të ndjek tri gjëra:

1. Të agjëroj tri ditë në muaj.
2. Të fal dy rekate namaz duha (Paradite).
3. Të fal namazin e vitrit para gjumit. (Buhari 1981)

I Dërguari i Allahut thotë: Dy janë dhuntitë të cilat shumica e njerëzve i ka të humbura; Shëndeti dhe koha e lirë. (Buhari, Rikak 1; Tirmidhi, Zuhd, 1; Ibn Maxhe, Zuhd 15)



Të pyesin ty për daljen e hënës së re. Thuaj këto janë shenja për të treguar kohë të përcaktuara për njerëzimin dhe për Haxhin



Po ashtu, në një hadith tjetër transmetohet se ka thënë: Nuk do të lëvizim ditën e kiametit para Allahut, pa u pyetur për këta pesë gjëra: ku dhe si ke kaluar jetën, në ç'ka e ke harxhuar rininë, si e ke fituar pasurinë, dhe çfarë ke vepruar me atë që e ke mësuar" (Tirmidhi, Kijamet, 1)

Njeriu është i fituar aq sa shfrytëzon kohën e lirë. Ndërsa në të kundërtën, ai është i humbur tërësisht. Sepse çdo sekondë që kalon nuk mund të kthehet më. Sepse Allahu (xh. sh.) nuk na e dha moshën e rinisë, aftësinë e fuqinë, për të mos pasur kurrfarë dobie, për të mos lënë kurrfarë gjurme në shoqëri. Koha është sikur shpata, nëse nuk kujdesemi për të, ajo na pret. Nëse kohën e lirë e përdorim mirë, atëherë ajo do t'i mundësojë robit një jetë të lumtur.

Po ashtu, koha është shkak për caktimin e disa ibade-teve farz; në këtë mënyrë, pa hyrjen e kohës nuk realizohet caktimi i farzit. Psh: hyrja në muajin Ramazan është shkak për agjërimin e muajit të Ramazanit. Në një nga hadithet e tij, Pejgamberi thotë: "Kur e shihni hënën e re të Muajit të Ramazanit agjëroni, dhe kur e shihni hënën e re të Muajit Sheval mos agjëroni më." (Buhari, Savm, II; Muslim, Sijam, 4, 18) Ndërsa në Kuranin famëlartë thuhet: "Kush nga ju e mbërrin muajin e Ramazanit, le të agjërojë". (Bakara, 185)

Po ashtu, edhe në zbatimin e ibadetit të Haxhit, pas disa kushteve të tjera është kusht edhe hyrja në muajin Dhilhi-xhe e qëndrimi në Arafat me ihram. Për këtë arsye, ata që kanë shkuar në Hixhaz dhe kanë vdekur para ditëve të

haxhit, atij nuk është bërë farz Haxhi. Allahu xh. sh. thotë: "Të pyesin ty për daljen e hënës së re. Thuaj këto janë shenja për të treguar kohë të përcaktuara për njerëzimin dhe për Haxhin". (Bakara, 189)

Edhe në dhënien e zekatit në bazë të disa kushteve, për të qenë Zekat pasuria e një myslimani duhet të kalojë si kohë një vit të plotë, dhe nëse vjen vdekja ose varfërohesh pa u realizuar viti, zekati nuk bëhet farz për atë person.

Po ashtu, koha është një prej kushteve për të qenë namazi farz .Për namazet farz, namazin e vitrit, teravisë, dhe për namazin e Bajramit janë të caktuar kohët e veçanta .Namazet e falur para kohës së namazit nuk do të pranohet, po ashtu pas kalimit të kohës ai namaz është kaza, sepse në Kuranin famëlartë thuhet: "Namazi është obligim) për kohë (i caktuar për besimtarët"

E ka mësuar Xhebraili a.s. pejgamberin Muhamed (a.s.) për fillimin dhe përfundimin e faljes se pesë kohëve të namazit. Hadithi i transmetuar nga Xhabiri (r.a) është kështu:

Xhebraili ka ardhur tek Pejgamberi dhe ka thënë: "Ngrihu dhe falu namaz" dhe Pejgamberi (a.s) kur dielli u drejtua nga zeniti për në perëndim, ka falur namazin e drekës. Pastaj Xhebraili ka ardhur në kohën e iqindisë dhe ka kërkuar të falë namazin, dhe resulullahu (a.s) është ngritur dhe ka falur namazin e Iqindisë. Pastaj ka ardhur në kohën e namazit të Akshamit dhe ka kërkuar prej Tij të falte namazin e Akshamit, dhe Pejgamberi pas perëndimit të diellit ka falur namazin e Akshamit. Pastaj Xhebraili a.s ka ardhur përsëri në kohën e namazit të Jacisë dhe i ka thënë të falë namazin e jacisë, kështu që kur është bërë terr namazin e jacisë. Pastaj ka ardhur në kohën e namazit të sabahut dhe ka thënë të fal namazin. Kështu, menjëherë pas hyrjes se kohës se namazit (menjëherë pas imsakut), Pejgamberi ka falur namazit e sabahut. Pastaj Xhebraili ditën tjetër ka ardhur dhe i ka kërkuar të falë namazin e drekës, dhe Pejgamberi pas kalimit të hijes një fish të çdo sendit, ka falur namazin e drekës. Pastaj Xhebraili ka ardhur dhe ka kërkuar që ai të falë namazin e iqindisë, dhe pas kalimin e hijes dy fish të çdo sendit ka falur namazin e Iqindisë. Pastaj Ai ka ardhur dhe ka kërkuar të falë namazin e akshamit dhe ka falur në kohën e ditës se kaluar. Pastaj ka ardhur në kohën e jacisë duke kaluar gjysma e natës ose një e treta e natës, dhe pejgamberi ka falur namazin. Pastaj, kur vendet nisen të ndriçohen, ka falur namazin e sabahut. Pastaj Xhebraili më tha kështu: Brenda këtyre dy kohëve është koha e namazit të sabahut.

Buhariu thotë se ky është hadithi më i saktë për caktimin e kohërave të namazit. Po ashtu, na tregon se jashtë namazit të akshamit, çdo namaz ka dy kohë ose thënë ndryshe namazi mund të falet ndërmjet këtyre dy kohëve.



Mos e shani kohën!

Hamdi Nuhiju

Rëndësia e kohës në jetën e njeriut është po aq e madhe sa edhe rëndësia e të gjitha veprimeve të tij në këtë botë. Koha është dhuratë, mirësi e dhënë nga ana e Allahut për krijesat, të cilat duhet ta shfrytëzojnë në mënyrë të drejtë dhe të saktë. Koha duhet shfrytëzuar në punë të mira dhe të dobishme për individin dhe për shoqërinë. Nuk duhet të guxojmë ta shfrytëzojmë në mëkate dhe veprime që janë në kundërshtim edhe me natyrën njerëzore.

Përderisa Zoti betohet në kohën, njeriu nuk do të ketë mundësi ta zhvlerësojë atë. Nëse e zhvlerëson rëndësinë e kohës, ai ka zhvlerësuar rëndësinë e jetës së vet. Koncepti dogmatik i njeriut për Zotin mund të ndryshohet ose edhe të marrë trajta jo të sakta. Madje disa mendime mund edhe të bien ndesh me identitetin kulturor dhe fetar të njeriut. Për asnjë moment nuk bën të lëshohet pe gjatë planifikimit të shfrytëzimit të kohës.

Gjatë jetës së tij njeriu duhet të mundohet në maksimum për arritjen e rezultateve të caktuara, të cilat do të jenë shkak për futjen në xhenet ose xhehenem. Po u humb dhe po u shkri në stuhitë e kohës, u humb dhe u bë pluhur e hi në gjendjen e tij të njëtrajtshme e cila dëmton atë dhe komplet shoqërinë njerëzore. Përderisa njeriu është një qenie e dobët dhe e mbushur plot me gabime, ai ka nevojë që të kthejë veten mbrapa në llogari personale për shfrytëzimin e çdo momenti në këtë botë. Nëse nuk i shfrytëzojmë të gjitha momentet në dobi to-

nën, ato do të na kthehen kundër nesh. Ne nuk do të kemi mundësi t'i përgjigjemi, madje as që do të kemi atë forcë të peshojmë veprat tona karshi hidhërimit, pra kohës. Ndoshta dikush e gjen veten të fuqishëm karshi kësaj krijese e cila di të lakojë në çdo moment gjendjen e njeriut modern. Shpesh herë i kemi dëgjuar njerëzit duke u ankuar për kohën, pra duke thënë se kohërat kanë ndryshuar. Në fakt kanë ndryshuar njerëzit, veset, traditat, lakmitë e tyre, sepse koha ka mbetur e njëjta. Të njëjtën kohë jetese ka pasur Ibn Tejmije, i cili ka shkruar 1000 libra, ashtu si një tjetër njeri i thjeshtë që ka jetuar vitet e tij. E njëjta kohë sot është si për një doktor shkence, i cili me një libër të nxjerrë gjatë tërë jetës së tij akademike, krenohet para botës, e njëjta kohë është edhe për dijetarin bashkëkohor Osman Nuri Topbash. (Allahu ia zgjatë jetën).

Koha është e njëjtë, por njerëzit janë të ndryshëm. Mjetet tekniko-teknologjike janë të njëjta, por përdorimi i tyre nga ana e njerëzve është i ndryshëm. Puna ndoshta ka të njëjtin emër si më parë, studim, hulumtim, por qëllimi është jo i njëjtë me atë të studiuesve dhe hulumtuesve të mëparshëm. Ndoshta sot puna bëhet për hir të dukjes, famës, interesit, duke u kamufluar përmes fjalës sikur bëhet për hir të Allahut. Ndërsa dikur puna bëhej për hir të Allahut dhe vetëm për hir të Tij. Prandaj edhe koha ishte shumë e bereqetshme nga ana e shfrytëzimit të saj për mirë. Emra të tillë si ata që ishin në të, mund të nxjerrim edhe sot nëse koha shfrytëzohet

në maksimum. Nëse nuk shfrytëzohet ajo, të gjitha përpjekjet për ta rikthyer kahun e mendimit kah fajësimi i kohës dhe do të ishte i kot.

Njerëzit parimisht pajtohen në koncepte të tilla se janë vëllezër, dhe se si të tillë duhet të vazhdojnë jetesën e tyre në këtë botë. Si të tillë, ato nuk duhet që të zhveshin punën në skajin e lakmisë pas të mirave të kësaj bote duke harruar esencën e shfrytëzimit të kohës. Qëllimi i ekzistencës sonë është adhurimi i Allahut xh.sh. dhe asnjë qëllim tjetër. Përderisa ky është qëllimi i ekzistencës sonë, atëherë nuk duhet të guxojmë të dalim në një rrugë tjetër dhe të bëhemi pre e kthetrave të djallit të mallkuar. Adhurimi i Allahut xh.sh. bëhet në shumë mënyra, e njëra prej mënyrave më efektive është të shfrytëzojmë kohën duke e falënderuar Atë, duke e përkujtuar, duke u falur, lutur, duke lexuar Kur'an, duke dhënë sadaka, kërkuar dituri, duke punuar për kafshatën e gojës, duke pasur kështu si qëllim kënaqjen e Allahut xh.sh..

Njeriu për të pasur një provim të lehtësuar në botën tjetër, patjetër që duhet të vërë vetveten në llogari përpara se ta llogarisin.

Hasan Basriu ka thënë: “Besimtari është vlerësuesi i vetvetes. Ai i kërkon llogari vetes për hir të Allahut. Llogaria në ditën e gjykimit do të jetë më e lehtë për ata që e kanë bërë këtë punë në dynja, ndërsa për ata që nuk e kanë kryer këtë gjë, do të ketë një llogari të vështirë.”

Njeriu që llogarit veten e tij në këtë botë, në fakt e shfrytëzon kohën ashtu si duhet dhe nuk ankohet në të për përtacinë e mangësitë e tij. Ai aspak nuk brengoset për dynjanë e humbur, por nuk mund të flejë rehat nëse ia ka ngrënë hakun dikujt, ose e ka shkelur dikë tjetër në nder.

Në një hadith të transmetuar nga Muslimi, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mos e shani kohën, sepse Allahu është koha.”

Allahu është zotëruesi dhe dirigjuesi i kohës. Ai bën që në kohë dhe rrethana të caktuara të ndodhin ngjarje të ndryshme, ngjarje të cilat ndoshta e ndërrojnë krejtësisht kahjen e globit. Secila kohë ka transformatorin e saj. Në çdo një shekull Zoti dërgon nga një reformues, i cili do

të ripërtërijë fenë dhe do të lërë gjurmë të thella në shoqërinë njerëzore. Por, përtacët, të cilët mallkojnë kohën për shkak se sipas tyre koha paska qenë e padrejtë ndaj tyre, e shprehin haptas hipokrizinë ndaj Allahut xh.sh. dhe ndaj krijesave tjera në këtë botë. Disa ia adresojnë kohës mossuksesin e tyre në jetë, duke thënë: Më ka shkelur rrota e historisë, që në fakt e ka shkelur mungesa e vullnetit për punë dhe mungesa e përgjegjësisë në shfrytëzimin e kohës për të mirë, dhe se nuk është koha ajo që shkel njerëzit. Njeriu shkel veten jo koha, koha ecë dhe nuk ndalet. Ngaqë ajo dirigjohet nga ana e Allahut xh.sh. dhe është për të gjithë njerëzit e jo vetëm për ne. Ne si myslimanë kemi qenë gjatë shumë shekujve në gjumë të thellë, në gjumë të ariut, dhe jemi ankuar me

kohën se koha na ka shkelur. Duke pasur në duar katër anët e rruzullit tokësor, duke pasur në duar fatin e gjithë popujve me emrin e Allahut, ne i humbëm ato, u shtrimë rehat në shtratin shekullor, ndërsa të tjerët shfrytëzuan kohën dhe sot po luajnë me ne. Edhe pse dekadat e fundit shohim një rizgjim të umetit islam në të gjitha sferat e jetës, prapë se prapë jemi shumë mbrapa të tjerëve.

Njeriu që ankohet dhe shan kohën, duhet të ketë parasysh gjithmonë se koha është Allahu. Ai duhet të jetë i kujdesshëm që të mos ankohet gjithmonë, por t'i bëjë punët sipas mundësive të tij, ngaqë askush nuk ngarkohet përtej mundësive, ndërsa shpërblimi i punës dhe suksesi është në dorën e Zotit. Ai njeri i cili mendon në

kësodore veprimtarinë e tij në këtë jetë, padyshim nuk do të ketë kohë të ankohet as para njerëzve e as para Allahut. Të gjitha sprovat që do t'i ndodhin gjatë veprimtarisë së tij në këtë jetë, do t'i shndërroj në kënaqësi dhe në mundësi përfitimi e të mirash nga ana e Allahut xh.sh. Sprovimet do i shohë si një formë të forcimit të tij në thirrjen islame dhe asesi me sytë e dëshpërimit. Kjo ngaqë dëshpërimi nuk guxon që të ketë vend në mesin e besimtarëve myslimanë.



Njeriu për të pasur një provim të lehtësuar në botën tjetër, patjetër që duhet të vërë vetveten në llogari përpara se ta llogarisin.



Ç'mund të bëni në pak minuta

Nesrin Kaja

Lështë detyrë e çdo myslimani që ta njohë dhe ta kuptojë rëndësinë e kohës, sepse ne u krijuam që ta adhurojmë Allahun dhe jo të përpiqemi ta vrasim kohën apo monotoninë me gjëra që nuk kanë përfitim. Njerëzit gëzohem me ditët që i kalojnë dhe nuk e mendojnë që në këto ditë të mbaruara, mbaron ngapak edhe jeta e tyre. Dijetari Hasan Basriu ka thënë: Çdo ditë që vjen i thotë birit të Ademit: "Unë jam dita e re, dëshmitare për veprat e tuaja. Nëse shkoj, kurrë nuk kthehem. Vepro çfarë të duash, lë pas dore çfarë të dëshirosh. Dije se ajo kohë që ka ikur, kurrë nuk do të të kthehet.

Koha e njeriut është dhuratë, sprovë dhe mëkat. Kush e kalon kohën në adhurim, le ta falënderojë Allahun, kush e kalon kohën në mëkat, le të pendohet. Kush e kalon kohën me një provë, le të kënaqet me caktimin e Allahut dhe të durojë.

Çudi sa të gjata janë dy orë të kaluara në xhami, e sa të shkurtra janë kur shohim ndonjë film! Çudi si gëzohemi kur loja e futbollit zgjatet dhe ankohemi kur teravia gjatë Ramazanit është më e gjatë se sa zakonisht! Çudi sa e rëndë është

të të lexohet një ajet në Kuran, dhe sa e lehtë është të lexohen disa gazeta apo revista rresht, brenda ditës!

Shumica e njerëzve e shpërdorojnë kohën, dhe kështu janë të privuar nga ky nimet, në mënyrën që nga jeta dhe koha e tyre të përfitojnë Ahiretin. Shumë njerëz e harxhojnë kohën dhe jetën e tyre për diçka që nuk u sjell dobi. Ata harrojnë që çdo minutë dhe çdo çast i kaluar nga jeta e tyre, i sjell më afër varrit dhe vdekjes dhe i largon nga kjo botë.

Në Kuran thuhet: "Kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova! Kurrsesi (kthim nuk ka), e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde deri në ditën kur ringjallen" (Muminun, 99 – 100). "Pasha kohën! Nuk ka dyshim që njeriu është në humbje të plotë, përveç atyre që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi dhe që këshillojnë njëri – tjetrin për të vërtetën dhe që e këshillojnë njëri – tjetrin me durim ." (Asr 1 -3)

Resulullahu a.s. ka thënë: "Shfrytëzojini pesë

gjëra para se të vijë pesë të tjera. Shfrytëzo rininë para pleqësisë, jetën para vdekjes, kohën e lirë para se të jesh i zënë, shëndetin para se të sëmuresh, pasurinë para varfërisë."

Transmetohet nga Ebu Hurejra se Profeti a. s. ka thënë: " Moshë e umetit tim, qëndron ndërmjet të gjashtëdhjetave dhe shtatëdhjetave, të paktët do ta kalojnë atë " (Tirmidhiu, Ibn Ma-xhe). Po e marrim moshën e Profetit a. s. i cili jetoi gjashtëdhjetë e tre vjet, si moshë mesatare të umetit, për të parë se sa kohë humbasin njerëzit në përgjithësi. Sipas një llogaritjeje të thjeshtë; një njeri i cili jeton gjashtëdhjetë e tre vjet, i cili punon tetë orë çdo ditë, ai njëzet e një vjet vetëm ka punuar. Nëse fle tetë orë në ditë, ai ka fjetur njëzet e një vjet të jetës së tij. Ndërkohë njeriu deri në moshën dhjetë apo trembëdhjetë vjeçare (moshë kur arrin pubertetin) nuk është i detyruar t'i praktikojë ligjet e Allahut. Nga gjashtëdhjetë e tri vjet po t'i heqim njëzet e një vjet punë, njëzet e një vjet gjumë, dhe dhjetë vite që nuk ke arritur moshën madhore mbesin njëmbëdhjetë vite. Po veprimtaritë tona të përditshme sa kohë na humbasin? E sa kohë nga jeta jonë na mbetka për ta shfrytëzuar në rrugë të Allahut? E atëherë pse për kaq pak kohë ta humbasim Xhenetin?!

I dërguari i Allahut ka thënë: "Kush e do dynjanë e tij, dëmton ahiretin e tij dhe kush e do Ahiretin, dëmton dynjanë e tij. Jepini përparësi asaj që mbetet ndaj asaj që zhduket"

Allahu i Madhëruar në Kuran e mëson profetin e Tij të lutet me fjalët: "Namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve."

Ja disa mënyra nëpërmjet të cilave do fitosh një numër shumë të madh sevapësh vetëm në pak minuta:

- Duhet ta dish se Kurani është libri i vetëm, prej të cilit fiton dhjetë sevape nëse e lexon një shkronjë nga ai. A nuk mundesh t'i

marrësh disa minuta nga dita jote dhe të lexosh disa rreshta në librin e Allahut dhe të mendosh për të? Ebu Hurejra r.a. transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë:

"Lexoni Kuranin se ai do t'ju bëjë shefaat (ndërmjetësim) ditën e Gjykimit për ata që e kanë lexuar". Gjithashtu Muhamedi a.s. ka thënë: " Kush lexon një shkronjë nga libri i Allahut, ka një sevap i cili vlerësohet dhjetë herë. Dhe unë nuk them se Elif, Lam, Mim, është një shkronjë; Elif është një shkronjë, Lam është një shkronjë dhe Mim është një shkronjë". (Transmeton Tirmidhiu dhe Darimi).

- Sureja Fatiha është sureja më e fuqishme në Kuran.

Edu Said ibn Mualâ r.a. transmeton se kur i dërguari i Allahut a.s. ka dashur të dalë nga xhamia, e ka kapur për dore dhe i ka thënë: A ta mësoj suren më të fuqishme në Kuran para se të dalësh nga xhamia? Për shkak të namazeve që i falem kaloi një kohë dhe unë e pyeta: O i Dërguari i Allahut, ti the se do të më mësoje suren më të fuqishme. Ai a.s. tha: Është Fatihaja.

Janë shtatë methani (ajetet që përsëriten shpesh) dhe thelbi i Kuranit që më është shpallur mua. (Buhariu).

- Sipas një transmetimi të Buhariut, Profeti a.s. i pyeti sahabët e tij: A nuk jeni në gjendje ta lexoni një të tretën e Kuranit për një natë? Pasi kjo iu duk e rëndë atyre thanë: O i Dërguari i Allahu, kush nga ne mund ta bëjë këtë? Ai, a.s. tha: kjo sure " Thuaj , Ai Allahu është një... është e njëjtë me një të tretën e Kuranit ".

- O Allah, fali besimtarët dhe besimtare.

Ubade ibnu Samit r.a. ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: "Kush kërkon falje për besimtarët dhe besimtare me fjalët "Allahumme fagfiri ve muminin vel mucinat" fiton një shpërblim për



çdo besimtar dhe çdo besimtare”.

Dhe mendo që sipas statistikave ekzistojnë 1,5 miliardë myslimanë në të gjithë botën.

- Ebu Hurejra r.a. transmeton se Profeti a.s. ka thënë: “Kush thotë “ La ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kul-li shejin kadir (S'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, Një dhe i Pashoq, Atij i takon sundimi dhe falënderimi, Ai është i plot-fuqishëm mbi çdo send) 100 herë në ditë, ka shpërblimin sikur t'i kishte liruar dhjetë rob, atij i shkruhen dhjetë të mira, i fshihen dhjetë gjynahe dhe është i mbrojtur nga djalli deri në mbrëmje. Askush nuk ka vepruar më mirë se ky person, me përjashtim të atij që ka vepruar më tepër.” (Buhariu dhe Muslimi)

“Kush thotë në mëngjes dhe në mbrëmje 100 herë Subhanallah është sikur të kishte shkuar dhjetë herë në haxh dhe kush thotë në mëngjes dhe në mbrëmje 100 herë Elhamdulillah është sikur t'i kishte përgatitur 100 kuaj dhe t'i kishte dërguar në rrugën e Allahut. Kush thotë në mëngjes dhe në mbrëmje 100 herë La ilahe ilallah është sikur t'i kishte liruar 100 robër, kush thotë në mëngjes dhe në mbrëmje 100 herë Allahu ekber askush nuk do të vijë me diçka më të vlefshme se ky, përveç atij që ka thënë si ky apo më tepër.” (Tirmidhi)

Një dua për dhjetë sekonda, e cila është përmbledhje e të gjitha dua-ve.

Ebu Uamama r.a. transmeton: I Dërguari i Allahut thoshte dua të ndryshme, prej të cilave nuk e mësuam asnjërën përmendësh, kështu i thamë: O i Dërguari i Allahut, t'i ke thënë plot dua nga të cilat nuk mësuam asnjërën përmendësh. Ai tha: A doni tju tregoj se çfarë përmbajnë të gjitha këto? Lutuni: O Allahu im, kërkoj prej teje çdo të mirë që e ka kërkuar prej teje peygamberi yt Muhamedi a. s., dhe kër-

koj strehim prej Teje nga çdo e keqe nga e cila ka kërkuar strehim peygamberi yt Muhamedi a.s. Ti je i vetmi ndihma e të cilit kërkohet, Ai që (atë që dëshirojmë) na jep. S'ka mundësi e fuqi vetëm se me Allahun”. (Tirmidhi)


-Umer ibnul Khatabi r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut, ka thënë: “Kush merr abdest mirë dhe thotë: Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, i Cili nuk ka shok, dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij. O Allah, më bëj nga ata që pendohen dhe pastrohen”, këtij i hapen tetë dyert e Xhenetit dhe hyn nga ajo derë që do.” (Tirmidhi).

Duhet ta dini se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë se ndërmjet njerit skaj të derës së Xhenetit dhe skajit tjetër, janë dyzet vjet.

-Ebu Hurejra r.a. transmeton: “Erdhën muhaxhirët e varfër te profeti Muhamed a.s. dhe thanë: O i Dërguari i Allahut, vetëm të pasurit e kanë fituar shkallën më të lartë (në Xhenet) dhe gëzimin e përhershëm, (sepse) ata falen po ashtu si ne, agjërojnë po ashtu si ne, ata japin sadaka dhe ne jo, ata lirojnë skllëvër dhe ne jo. Këtu i Dërguari i Allahut a.s. tha: “ A t'ju mësoj diçka me të cilën do të arrini përparësinë e atyre që janë para jush, me të cilën do tua kaloni dhe atyre që vijnë pas jush, e me të cilën askush nuk do të jetë më i mirë se ju, përveç nëse e thonë si ju?” Ata thanë : Sigurisht o i Dërguari i Allahut. Ai a.s. tha:

“Madhërojeni Allahun (Subhanallah), falënderojeni (Elhamdulillah) Atë dhe madhërojeni (Allahu ekber) tridhjetë e tre herë pas çdo namazi”. (Buhari dhe Muslim) Ebi Umama r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “ Kush e lexon ajetul Kursinë pas çdo namazi farz, asgjë nuk e pengon që të hyjë në Xhenet, përveç momentit të vdekjes që nuk i ka ardhur ende.”

Enes ibn Malik r.a. transmeton se i Dërguari i Alla-



hut a.s. ka thënë: "Allahu është i kënaqur me robin e tij, i cili pasi të hajë ushqim dhe të pijë, e falënderon Allahun (me elhamdulillah)."

Shedad ibn Avs r.a. ka thënë se i dërguari i Allahut i ka thënë: "Duaja më e mirë e robit të Allahut për të kërkuar falje është: "O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër përveç teje, Ti më ke krijuar dhe unë jam robi yt, do të qëndroj besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit Tënd, sa të kem mundësi; kërkoj mbrojtjen tënde nga e keqja që kam vepruar, unë jam mirënjohës ndaj dhuntive të tua, i pranoj gjynahet e mia, prandaj më fal, ngaqë gjynahet nuk i fal askush tjetër përveç teje". Kush e thotë këtë në mbrëmje, po ashtu edhe në mëngjes, duke qenë i bindur në të dhe vdes po atë natë, do të jetë prej banorëve të Xhenetit. (Buhariu)

- Kur biri i Ademit e lexon suren Sexhde, shejtani largohet duke qarë dhe thotë: "O i mjeri unë! Birit të Ademit iu urdhërua të bëjë sexhde dhe ai e bëri, për këtë ai do të fitojë Xhenetin. Mua më u urdhërua të bëj sexhde dhe unë e refuzova dhe për këtë do të fitoj Xhehenemin. (Muslimi)

-Sad ibn Ebi Vekas r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Kush e dëgjon ezanin dhe thotë: "Ve ene eshhedu en la ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh, ve enne Muhameden abduhu ve resuluhu, redijtu bil-lahi Rabben ve bi Muhamedin resulan ve bil islami dinen" (Edhe unë dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një dhe i pashoq dhe se Muhamedi a.s. është rob dhe i dërguari i Allahut; jam i kënaqur me Allahun për Zot, me Muhamedin për peygamber dhe me Islamin për fe) do t'i falen gjynahet". (Muslimi)

-Allahu i madhëruar thotë në Kuran: "Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt e tij e mëshirojnë peygamberin me adhurim. O ju që keni besuar, madhëro-

jeni pra atë (duke rënë salavat) dhe përshëndeteni me selam (Ahzab, 56). Abdullah ibn Amr ibn As r.a. transmeton që i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: " Kush e lut Allahun të më bekojë mua, Allahu e bekon atë dhjetë herë. " (Muslimi). Në një version tjetër nga imam Ahmedi dhe Nesaiu, thuhet edhe kjo shtesë: " ...dhe i falen dhjetë gjynahe, si dhe ngrihet dhjetë shkallë" (në Sahihun e Ibn Hibanit)

Koha është mosha e njerëzve dhe gjëja më e çmuar të cilën njeriu, në veçanti myslimani duhet ta ruajë nga mospërfillja. I mençuri e ruan kohën e tij dhe nuk e humb atë duke bërë vepra të këqija që e dëmtojnë. Ai e përdor kohën e tij duke u munduar të bëjë vepra të mira që e kënaqin Allahun dhe i bëjnë dobi si këtij, ashtu edhe të tjerëve, si në këtë botë , po ashtu edhe në tjetrën.

Në çdo minutë të jetës tënde mundesh të vendosësh një tullë të pallatit tënd në Xhenet.

Prandaj mundohu zellshëm të fitosh dinjitetin tënd, mirëpo duhet që të mposhtësh nefsin. Ndërto një mur mbrojtës ndërmjet teje dhe lo-

jës së jetës. Për një minutë mundesh të fitosh shumë sevape, të mësosh më shumë përmendësh, të ngresh shkallën tënde në Xhenet dhe t'i shlyesh gjynahet...

Kjo minutë mund të sjellë dobi ditën e llogarisë, nëse ti e shfrytëzon.

Duhet të dish se këto vepra nuk të kërkojnë shumë punë, nuk të mendojnë, këto vepra mundesh t'i kryesh në çdo gjendje. Veprat e mira janë shkaqet kryesore për të qenë i lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër, si dhe për të larguar brengat dhe mërzitë.



RËNDËSIA E KOHËS në Islam

Fatjon Hamzi

Në psikologjinë e popujve të ndryshëm vlera e kohës është dhënë nëpërmjet proverbave të tilla si: për ne shqiptaret “Koha është flori”, për anglezët “Koha është lekë” (The time is money), po ashtu edhe për popullin italian “il tempo e denaro”, ndërsa për arabët “koha është si shpata, po nuk e preve të pret ..” e shumë thënie të tjera. Nuk është çudi të mendojmë se popujt e prapambetur e marrin kohën si diçka të pavlerë, mendojnë për të me vështirësi, aq sa kur e kalojnë kohën kot ndjehen të lumtur. Por popujt e mençur, apo popujt udhëheqës dhe ata që janë aktivë në arenën botërore, i japin rëndësi të veçantë kohës dhe mendojnë se ajo në asnjë mënyrë nuk duhet humbur kot, sepse çdo çast i saj që kalon nuk kthehet më. Është humbje e madhe që shumica e myslimanëve e trajtojnë kohën si diçka jo shumë të rëndësishme në jetën e tyre! Por koha është shumëçka. Pikësëpari ajo është amanet të cilin e kemi pranuar nga Allahu xh.sh. dhe për të cilin toka dhe qiejt janë tkurrur nga frika se nuk do të mund ta çonin në vend, por të cilën njeriu e pranoi me vetëdije. Për këtë arsye Allahu i ka dhënë një vlerësim të jashtëzakonshëm në fjalën e Tij, në Kuranin famëlartë. Për të treguar vlerën e kohës, Allahu është betuar kësajsoji në fillim të disa sureve: “Pasha Natën që me errësirë mbulon gjithësinë, pasha Ditën kur ajo shkrepstinë” (Surja 92, ajeti 1-2), “Pasha agimin” (Surja 89, ajeti 1), “Pasha paraditen ...” (Surja 93, ajeti 1-2).

Nga disa studime të bëra në Kuranin famëlartë, del se në 28 ajete të ndryshme preket dhe trajtohet problemi i kohës, raporti që duhet të krijojnë njerëzit me të, si ta shfrytëzojnë, si ta bëjnë atë të dobishme për veten, për familjen dhe shoqërinë. Ndonëse njerëzit betohen dhe duhet të betohen në emrin e Allahut, Allahu betohet ndërmjet të tjerave për kohën. Le të mendojmë

për pak çaste se ç’vlerë e jashtëzakonshme i jepet asaj. Allahu betohet në krijesat e Tij për të na kujtuar dhe për të na bërë neve të mendojmë për vlerat dhe rëndësinë e asaj në të cilën Allahu është betuar. Edhe tradita e profetit tonë të dashur, Muhamedit a.s, thekson një gjë të tillë. Në një hadith të transmetuar nga Taberaniu, profeti a.s. thotë: “Nuk do të lëvizë këmba e njeriut ditën e gjykimit, derisa të pyetet për katër gjëra : Ku e ka çuar jetën e tij? Ku e ka shfrytëzuar rininë e tij? Ku e ka fituar dhe shpenzuar pasurinë e tij? Çfarë ka punuar me diturinë e tij“

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Buhariu, profeti a.s thotë: “Janë dy mirësi në të cilat shumë prej njerëzve janë të humbur, shëndeti dhe koha e lirë.“

Në një hadith tjetër thuhet: Shfrytëzo pesë gjëra para pesë të tjerave: rininë para pleqërisë, shëndetin para se të bëhesh i sëmurë, jetën para vdekjes, pasurinë para varfërisë dhe kohën e lirë para se të zihesh me punë. Islami urdhëron që koha të përdoret maksimalisht dhe të mos humbet kot. Dihet se myslimanët e shekujve të parë i kanë dhënë kohës rëndësi aq sa myslimanët e epokës sonë i japin pasurisë. Rezultat i kësaj është dija e mirëfilltë, veprat e mira, lufta në rrugën e Allahut xh.sh, fitorja e sigurt dhe një civilizim i thellë. Koha ka vlerë dhe rëndësi të madhe për njeriun, sepse Allahu xh.sh. nuk na ka krijuar për kot, nuk na e dha moshën e rinisë plot vitalitet dhe aftësi e fuqi për të bërë çudira, që ta harxhojmë pa pasur asnjë dobi dhe pa lënë ndonjë gjurmë në jetën e njeriut dhe në shoqëri. Qëllimi im është që ky shkrim t’i drejtohet sidomos të rinjve të cilët janë e ardhmja e shoqërisë, por edhe të tjerëve, që po ashtu duhet të ulen e të meditojnë për kohën që kanë kaluar dhe të mundohen ta shlyejnë kohën e humbur. Nuk ka dyshim se një nga problemet më të dukshme të rinisë Islame në veçanti, por në përgjithësi edhe të disa të rinjve të besimeve tjera, është moskujdesi ndaj kohës dhe mosshfrytëzimit racional i saj. Një pjesë e të rinjve, le të mos e teprojmë duke i përfshirë të gjithë, nuk i kushtojnë kujdes

mënyrës se si dhe ku e kalojnë kohën, nuk janë vigjilentë ndaj elementeve destruktive dhe faktorëve negativë, të cilët punojnë me të madhe që i riu mysliman të mos krijojë shprehinë e shfrytëzimit si duhet të kohës së vet, por ta humbasë dhe ta harxhojë në gjëra të kota. Është e vërtetë se njeriu në rini ndoshta nuk ka shumë preokupime. Por ai duhet ta shfrytëzojë maksimalisht kohën që ka në disponim, sepse kur të hyjë në moshë të pjekur, kur të krijojë familje, kur t'i shtohen obligimet e preokupimet do ta kuptojë rëndësinë e kohës së lirë, por atëherë ajo nuk do të jetë në disponim të tij dhe do të jetë e kotë të qajë për të. Disa të rinj e humbin kohën duke qëndruar pa gjumë deri në orët e vona të natës, për shkak të mbrëmjeve gazmore, zbavitjeve, lojërave të bixhozit, bisedave të parëndësishme me shokë, etj. E gjithë kjo do të pasohet prej gjumit deri në mesditë apo edhe më vonë, pasohet prej mosshkuarjes në punë, moskryerjes së detyrimeve të rëndësishme, mosshkuarjes në shkollë, apo humbjes së orëve të para rregullisht, pa përmendur humbjen e obligimeve fetare të cilat paraqesin anijen e shpëtimit të njeriut nga shtrëngatat e djallit dhe degjenerimit. Nëse nuk shfrytëzohet koha si duhet, apo më mirë të themi nëse humbet koha kot, nuk mund të kemi një të ri mysliman të gatshëm për kryerjen e angazhimeve që i imponon koha, nuk mund të kemi profesionistë të lëmeve të ndryshme, shkencëtarë të mirëfilltë, njerëz të penës, politikanë të shkathtë dhe punëtorë të sinqertë, njerëz me famë, apo thënë shkurt kuadro të aftë. Ja si e këshillon rininë një nga mendimtarët bashkëkohorë islam, Mustafa Tahhan: "Brezi i ri islam që tenton të marrë mbi vete synimin e reformës dhe ndryshimit rrënjësor të ummetit islam në drejtim të së mirës, medoemos duhet të ketë kujdes ndaj çështjes së kohës në lidhje me vepërimtarinë dhe aktivitetin e tij. A thua do të mund të arrijë sukses në rast se në mesin e tyre ka më shumë persona të cilët çështjen e kohës e kanë lënë pas dore? Apo prej atyre të cilët nuk lejojnë hapjen e kësaj teme?" Duke qenë koherent me një gjendje të atillë, e ndjej të nevojshme t'ju paraqes një program të thjeshtë të cilin mund ta përdorë kushdo që ka logjikë dhe që mendon se koha duhet të menaxhohet në mënyrë të dobishme, me përfitim dhe mbi të gjitha për fitimin e njohurive në fusha të ndryshme të shkencës, me qëllim që t'i përgjigjemi kohës në të cilën ne jetojmë. Pse jo edhe për ta përgatitur që të përballojë sfidat e së ardhmes, gjë e cila nuk mund të arrihet pa një kulturë të gjerë, pa dije fetare, pa njohuri shkencore dhe pa punë e mundim. E të gjitha këto mund të realizohen nëse ne punojmë shumë në rini, nëse shfrytëzojmë kohën në mënyrë të programuar dhe nuk lëmë asnjë minutë të na ikë kot, duke pasur parasysh:

Së pari, koha duhet të kuptohet thellë dhe të meditojmë në lidhje me hadithet dhe ajetet kuranore që cituam me sipër, në mënyrë të atillë që të mos pendohe mi kur të jetë vonë.

Së dyti, të gjithë jemi koshientë se koha ikën e nuk kthehet më dhe se çdo çast që kalon nuk përsëritet.

Së treti, ta menaxhojmë ne kohën dhe jo ta lëmë veten në rrjedhën e kohës. Në këtë kontekst, menaxhimi i kohës lidhet shpesh me faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, ka anët e veta teknike dhe psiko-sociale. Në jetën e përditshme ne hasim shpesh vështirësi dhe probleme, të cilat na shpërqëndrojnë nga planifikimi i kohës, por këtu qëndron dhe e fshehta e këtij sukcesi, pasi në vështirësi shikohet i formuari, ai që ka edukatë punën, i devotshmi, ai që ka një qëllim fisnik në jetë. Në kompanitë e mëdha, në të cilat koha është flori, madje çdo sekondë e saj, edhe po të duash të lësh një takim me një menaxher, duhet të përballesh me sekretaren e tij, e cila të thotë: një minutë ju lutem, sa të shikoj axhendën, zotëri.... Kjo sepse shefi i saj e ka të kronometruar kohën, gjë që do të thotë, nëse ai merret me çështje që s'kanë perspektive për biznesin, pason falimentimi. Po neve që Allahu na ka lajmëruar që ta shfrytëzojmë kohën, sepe do përgjigjemi për të?!! A keni menduar ndonjëherë për kohën që keni konsumuar jo në vepra të mira, jo duke kërkuar dituri, jo duke dhënë dituri, por përkundrazi duke frekuentuar bare dhe aktivitetet jo të pëlqyeshme në Islam? Të ulemi për një minutë dhe të bëjmë një axhendë të kohës suaj; kjo gjë mund të arrihet në këtë mënyrë, duke realizuar plane pune dhe me perspektivë. Unë do ju rekomandoja që të ndiqnit këtë ecuri: Bëni një agjendë në të cilën planifikoni 60 % të kohës suaj në aktivitete që priten të ndodhin, ndërsa pjesën tjetër të kohës lëreni për gjëra që nuk janë të parashikueshme. Bëjeni këtë gjë sistematikisht dhe do e shikoni se shumë shpejt do të ndjeheni mirë.

Do të duhen me qindra e me mijra libra e volume për të folur rreth dobisë së kohës nëse e mirëmenaxhojmë mirë atë, dhe për pasojat e saj nëse nuk dimë ta përdorim. Në këtë pikëpamje, të gjithë kemi nevojë të mendojmë dhe të përpiqemi në çdo rast ta menaxhojmë kohën që kemi. Koha është plot e përplot me ngjarje të çuditshme, me njerëz të mëdhenj që humbin vlerën, me njerëz të panjohur që arrijnë famë, me pasanikë që varfërohen, e kështu me radhë në të gjitha fushat e jetës. Prandaj ne duhet të marrim mësim, të nderuar vëllezër dhe motra besimtare, që të mos humbasim, por të jemi gjithnjë në përparim, ashtu siç është i përparuar Islami.



Njeriu përballë kohës dhe vetvetes

Zymer Ramadani

“Ne i bëmë natën dhe ditën dy fakte (që dokumentojnë për fuqinë Tonë), e shenjmë e natës e shlyem (e errësuam), e shenjmë e ditës e bëmë të ndritshme që të mund të angazhoheni për shfrytëzimin e begatave të dhuruara nga Zoti juaj, dhe që të mësoni njehsimin e vjetëve dhe llogaritjen (e kohës). Ne kemi sqaruar çdo send në mënyrë të hollësishme. (Isra, 17/12)

Njëra ndër begatitë më të mira që çdo njeri e posedon, padyshim se është edhe koha të cilën Krijuesi ia ka dhuruar atij. Padyshim se ndër dhuratat më të mira që ka njeriu, në nivelin e të parave mund të llogaritet koha dhe vlera e saj. Kështu që po të ndalemi dhe të mendojmë se çfarë mund të shpik dhe të nxjerr në dritë njeriu brenda asaj kohe që i dha Allahu, do të arrijmë në përfundim se ai më së paku do të bëjë diçka që do të ndikonte në

zhvillimin dhe përparimin e personalitetit të tij. Kështu që çdo ditë e më tepër ai do të rrit nivelin e diturisë dhe punës së tij.

Allahu i Madhëruar shumë herë në shumë aje-te të Kuranit është betuar për disa gjëra, e ndër to është edhe koha. Ndër betimet dhe përbetimet tjera që kanë të bëjnë me kohën dhe vlerën e saj janë edhe etapat si: agimi, paraditja, pasditja etj., Ai po ashtu betohet edhe në natën dhe ditën, në kohën më të vlefshme të natës – para hyrjes së kohës së sabahut etj. për të gjitha këto ne si mysliman, duhet të ndalemi dhe të llogarisim se a thua pse Allahu i Madhëruar edhe pse e krijoi kohën dhe gjithçka tjetër, po betohet në to? Pse Ai i dha një rëndësi të madhe fjalës – *kohë*- në Kuranin Fisnik dhe a thua pse Ai u ndal dhe neve kohën na ndau në etapa; ndau në etapa vitin në stinë, stinë

në muaj, muajt në javë, javën në ditë e natë dhe se brenda këtyre dy ndërrimeve Allahu neve na ndau natën për pushim dhe atë në disa pjesë po ashtu edhe ditën në disa pjesë duke filluar nga sabahu deri në mbrëmje – jaci, duke punuar dhe u furnizuar. Kështu që viti ka dymbëdhjetë muaj, muaji i ka tridhjetë ditë, dita ka njëzet e katër orë dhe ora ka gjashtëdhjetë minuta etj. ta e dimë shumë mirë se për të gjitha këto imtësi do të na pyes Allahu xh. sh.

Nga të gjitha këto betime dhe përbetime që bëri Allahu xh. sh. në mënyrë direkte nga Libri i Tij, Kurani Fisnik po sjellim disa pjesë të ajeteve në lidhje me këto:

1. **“Pasha kohën!”**¹
2. **“Pasha agimin!”**²
3. **“Pasha paraditen!**
4. **“Pasha natën që me errësirë mbulon gjithësinë!”**³; **“Pasha natën kur ajo ia beh me errësirë”**⁴
5. **Pasha natën, që me errësirë mbulon gjithësinë!**
6. **“Pasha ditën kur ajo shkrepitin!”**⁵; **“Pasha ditën e premtuar”**⁶

Në këtë mënyrë Allahu i Madhëruar ndau kohët dhe caktoi punët të cilat duhet të bëhen në ato kohë. Ai me madhërinë e tij absolute, në çdo cep të saj nxori nga një vlerë të veçantë për robërit, andaj çdo person le të ndalet dhe të mendoj në atë që iu dorëzua ta shfrytëzoj. Me një thënie tjetër, a thua kot Allahu i bëri të gjitha këto përbetime? Jo, jo asesi, Ai u betua në mënyrë që të na tërheq shikimet dhe mendimet tona ndaj asaj gjëje.

Ndër sistemet dhe programet më të mira që mund të krijoj njeriu është edhe llogaritja e kohës,

1. El-Asr, 103/1.


2. Fexhr, 89/1.

3. Gashije, 92/1.

4. Tekvir, 81/17

5. Gashije, 92/2.

6. Buruxh, 85/2.



O biri i Ademit, ti je disa ditë të mbledhura, sa herë që kalon një ditë, kalon një pjesë e jotja, mbaron një fletë nga libri yt, bie një gjeth nga pema jote, shembet një mur nga ndërtesa jote.

punës, vendit etj. sikurse që e bën tregtari llogarinë në fund të ditës, muajt apo vitit duke i ndarë fitimet dhe humbjet. Myslimani bashkëkohorë ka në dispozicion shumë gjëra për të arritur deri tek shfrytëzimi i kohës dhe nxjerrja në pah e shumë gjërave themelore të jetës së tij. Ai duhet të ndajë kohë edhe për detyrat dhe obligimet e kësaj bote por edhe të ahiretit – obligimet që ka ndaj Allahut, obligimet ndaj vetvetes, familjes, të afërmeve etj. Jeta dhe ambjenti që të rrethon është në të mirën ose të keqen tënde, krejtësisht varet nga ajo se sa korrekt dhe i përgatitur je ti ndaj tyre. Çdo çast i kohës që kalon është një rrënim dhe zvogëlim i jetës tënde, e nëse ti e kalon këtë çast në adhurim, punë, zhvillim dhe përparim, atëherë suksesi dhe përparimi yt është vërejtur qysh në momentet e para të ditës dhe jetës.

Kur personi zgjohet në mëngjes, ai fillon të harxhoj nga energjia e tij trupore e mendore duke iu afruar mbrëmjes, e në këtë mënyrë koha punon në harxhimin tënd përderisa ti të mos merresh me atë; ti do t'i afroresh edhe një hap më tepër pleqërisë që është fundi i jetës, në këtë mënyrë ti po i afroresh edhe më afër varrit tënd. Thotë Hasan Basriu:

“O biri i Ademit, ti je disa ditë të mbledhura, sa herë që kalon një ditë, kalon një pjesë e jotja, mbaron një fletë nga libri yt, bie një gjeth nga pema



jote, shembet një mur nga ndërtesa jote". Apo thënia tjetër e artë e Omer ibn Abdulazizit : "Dita dhe nata punojnë në ty, por ti a do të punosh në to?"

Ka edhe shumë këshilla dhe rrëfime që udhëzojnë njeriun në shfrytëzimin e kohës, ngase syri, veshi, zemra etj, të gjitha këto duhet të futen në një sistem për t'i dhënë një kuptim jetës, por në anën tjetër të gjitha këto kanë edhe përgjegjësinë para Allahut xh. sh. në ditën e kiametit. Në këtë kontekst thotë i Gjithëfuqishmi: **"...të dëgjuarit, shikimi dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi."**⁷

Myslimani nuk duhet të mbys kohën:

Një mysliman i devotshëm, i cili shpreson në një jetë të begatshme, nuk duhet që me mendjen dhe dorën e tij të mbysë apo të vras kohën. Ata të cilët mendojnë në këtë mënyrë, në realitet e kanë vrarë dhe mbytur vetën e tyre, sepse koha ec sipas caktimit dhe programit që ia ka bërë Allahu. E në anën tjetër njeriu duke mos punuar, duke mos u orvatur dhe duke mos u angazhuar për të fituar diçka nga koha për jetën e tij, do të tretët në plogështi dhe pesimizëm. Ka shumë të rinj që e mendojnë një gjë të tillë për të vrarë kohën, dhe kur i pyet se çfarë bëjnë, ata pa u turpëruar thonë se po

e kalojmë kohën ose po e vrasim atë; duke ndejë nëpër kafe, disko, festivale, vende për të bredhur, në klube të natës etj. Të gjitha këto, asnjëherë nuk i kanë ofruar asnjë të mirë askujt.

Këto gjëra jo vetëm që i dënon islami, por edhe edukata e çdo populli, ngase problemet më të mëdha dalin mu nga këto vende. E në anën tjetër e kemi përballë edhe gjykimin më të madh të jetës në ditën e kiametit ku, secili nga ne do të pyetet se ku e kemi harxhuar jetën, se si e kemi kaluar rininë, si dhe në çfarë mënyre e kemi fituar pasurinë dhe ku e kemi shpenzuar atë, dhe për diturinë e tij, se çfarë ka vepruar me të. Duhet t'i dorëzohemi dhe mbështetmi një fuqie absolute e cila na krijoi neve, kështu që në këtë mënyrë duhet të veprojmë diçka nga koha dhe mundësia që na është dhënë.

Nëse kthehemi dhe lexojmë biografite e dijetarëve dhe shkencëtarëve të mëdhenj islam dhe atyre botërorë, do të gjejmë një thesar të veprave të tyre. Ata këtë mund ta arrinin vetëm duke punuar në çdo moment të kohës, apo thënë ndryshe e kishin kuptuar se koha po nuk u shpenzua në punë, gjithçka do të shkonte në hiç. Sipas një hadithi që transmeton Ibn Abbasi (radijallahu anhu), pejgamberi Muhamedi a. s. rreth vlerës dhe dobisë së kohës në një thënie të begatshme të tij shprehët kështu: *"Janë dy begati e që njerëzit nuk ua dinë vlerën*

7. Isra, 17/ 36.



e tyre. Shëndeti dhe koha e lirë”⁸ Po të ndalemi dhe të analizojmë këtë hadith, do të vërejmë se vërtetë shumica nga ne, kohën e lirë e shfrytëzojmë për gjëra të kota, dhe se kur na ngushtohen punët, ankohemi se nuk po kemi kohë. Ndërsa sa i përket shëndetit, kur jemi pa ndonjë sëmundje qoftë e rëndë apo e lehtë, ne nuk ia japim hakun shëndetit tonë dhe as që me atë shëndet drejtohem ka krijuesi ynë. Vërtetë nuk ka vlerë dhe nuk zënë vend ankimet kur shëndeti keqësohet, sepse sa ishim të shëndosh nuk vepruam asgjë.

A ka porosi dhe këshillë më të mira se këto që na i ka përmendur i dashuri ynë Muhammed? Ky është një program i jetës sonë që na ka mësuar ai se si ta e shfrytëzojmë, ngase porosia që u cek në hadith, është në mënyrën urdhërore, që na jep të kuptojmë se secilën nga këto duhet ta e marrim dhe shfrytëzojmë në mënyrë të veçantë. Edhe pse jo gjithmonë urdhrat e Pejgamberit a. s. janë urdhra të prerë, në këtë duhet ta kuptojmë si një sunnet i fortë që nuk duhet t’i ikim veprimt.

Allahu xh. sh. në Kuranin Fisnik bën krahasime dhe na pyet neve për shumë gjëra, e njëra ndër to është edhe pyetja: **“Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?”**⁹ Të tillët nuk mund

të krahasohen në asnjë mënyrë, sepse të diturit kanë shpërblime dhe grada, ndërsa injorantët, për fat të keq nuk gëzojnë një gjë të tillë. Ngase të diturit, me shfrytëzimin e kohës ia arritën të bëhen të ditur.

Për një edukim shpirtëror më të mirë nevojitet një kohë jo shumë e madhe, për një adhurim ndaj Allahut nuk nevojiten më shumë se dy orë nga 24 orët në ditë. Nëse ndodh që të gjithë kohën e kalojmë pa punuar, pa lexuar, pa adhurim dhe pa një edukim fetarë, atëherë do të hyjmë në normën e ajetit që Allahu betohet edhe një herë në mënyrë të veçantë në kohën dhe tregon përfundimin e atyre që e kalojnë kohën kot: **“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm”**.¹⁰

Lutja jonë e fundit është që Allahu të na begatojë kohën tonë me vepra dhe punë të mira, të cilat do të na sjellin lumturi, bereqet dhe harmoni si në shpirtat tonë ashtu edhe në familjet tona.

8. Buhari, Rikak, 1.
9. Zumer, 39/9

10. Asr, 103/1-3.

BEGATITË E KOHËS

Abdylkader Durguti

Koha është jeta e njeriu dhe jeta e të gjitha krijesave të tjera. Mendja e njeriut dhe vetë jeta e njeriu janë krijuar për të qenë të varura ndaj kohës. Ngase njeriu lind, rritet, zhvillohet, me kalimin e kohës plaket dhe i vjen fundi i jetës, pra fundi i kohës së tij në këtë botë. Çdo gjallesë dhe çdo krijesë ka nevojë për kohën dhe vendin. Çdo krijesë ka Krijues, çdo krijesë ka qëllimin e krijimit, çdo qëllim ka Krijues.

Kur'ani e vlerëson kohën sipas karakteristikës së vet, duke cekur vlerat e veçanta të kohës. Koha në Kur'an është cekur si veti "vepruese dhe aktive" vetëm për një moment të caktuar p. sh. "hin", "një kohë e caktuar"¹ apo "ke lamhi'l basar", "sa hedh një shikim"² apo edhe me një emër të veçantë sikurse është "Dehr", "periudhë kohore", si dhe me emra të tjerë.

Prandaj pasuria më e madhe e njeriut është jeta dhe koha e tij. Jeta e njeriut pakësohet për çdo frymë që merr, për çdo minutë që e kalon. Me kalimin e kohës njeriu udhëton për të dhënë llogarinë e tij për të gjitha mirësitë që ka shfrytëzuar. Sepse jeta, koha apo dhe gjymtyrët e njeriut janë amanete të Allahu, për të cilat njeriu është përgjegjës sa i takon mënyrës së përdorimit të tyre. "Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar."³ "Secili njeri është peng i asaj që ka punuar"⁴ kështu njeriu në ditë e gjykimit do t'i kthej amanetet, por e tij do të jetë vetëm ajo që ka punuar në këtë botë.

Koha ecën pa marrë parasysh se çfarë bën njeriu. Nëse ai e shfrytëzon kohën në të mirë, të mirën do të gjejë; nëse e shfrytëzon në të keqen, të keqen do ta gjejë. Nëse nuk është shfrytëzuar pa dyshim se i është bërë padrejtësi kohës dhe vetvetes. Sepse njeriu jo vetëm që është përgjegjës për kohën që e kalon, por ai do të japë llogari edhe për oksigjenin, edhe për frymën që shfrytëzon. Njeriu jep llogari për tri frymët; për frymën nga e merr, ku i shkon ajo dhe ku e kthen. Sepse fryma që ai merr kalon nëpërmjet mushkërive, pastron gjakun e njeriut, fryma që njeriu merr është e pastër, vendi ku do të shkojë duhet të jetë i pastër moralisht dhe duhet ta kthejë po ashtu të pastër tek krijuesi i saj.

Për njeriun koha është një prej dhuratave dhe e begative që Allahu xh.sh. i ka dhënë, edhe pse njeriu nuk ia di vlerën; mirëpo ajo është më e vlefshme se sa pasuria, sepse pasuria e humbur ka gjasa edhe të rikthehet, ndërsa koha e humbur nuk mund të kthehet më. Kësisoj humbja e kohës është humbja e vërtetë. Allahu në Kuran thotë:

"Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët:"

1. Ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit,
2. Ata të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë),

Ata të cilët i shmangen punëve që nuk kanë vlerë, fjalëve të kotave, debateve pa vlerë, punëve që nuk kanë dobi për besimtarin. Në ajetin e lartpërmendur përgëzohen besimtarët dhe tregohen cilësitë e të shpëtuarve, që ceken në rend të parë, pra ata të cilët falin namaz me kujdes, e menjëherë pas tyre vijnë ata që i shmangen të kotës. Po ashtu edhe ai që nuk i shmanget së kotës ësh-

1. Enbija, 111; Saffat 174, 178.

2. Nahl, 77.

3. Nexhm, 39.

4. Tur, 21.

Dy begative nuk ia dinë vlerën shumica e njerëzve: shëndetit dhe kohë së lirë.

të duke harxhuar nga thesari i çmueshëm, pra nga jeta, nga koha e tij. Pejgamberi a.s. tregon se *“Nga bukuritë e Islamit (myslimanit) është braktisja e çështjeve të pa vlerë.”*⁵ Sepse për besimtarin koha është më e vlefshme se sa të merret me punët që nuk i përkasin atij. Pejgamberi a.s. tregon se njeriu do ta harroj vlerën e kohës, apo nuk do të dijë vlerën që ajo e ka, sepse natyra e njeriut është e tillë që gjërat të cilat posedon që nga lindja nuk arrin t’i vlerësojë. Nëse koha do të ishte gjë konkrete që mund të shitej, ajo do të ishte sendi më i shtrenjtë në botë. Po ashtu, fjala është edhe për shëndetin e njeriut, kur Pejgamberi a.s. thotë: *“Dy begative nuk ia dinë vlerën shumica e njerëzve: shëndetit dhe kohë së lirë.”*⁶

Njerëzit që kanë më shumë nevojë për ta sistemuar kohën janë ata që janë të punësuar dhe të ngarkuar me përgjegjësi, sepse nëse koha nuk sistematizohet atëherë punët përplasen me njëra-tjetrën dhe obligimet duken më shumë se sa koha. Vlerën e kohës së lirë e kuptojnë njerëzit që janë të punësuar e të cilët mundohen ta ndajnë kohën edhe për obligime fetare ditore. Sepse po mos ta bëjë këtë, atëherë do të jetë koha ajo që do ta sistematizojë atë. Sepse koha nuk përsëritet, nuk zgjatet, nuk ndalet, përkundrazi ecën vetëm përpara. Atëherë njeriu duhet ta shfrytëzojë atë. Formula kryesore që ia mundëson njeriut të ketë sukses në jetë, është që ta shfrytëzojë kohën maksimale, dhe ta sistematizojë kohën e tij ndaj gjërave elementare, ditore, obliguese, familjare etj. Nëse nuk sistematizohet, atëherë do të jetë koha ajo që do ta sistematizojë njeriun, por atëherë gjithçka do të jetë në favor të kohës.

Për njeriu e sinqertë që e di Krijuesin e tij dhe e kupton fshehtësinë e ekzistencës së tij në këtë botë, nuk ka asgjë më të vlefshme se koha; ai bëhet kujdestar i saj dhe e shpenzon atë me kujdes të madh, sepse bashkë me çdo pjesë që kalon nga minuta e njeriut kalon edhe pjesa e

5. Muvatta, Husnu'l-Huluk, 3; Tirmidhi, Zuhd, 11; İbn Maxhe, Fiten, 12.
6. Buhari, Rikak, 1; Tirmidhi, Zuhd, 1; İbn Maxhe, Zuhd, 15.

jetës së tij, edhe pse njeriu mund të ketë jetuar shumë gjatë. Nuhu a.s. thuhet se ka jetuar me shekuj, kishte jetuar një mijë vjet para tufanit dhe një mijë pas tufanit dhe kur i erdhi engjëlli i vdekjes e pyeti: Si tu duk jeta? Nuhu a.s. tha: Si një shtëpi me dy dyer, hyn nga njëra derë dhe del nga tjetra. Kjo është karakteristika e kohës: kur çast kalon, nuk mund të kthehet më. Kështu që për njeriun çdo çast është më i vlefshëm se çdo gjë.

Për të vërtetuar rëndësinë e vlerës së kohës, Allahu xh.sh. u betua në pjesët e saja të veçantë, si betimi në natën,⁷ ditën,⁸ diellin, dritën,⁹ agimin,¹⁰ paraditen,¹¹ ose në vetë kohën: *“Pasha kohën”*¹²

Pa dyshim që betimi i Krijuesit në krijesë bëhet për t’i tërhequr vëmendje ndaj asaj që betohet. Mirëpo pas betimit, Allahu tregon se *“njeriu është në një humbje të sigurt”*.

Si mund të jetë njeriu në humbje të sigurt? Me kalimin e çdo sekondi njeriu është në humbje. Pasi që koha është jeta e njeriut. Me kalimin e kohës çdo njeriu pa dallim i shkurtohet jeta, çdo njeri ka fundin e sigurtë. Atëherë ne të gjithë jemi në humbje, sepse kalimi i kohës është investim nga jeta e njeriut. Mirëpo Allahu i klasifikoi dhe nga të gjithë që ishin të humbur përjashtoi vetëm:

1. Ata që besuan në Allahun xh.sh.
2. Ata që bënë vepra të mira
3. Ata që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen së vërtetës
4. Ata që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm¹³

7. Fexhr, 4; Shems, 4; Tekvir, 17.

8. Lejl, 1-2;

9. Shems, 1.

10. Fexhr, 1

11. Duha, 1.

12. Asr, 1.

13. Asr, 1-3.



Kujdesi gjatë faljes së namazit!

Shejketin Ismaili

Allahu në Kuranin famëlartë thotë: “Vazhdoni rregullisht namazet (faljet), dhe atë namazin e mesëm, dhe ndaj Allahut të jeni respektues (në namaze).” (Bekare 238)

“Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz, vërtet, ajo është e madhe (e vështirë), por jo për ata që kanë frikë (Zotin).” (Bekare 45)

“Me të vërtetë namazi është shtylla kryesore praktike e fesë Islame dhe përlësia gjatë tij është një prej kushteve kryesore që namazi të jetë i plotë. Armiku i Allahut, Iblisi është përбетuar se do t'i mashtrojë bijtë e Ademit dhe do t'i devijojë nga rruga e drejtë deri në ditën e gjykimit dhe thotë: “Mandej, do tju sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjesh që të falenderon (të besojnë).” (El – A`raf- 17)

Një prej kurtheve më të rëndësishme të shejtanit, është largimi i njerëzve prej namazit me anë të vesveseve, me qëllim që t'i largojë nga të kënaqurit në namaz dhe prej qetësisë që shkakton namazi në shpirtin e tij. Qëllimi i tij është që t'i privojë njerëzit nga shpërblimi i premtuar. Përlësia është gjëja e parë të cilën Allahu do ta humbë nga toka dhe do ta largojë nga zemra e njerëzve. Koha në të cilën jetojmë është afër ditës së gjykimit, ashtu që fjalët e Hudhejfs janë pikërisht për ne: “Gjëja e parë që do të largohet nga feja juaj është përlësia, përderisa gjëja e fundit e cila do të humbë është namazi. Do të falen njerëz të cilët në zemrat e tyre nuk kanë aspak mirësi dhe do të vijë koha kur do të hysh në xhami e nuk do të shohësh asnjë të devotshëm”.

Mendimi i shumicës së dijetërëve islamë për përlësinë është se ajo është vaxhib. Duke theksuar ajetin e lartpërmendur të sures Bekare, Ibn Tejmije thotë se ky ajet tregon qortimin e atyre të cilët nuk janë të përlur. Qortimi zë vend vetëm në ato raste kur ka refuzim të obligimeve apo bërje të veprave të ndaluara. Sipas kësaj, nëse ato nuk posedojnë përlësi, duhen qortuar, dhe kjo tregon se përlësia është vazhib. “Është e sigurtë që kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përlur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit” (Muminun, 1-2) “Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë Firdeusin dhe ata janë përgjithmonë”. (Muminun, 10-11)

Allahu në Kuran thotë: “Është e sigurt që kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përlur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit” (El – Mu`minun 1-2). D.m.th. janë të qetë në namazin e tyre dhe kanë frikë nga dënim i Allahut. Me fjalën përlësi kemi për qëllim: qetësinë, dinjitetin, mosnxitim, nënshtimin dhe modestinë. Gjëja që ia mundëson njeriut përlësinë në namaz është frika ndaj Allahut dhe vetëdija se Ai është mbikëqyrës. Transmetohet se Muxhahidi ka thënë: “Repekti në namaz d.m.th. rukuja e plotë, përlësia, ulja e shikimit dhe nënshtimi i gjymtyrëve nga frika e Allahut”. Vendi i përlësisë është në zemër, por rezultati i tij shihet në gjymtyrë. Të gjitha pjesët e trupit i nënshtrohen zemrës, e kur të priset përlësia e zemrës me huti dhe vesvese, padyshim që do të priset edhe adhurimi i gjymtyrëve. Zemra është si mbret, e gjymtyrët janë ushtria e tij, të cilët e respektojnë për çdo urdhër që vjen nga ai, qoftë ai i mirë apo i keq.

Përlësia në namaz arrihet kur zemra nënshtrohet plotësisht dhe njeriu përqëndrohet kryesisht në namaz; gjith-

çka tjetër harrohet dhe lihet anash. Vetëm atëherë ai gjen qetësi dhe kënaqësi në namaz, gjë të cilën gjë e vërteton edhe pejgamberi a.s.: “Kënaqësia e zemrës sime është në namaz.” Një nga dobitë që ka njëri prej përlësisë, është lehtësimi i namazit. Sa më shumë që robi të ndjejë ëmbël-sinë e namazit, aq më tepër do të jetë i lidhur me namazin dhe kjo varet nga imani i tij.

I dërguari i Allahut a.s. ka qënë i qetë gjatë veprimit në namaz dhe nuk nxitohej. Po ashtu, ai na ka urdhëruar neve që të veprojmë kështu; “Askush nga ju nuk do ta plotësojë namazin deri sa të mos veprojë kështu”. Transmeton Ebu Katade r.a. se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Vjedhësi më i madh është ai që vjedh nga namazi i vet”. Dikush pyeti: O i Dërguari i Allahut, si është e mundur që dikush të vjedhë nga namazi i vet?! Ai a.s. u përgjigj: “Duke mos plotësuar mirë rukunë dhe sexhden” (Ahmed dhe Hakim).

I dërguari i Allahut ka thënë: “Kujtojeni vdekjen në namazin tuaj, sepse ai që mendon për vdekjen gjatë namazit, sigurisht që do ta bëjë atë sic duhet dhe e fal këtë namaz sikur të ishte namazi i fundit.” E ngjashme me këtë është edhe porosia e Pejgamberit a.s drejtuar Ebu Ejub Ensariu: “Kur të falesh, falu sikur je duke u ndarë nga kjo botë.” (Ahmedi). Pra secili namaz duhet të falet sikur të ishte namazi i fundit, e padyshimtë gjithë do ta lëmë këtë botë dhe një nga namazet do të jetë i fundit. Prandaj është e domosdoshme përlësia në cdo namaz, sepse mundet që pikërisht ai të jetë i fundit.

Gjithashtu, duhet të mendohet rreth ajeteve kuranore dhe lutjeve që themi gjatë namazit. Kurani është shpallur që të mendojmë për atë që është shkruar në të. Allahu i madhëruar thotë: “Ky është libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë që t’i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ato që kanë mend.” (Sad 29). Për të menduar rreth ajeteve kuranore duhet të posedojmë dituri dhe t’i kuptojmë këto ajete që lexojmë gjatë namazit, domethënia e të cilave mund të na prekë thellë në shpirt, ashtu që të na pikojnë lot.


Te besimtarët duhet të ekzistojë bindja se Allahu i lartësuar i përgjigjet lutjes. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Allahu i lartësuar thotë: “E kam ndarë namazin mes Meje dhe robit tim në dy pjesë dhe robit tim i takon ajo që e ka kërkuar. Kur thotë: Të falenderohem ty Allah, Zot i botërave – Allahu i përgjigjet: Robi im mu falenderua; Kur thotë: Mëshiruesi, Gjithmëshirshmi – Allahu përgjigjet: Robi im më lartësoi; Kur robi thotë: Zot i ditës së Gjykimit, Allahu thotë: Robi im më lavdëroi; Kur robi thotë: Udhëzova për në rrugën e drejtë, në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër

“Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz, vërtet, ajo është e madhe (e vështirë), por jo për ata që kanë frikë (Zotin).”

(Bekare 45)

vetes tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën vetën, Allahu thotë: Kjo i takon robit tim dhe do t’i jap atë që mu lut.” Ky hadith është me vlerë të madhe sikur ta mendonte secili njeri gjatë namazit, padyshim se do të arrinte përlje të plotë. E si ka mundësi të jetë ndryshe, kur robi i di dhe e ndjen se Zoti i vet e dëgjon, i përgjigjet dhe ia pranon lutjen. Patjetër që duhet të mundohemi që Zotit tonë t’i drejtohem me lutje në mënyrën më të mirë, sepse i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kur dikush nga ju është në namaz, ai flet me Allahunë e lartësuar, prandaj le të ketë kujdes se si i drejtohet.” (Ebu Davud)

Kur njeriu ngrihet për të falur namazin, shejtani ndjen xhelozi të madhe, sepse ai që falet i afrohet Zotit të tij, gjë që e pengon dhe e mërzhit shejtanin. Për këtë shkak, ai mundohet që ta largojë nga namazi dhe përdor mashtrimet e tija, duke u munduar ta nxisë ta harrojë, apo t’ia rëndojë me mënyrat e tij të shumta. Pas këtyre mashtrimeve, njeriu fillon ta konsiderojë namazin si një gjë më pak vlerë, e lë pas dorë dhe e braktis plotësisht namazin. Nëse shejtani nuk arrin ta realizojë këtë qëllim dhe njeriu falet duke e injoruar shejtanin e duke vazhduar me falje, në këtë rast armiku i Allahut do ta vazhdojë luftën, duke i sjell ndër mend gjëra për të cilat nuk ka menduar para se të hyjë në namaz, me qëllim që ta hutojë njeriun dhe t’ia humbasë përqëndrimin. Kështu, zemra e tij nuk do të jetë më e përqëndruar në namaz, gjë që do t’ia humbë shpërblimin e premtuar, sepse atë shpërblim e fiton vetëm ai, zemra e të cilit është me të vërtetë e pranishme në namaz. Dhe kështu, njëri do ta kryejë namazin duke mos e zvogëluar barrën e mëkateve. E ne e dimë mirë se namazi i shlyen mëkatet vetëm atëherë kur ai bëhet sipas rregullit. I dër-



“Nuk ka musliman i cili, kur hyn koha e namazit merr abdest mirë, posedon përlësi të plotë, rukunë e bën ashtu sic duhet, e kjo të mos jetë shpagim për të gjitha mëkatet e tija të mëparshme, përpos mëkateve të mëdha, dhe kjo vlen për të gjithë jetën.”

(Muslimi)

guari i Allahut a.s na ka mësuar se si ta luftojmë shejtanin dhe si të lirohemi nga vesveset e tija. Ebul-A`asi transmeton se ka thënë: O I dërguari i Allahut, shejtani më pengon në namaz dhe unë filloj të hutohem dhe të gaboj në lexim. I Dërguari i Allahut iu përgjigj: “Ai është shejtani me emrin Hinzeb. Nëse e ndjen prezencën e tij, kërko mbrojtjen prej Allahut (Thuaj eudhu bilahi min Hinzeb) dhe pështyj tri herë në anën e majtë.

I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Nuk ka musliman i cili, kur hyn koha e namazit merr abdest mirë, posedon përlësi të plotë, rukunë e bën ashtu sic duhet, e kjo të mos jetë shpagim për të gjitha mëkatet e tija të mëparshme, përpos mëkateve të mëdha, dhe kjo vlen për të gjithë jetën.” (Muslimi)

Shpërblimi për namaz varet nga përlësia e personit. I dërguari i Allahut a.s. thotë: “Robi i Allahut mund ta kryejë namazin dhe nga ajo mos t’i pranohet asgjë, përvec e dhjeta e shpërblimit, e nënta, e teta, e shtata, e gjashta, e pesta, e katërta, e treta, apo gjysma e saj.” (Ahmedi)

Vetëm ato pjesë të namazit, në të cilat njeriu ka qënë i përqëndruar do t’i bëjnë dobi. Transmetohet se Ibn Abasi ka thënë: “Nga shpërblimi i namazit do të fitoni vetëm aq sa keni qënë të pranishëm në të.”

Mëkatet do t’i falen njeriut nëse ai e fal namazin me plotësi dhe përlësi, ashtu sic thotë i dërguari i Allahut a.s.: “Kur robi ngritet për t’u falur, të gjitha mëkatet e vihen mbi kokën dhe mbi supet e tij, dhe sa herë që bën ruku apo sexhde, mëkatet i bien një nga një.”

Njeriu i cili posedon përlësi do të ndihet shumë i lehtësuar kur mbaron namazin, sepse pikërisht përlësia është burimi i lumturisë, i kënaqësisë dhe i qetësisë në këtë botë. Besimtari duhet të jetë i qetë në namaz dhe jo nga namazi. Ata të cilët e duan namazin thonë: Falemi dhe ndiejmë rehati dhe qetësi në namaz. Ashtu sic i tha i dërguari i Allahut a.s. Bilalit: “O Bilal, eja që të pushojmë në namaz”, e nuk tha të pushojmë nga namazi.

Nuk ka dyshim se biseda me Allahun e lartësuar dhe përlësia para tij forcon lidhjen mes robit dhe Zotit të vet, si dhe e shton përlësinë. Duatë janë lloje ibadeti dhe na është urdhëruar t’i bëjmë ato. Allahu i lartësuar thotë: “Luteni Zotin tuaj me përlje dhe në fshehtësi.” I dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Allahu i Lartësuar është i hidhëruar më atë që nuk kërkon (lutet) prej Allahut.” (Tirmidhiu). Transmetohet se i Dërguari i Allahut bënte dua disa herë gjatë namazit, mirëpo në vende të caktuara, sic janë sexhdeja, ulja mes dy sexhdeve, si dhe pas leximit të teshehudit. Vendi më i preferuar për lutje është kur jeni në sexhde, sepse i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Robi është më afër Zotit të vet deri sa është në sexhde, prandaj bëni më shumë lutje në të.” Dhe shton: “Mundohuni të bëni dua kur jeni në sexhde, sepse ato me siguri do të pranohen.” (Muslim) Një nga duatë që ka thënë i Dërguari i Allahut a.s. në sexhde, është: “Allahumegfir li dhenbi kullehu, dikkahu ue xhilehu ue evvelehu ue ahirehu, ue alanijjetehu, ue sirehu (Zoti im, m’i fal të gjitha mëkatet e mia të vogla e të mëdha, të kaluara e të ardhme, të hapta dhe të fshehura).” (Muslimi) Gjithashtu i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kur dikush nga ju mbaron me uljen e fundit në namaz, le t’i lutet Allahut të lartësuar që ta mbrojë nga katër gjëra: prej dënimit të Xhehenemit, prej dënimit të varrit, prej sprovavë të jetës dhe prej sprovavë të dexhalit”.

I Dërguari i Allahut a.s. na ka tërhequr vërejtjen që të mos e ngrijmë shikimin nga qielli dhe na ka ndaluar ashpër që të bëjmë këtë duke thënë: “Kur faleni mos e ngritni shikimin kah qielli, sepse ka mundësi që ta humbni të pamurit” (Ahmedi) Në një transmetim tjetër thotë: Ç’është puna me disa që ngrejne shikimin kah qielli në namaz? Gjithashtu, i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Nëse gjatë namazit u hapet goja, atëherë mundohuni të përmbaheni sa të keni mundësi, që shejtani të mos hyjë. (Muslimi) Nëse shejtani hyn, atëherë mund të ndikojë në përlësinë e personit, duke iu bashkëngjitur kësaj edhe të qeshurit e tij, kur falësit i hapet goja. Ndërkohë, mbyllja e syve gjatë

“Dy njerëz mund të falen me një xhemat, por dallimi në shpërblimet e namazit mes tyre mund të jetë si toka me qiellin. Njëri nga ata mund të jetë i kthyer me plot zemër kah Allahu i lartësuar, derisa tjetri është i pakujdesshëm dhe i harruar.”

(Mexhmu`atu-l-Fetava 22\559)



namazit është në kundërshtim me synetin e të Dërguarit të Allahut a.s., sepse ai që falet në këtë mënyrë nuk do të jetë në gjendje të shikojë në vendin e sexhdes dhe në gishtin tregues. Nuk duhet të falemi ndërkohë që sofrë është duke u shtruar, sepse i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë; “Nëse darka është gati, ndërsa ka hyrë koha e namazit, së pari hani pastaj faluni dhe mos u ngutni me ushqimin (Ibn Maxhe). Transmetohet nga Enes Ibn Malikun, se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “ Nëse dikujt nga ju i vjen gjumë teksa është në namaz, atëherë le të flejë, derisa t’i hiqet gjumi, sepse ai që falet dhe është i përgjumur, mundet që në vend që të kërkojë falje, ai do shante veten. (Buhariu) Kjo mund të ndodh gjatë namazeve të natës, në kohën e pranimit të duave dhe njeriu mundet që të bëjë dua kundër vetes dhe të mos ta kuptojë apo ta vëre. Ky hadith vlen edhe për namaze të obliguara (farze), me kusht që të jetë i sigurt se ka mjaft kohë për të kryer namazin, pasi që të pushojë.

Hasan Ibn Hatije thotë: “Dy njerëz mund të falen me një xhemat, por dallimi në shpërblimet e namazit mes tyre mund të jetë si toka me qiellin. Njëri nga ata mund të jetë i kthyer me plot zemër kah Allahu i lartësuar, derisa tjetri është i pakujdesshëm dhe i harruar” (Mexhmu`atu-l-Fetava 22\559)

Është synet të lëvizurit e gishtit tregues, edhe pse shumë njerëz e kanë lënë pas dore nga padituria. I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Lëvizja dhe drejtimi i gishtit tregues gjatë kohës së teshehudit, është më e rëndë për shejtanin se sa goditja me hekur, sepse kjo ia përkujtton robit se Allahu është Një, dhe se duhet të adhurojë sinqerisht vetëm Atë, gjë të cilën e urren shejtani, Allahu na mbroftë prej tij”

Muhaxhidi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Kur dikush nga ata (paraardhësit tanë) ngrihej për tu falur, kishte frikë ta luhaste shikimin, të lëkundej djathtas-majtas apo të mendonte për gjëra të kësaj bote.” Transmetohet se një person do të zverdhej akoma pa filluar namazi, qysh kur

merrte abdest, dhe kur i thuhej: “Kur je duke marr abdest, shohim ndryshim të madh në fytyrën tënde, ai përgjigjej: Kjo ndodh, sepse e di se para kujt do të qëndroj. Kur hyn te koha e namazit, Ibn Ebi Talibi shqetësohej dhe ngjyra e fytyrës do t’i ndryshonte. I thuhej: Çka po ndodh me ty? Përgjigjej: Pasha Allahun, erdhi koha e plotësimit të emanetit, të cilin Allahu ua ofroi qiejve dhe tokës, e ato e refuzuan ngaqë u frikësuan, e pastaj atë e pranuan në një rëzit. Vallë kush nga ne ka frikë dhe respekt ndaj Allahut të Lartësuar, ashtu sic kishin tabiinët? Është pyetur Amër ibn Abdul Kajsi: Kur je në namaz, a mendon në dicka tjetër? U përgjigj; Unë e dua namazin më shumë se cdo gjë dhe vetëm për të mendoj. Thanë: Ne, gjatë namazit mendojmë për veten tonë. Tha: A mendoni për Xhenet dhe huri? Thanë: Jo, jo, por për familjen dhe pasurinë tonë. Tha: Pasha Allahun, më shumë do të kisha dashur që të më gjuajnë me shigjeta në trupin tim se sa të mendoj për gjërat e kësaj botë gjatë namazit.

Dhikri (të përmendurit e Allahut) gjithashtu ndihmon në përforsimin e përlësisë në zemër dhe shton mirësinë dhe dobinë që fitojmë nga namazi. Pa dyshim, një nga mënyrat më të mira për t’u ruajtur një vepër e mirë, është që ajo të pasohet me vepra të tjera të mira. Kështu që nëse dikush bën dhikër pas namazit, kjo do të thotë se ai njëri vazhdon të kërkojë falje nga Zoti i vet. Në një farë mënyre, kjo është edhe kërkim faljeje, në rast se gjatë namazit të tij ka ndodhur ndonjë mosplotësim i rregullave apo i përlësisë se tij. Është shumë me rëndësi që t’u kushtohet vëmendje edhe namazeve vullnetare, sepse këto kompensojnë lëshimet që mund t’i kemi bërë në namazet farze.

Përlësia është një gjë mjaft e shenjtë dhe pjesë e rëndësishme e namazit, e cila është e pamundur të arrihet pa ndihmën e Allahut. Mosposedimi i përlësisë është me të vërtetë një fatkeqësi e madhe. I Dërguari i Allahut a.s. e lexonte shpesh duanë: “Zoti im, kërkoj mbrojtje tek Ty nga zemra në të cilën nuk ka përlësi.” (Tirmidhiu)



Vlerësimi i kohës në traditën islame

Naim Driçaj

*L*idhur me këtë temë, Allahu i madhëruar urdhëron në Kur'anin famëlartë:

“Pasha kohën! “Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt”, “Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.” (Asr,1-3)

Kjo sure e zbritur në Mekë, ka tre ajete. E veçanta e kësaj sureje është se përmban pak ajete, dhe një kuptim shumë të madh.

Komente rreth fjalës El-Asr - Koha

• Ibn Kethiri: (Asr) Koha ku ndodhin lëvizjet e njerëzve, si e mira ashtu edhe e keqja.

• Ibn Abasi: (Asr) Orë prej orëve të ditës, koha para se të perëndojë dielli.

• Ibnul Kajimi: (Asr) Koha e parë pas akshamit, ora e fundit kur terrohet dita, namazi i ikindinë.

• Raziu: (Asr) Koha ku ka gëzim e hidhërim, sëmundje e shërim, pasuri e varfëri.

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se Asr është koha në përgjithësi, siç thotë Imam Shevkani: “Allahu i Lartësuar është betuar në kohë për arsye se ka ndodhi të shumta: ndërrimi i ditës dhe i natës, errësira, drita etj.

Në librin e tij Taberaniu transmeton nga Hamad ibn Selemeh, nga Abdullah ibn Husn Ed-Daremij, se ka thënë: “Kur takoheshin dy shokë të Pejgamberit a.s.,

ata nuk ndaheshin pa ia lexuar njëri-tjetrit këtë sure, më pas përshëndeteshin me selam.”

Ky veprim tregon vlerën dhe rëndësinë e kësaj sureje, e cila në gjirin e saj përmban këshilla e porosi që kanë të bëjnë me vlerësimin e kohës, e cila është vetë jeta, dhe me imanin, durimin si karakteristikë e veçantë e myslimanit dhe veprat e mira, etj.

Fahrudin Razi në tefsirin e tij thotë: “Allahu xh.sh. është betuar në kohën, sepse ajo përmbledh të gjitha aspektet që janë pjesë e jetës njerëzore. Në të ka gëzime, hidhërimi, është shëndeti, sëmundja, pasuria, varfëria, etj”.

Imam Shafiu ka thënë: “Nëse njerëzit do të meditojnë rreth kësaj sureje, kjo do t’u mjaftonte atyre.”

Ne e dimë se kjo botë është kalimtare dhe se qëndrojmë në të për një kohë të shkurtër e të kufizuar. Çdo orë, çdo minutë, çdo sekondë është me vlerë për ne, prandaj nuk duhet ta kalojmë kohën kot.

Ibnul-Kajim el Xhevzi ka thënë: “Humbja e kohës është më e madhe se vdekja. Sepse humbja e kohës e largon njeriun nga Allahu dhe nga bota tjetër, ndërsa vdekja të largon vetëm nga kjo botë”.

Koha është jeta e besimtarit, dhe në bazë të shfrytëzimit të kohës gjykohet para Allahut xh.sh. Ai që e shfrytëzon kohën në punë të mira, ai besimtar është i lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër, ndërsa ai që e humb kohën e tij ka humb një gjë shumë të madhe.

Hasan El Basriu ka thënë: “Jeta e njeriut përmbledhet në tre ditë: E djeshmja, e këtë ditë që të ka kaluar nuk mund ta kthesh më; e nesërmja, që është një ditë që ndoshta nuk mund ta arrish; dhe e sotmja, që është dita e jote, arsye për të cilën duhet ta shfrytëzosh mirë.”

Një poet arab ka thënë: “Koha është gjëja më e shtrejtë për të cilën duhet të kujdesesh, ndërsa është gjëja më e lehtë që mund të humbasësh.”

Njeriu ka mundësi ta rikuperojë çdo humbje, ndërsa humbjen e kohës asnjëherë nuk ka mundësi ta zëvendë-

sojë.

Hasan El-Basriu ka thënë: “ Në çdo ditë të re, një zë thërret: O bir i Ademit, unë jam ditë e re, dëshmitare për punën tënde, prandaj më shfrytëzo, sepse unë nuk do të kthehem më deri në Ditën e Kijametit”.

Muhasiu, Zoti e mëshiroftë, ka thënë: “Po të ishte e mundur që koha të ishte mall tregtie dhe do të mund të blihej, tërë pasurinë do ta kisha shpenzuar për të blerë kohë të lirë “.Kur e kanë pyetur: Prej kujt do ta kishe blerë atë kohë të lirë? Është përgjigjur: Prej neglizhencës!

Transmetohet nga Buhariu se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Dy prej begative apo nimeteve të Zotit që shumica e njerëzve nuk ia dinë vlerën: shëndetit dhe kohës së lirë.”


Pra, Pejgamberi a.s. i ka përmendur këto begati sepse shumica e njerëzve nuk i shfrytëzojnë ato. Shohim shumë njerëz që Allahu xh.sh. iu ka dhënë shëndet, ndërsa ata e shfrytëzojnë në haram. Ndërsa, të tjerëve Allahu iu ka dhënë kohë të lirë dhe nuk e shfrytëzojnë atë në punë të mira.

Hasan Basriu ka thënë: “Nëse nuk e shfrytëzon kohën tënde, ajo ka për të të ndëshkuar ty”. “O biri i Ademit, dita jote është mysafiri yt, andaj prite mirë atë!”

Allahu xh.sh. na ka treguar në Kur’an se si muslimani duhet të jetë i kujdesshëm me kohën e tij. Allahu xh.sh. ka caktuar ibadete që njeriu patjetër duhet t’i kryej në kohë të caktuar, psh: namazin, agjërimin, haxhin etj. Pra, nëse dikush duhet të kujdeset për kohën e tij më së shumti, në këtë ka përparsi muslimani. Përmes këtyre

ibadeteve në kohë të caktuar, Allahu na tregon se si muslimani duhet ta organizojë jetën e tij. Allahu xh.sh. urdhëron: “Namazi është obligim (për kohë) i caktuar për besimtarët.” (En-Nisa, 103) Pse Allahu xh.sh. e veçoi namazin në Kuran me fjalën “kohë e caktuar”, duke pasur parasysh se edhe agjërimi është në kohën e caktuar, haxhi është gjithashtu në kohën e caktuar.

Allahu xh.sh. veçoi na-



mazin për arsye se namazi është një prej ibadeteve që përsëritet më së shumti në jetën e muslimanit. Përmes kryerjes së namazeve, muslimani mundet edhe të programojë jetën e tij të përditshme.

Çdo ditë e jetës sate është një faqe e biografisë sate, kujdesu ta shkruash mirë.

Njerëzit nuk krahasohen mes tyre me jetëgjatësinë e tyre, por me veprat e tyre. Abdullah ibn Mesudi r.a. ka thënë: “Unë e urrej njeriun e lire, kur e shoh që nuk punon as punë të dunjasë, as punë të ahiretit.”

Një herë disa të rinjë ishin duke punuar me një projekt dhe një prej dijetarve ishte përgjegjës për ta. Një ditë, ky dijetar sheh njërin prej të rinjve duke pastruar dhe e pyeti. Ç’ka bënë këtu. Iu përgjigj djaloshi: Po i ndihmoj vëllezërve, po fshij. Hoxha i tha: Këtë po e shoh, por çfarë po bën tjetër? Asgjë tjetër, iu përgjigj djaloshi. Atëherë hoxha i tha: Angazhoje gjuhën tënde me dhikër sa të jesh duke fshirë. Punon dhe bën dhikër në vend që të fitosh një shpërblim, punon dhe bën dhikër kështu edhe mbjell pemë në xhennet. Sa kohën e humbim pa e përmendur Allahun. Besimtari i mirë punon me trup dhe në të njëjtën kohë e përmend Allahun, dhe kështu mbjell shumë pemë në xhennet.

Ebu Jusufi nxënësi i Ebu

Hanifes, Zoti e mëshiroftë, ka qenë tepër i angazhuar në shfrytëzimin e kohës. Kur ishte në shtratin e vdekjes njëri prej nxënësve e viziton, ndërsa ai e kishte humbur vetëdijen. Kur kthjellohet, i thotë menjëherë nxënësit të tij: Tani do të diskutojmë një çështje të haxhit. Haxhiut i lejohet ta kryejë haxhin në këmbë, apo hipur në ndonjë kafshë?

Nxënësi i thotë: Imam! A mos është ora e mësimit kjo? Ebu Jusufi i thotë : O biri im! Për Zotin, nëse më mbetet një minutë i jetës sime, atë do ta kisha shpenzuar në shërbim të Islamit dhe muslimanëve.

Amir bin Kajsi: Një ditë, një njeri e ndalon dhe i thotë : Dëshiroj të flas me ty. Amiri i thotë: Ndale diellin! Pra, Amiri kishte për qëllim ndaljen e kohës, sepse nëse do të ndalej koha do të ndalej edhe ai, sepse nuk ka

dëshiruar të shpenzojë kohë pa nevojë. Shikoni pra se çfarë rëndësie i ka dhënë kohës.

Transmeton Ibn Abasi r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë : “Shfrytëzo pesë çështje para se të zëvendësohen me pesë çështje tjera :

- Jetën para vdekjes;
- Shëndetin para sëmundjes;
- Kohën e lirë para se të bllokohet;
- Rininë para pleqërisë dhe
- Pasurinë para varfërisë”. (Sahih, Albani)

Në një orë të vjetër në Oxford shkruan: Koha po kalon, por për të jepet llogari”. Dhe vërtet, të gjithë ne jemi përgjegjës për kohën në të cilën jetojmë. Askush prej nesh nuk e di se kur do të vijë çasti i vdekjes.

Kur hyj në bibliotekë dhe kur shoh veprat e ndonjë shkrimtari, pyes veten: Si është e mundur të ketë shkruar aq libra për një kohë aq të shkurtër? Si ka arritur ky njeri ta shfrytëzojë kohën në mënyrë kaq të mençur?

Lexojmë për Imam Gazaliun: Është lindur më 450 sipas Hixhrit dhe ndërroi jetë në vitin 505 sipas Hixh-

rit. Shkroi një bibliotekë të tërë, rreth 700 vepra. Pjesën më të madhe e përbëjnë mesazhet e pejgamberëve (broshura-risalet) të shkruara në 50-100 faqe. Mirëpo ai ka shkruar edhe një varg veprash shumë të rëndësishme nga përmbajtja dhe vëllimi. Komentin e tij e përbëjnë 15 libra të mëdha, ”Ihja-ulumid-din” 4 libra, ”Mustafa” 2 libra, ”Vesit” 2 libra etj. Jetoj rreth 55 vjet

Thuhet se Jahja bin Muaz ka thënë: “Nata është mjaft e gjatë, mos e shkurto me gjumin tënd. Dita është e shenjtë, mos e turbullo me gjynahet tua!”

Katër gjëra nuk mund të kthehen kurrë më: Fjala e thënë, shigjeta e hedhur, koha e kaluar dhe rasti i pashfrytëzuar (fjalë e urtë arabe).

Loti që nuk u pa!

Hivzi Zegiri

Brendësia e njeriut, ndjenja e madhe për... iu pa në sytë e mprehtë dhe shikimin e tij të mërziur. Erdhi në mes të natës në kasollen e tij të vogël në të cilën nuk kishte dëshirë të hynte. Me vete po pëshpëriste dhe qante një hall të madh. E kishte zakon që sa herë hynte në shtëpi, në kasolle, afrohej pranë dritares. Asnjëherë nuk kishte arritur të hynte në të e të mos kishte rënë terri, pra pa u shfaqur yjet “në faqen moderne të qiellit”.

Qante, vazhdimisht qante! Të qarat e gjata e kishin kërrusur dhe i kishin dhënë një imazh pleqërie, apo ndoshta jo të qarat!?

Shikoi majtas dritares, brenda dhomës, pa shtratin e tij dhe një mbulesë prej pëlhure të shtrenjtë që tani i kishte humbur shkëlqimi e bardhësia. Dikur ajo pëlhurë shkëlqente si diamant, por nuk bën as pesë pare. Shkoi në shtrat, u ul dhe tha:

- Kush je ti?

- Unë jam Muharremi!

- Nga je? Nga ke ardhur? Çfarë kërkon këtu?!

- Unë vij nga fushëgropa e madhe e Ballkanit. Kam ardhur për të punuar dhe... uli kokën dhe filloi të qante.

Përballë kishte derën në të cilën kishte hyrë e kishte dalë plot njëzet vite të zeza rresht, që po të shkruheshin do të kalonte rekordin e veprave shkencore e artistike që janë shkruar deri më tani.

- Çka dhe?! Çka?! Fol?!

- Unë..., kam një hall.

- Unë kam më shumë halle se ti, prandaj m'u hiq qafe. Dil jashtë!

Uli kokën dhe u kthye kah dera. Iu afrua derës, e hapi dhe doli. Shikoi lart dhe ndenji me shpresën se një udhëtim kohe do ta çonte në vendin ku për herë të parë i kish prekur balli. Nga malli u kthye brenda, u shtri në shtratin e

papastër dhe përsëri tha:

- E ç'hall ke o i shkretë!? Prapë u ktheve. Unë të përzura! Çfarë burri je ti që kur del nga një derë për të mos u kthyer dhe prapë kthehesh?! Mburravec?! Unë moti kohë kam dalë nga një derë dhe nuk jam kthyer, e as që kam ndërmend të kthehem. Në dashtë koha le të më kthejë!

Për njëzet vjet me radhë, për njëzet vite të plota, për njëzet vjet të zeza, ai fliste me veten kështu çdo natë e herëherë edhe duke i ngatërruar rolet. I fliste vetes dhe shante. Shpesh herë një personazh e përzinte, për ta kthyer tjetrin në shtëpi, por, ai prapë kthehej në dhomë.

Djemtë i janë bërë burra, kanë fëmijë. vajzat i janë martuar, i janë bërë gra, kanë fëmijë. Qante, qante i shkreti!

Buf...! - diçka në mendjen e tij.

- Çfarë kam unë; pse më duket si kasolle i gjithë ky pallat?! Askush nuk është më i pasur se unë. Unë jam burrë e ndër të tjera jam shqiptar!

Ishte një burrë i gjatë, me ballë të gjerë, me mustaqe në të cilat nuk kishte mbetur asnjë qime e zezë. Shpinë e përulur pranë pasurisë që nuk e gjeti, me unazat e kurrizit që i dukeshin mbi këmbë kush e di nga sa larg. Flokë të zbardhur nga malli, ballin plot rrudha, vetulla të përkulura po si kurrizi; asnjë bukuri rinore me vete, asnjë vlerë.

Një lajm i zi, i hidhur, ia ndërroi mendimin menjëherë; mendim ky se nuk e lë kasollen e Evropës për tu kthyer në shtëpi. I kishte vdekur gruaja por, si alamet patrioti që ishte e mbajti veten. E mbajti veten për të mos u poshtëruar prej vetes, sepse të tjerët qysh moti e kishin pështy në fytyrë.

Si çdo herë që dilte e hynte në shtëpi, kasolle apo pallat, edhe herën e fundit doli nga shtëpia me natë. Me kokën ulur..., qante..., asnjë pikë loti në sy. Zemra i kalbej, por kësaj here kishte marrë edhe tiganin me vete.



Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshurshmit, Mëshurplotit!

1.Pasha kohën! 2. Me të vërtetë, njeriu është në humbje, 3.përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri tjetrit durimin.

Surja hapet me një betim hyjnor për kohën, sepse ajo është një nga krijesat më madhështore të Allahut dhe për shkak të rëndësisë që ajo paraqet në jetën e njeriut.

Sipas transmetimit të Ibn Xheririt, Hazreti Aliu radijallahu anhu, ka thënë: “Pasha fatkeqësitë që koha sjell njëra pas tjetrës! Pasha fatkeqësitë që ruajnë njëra tjetrën! E vërteta është se njeriu është në humbje të plotë deri në fundin e kohës.”

Urtësia e të betuarit në kohë është një paralajmërim në lidhje me fatkeqësitë dhe ngjarjet e mëdha, si dhe me ndryshimet e thella që koha do të sjell në jetën tonë.

Koha përmban të gjitha gjërat e çuditshme dhe të mahnitshme. Prandaj ajo është quajtur “Ebul Axheb”, që do të thotë “Babai i çudisë”. Çdo situatë e ngjarje e përgjithshme ose e përveçme, e njohur ose panjohur, e hidhur ose e ëmbël, ndodh pikërisht në të. Shtetet, popujt, të mirat, fatkeqësitë shfaqen në kohë, rriten në të dhe pikërisht aty shuhen dhe mbesin. Koha është “gjëja më e çuditshe ndër të gjitha gjërat e çuditshme”. Ajo është parametri i ndryshimit që lëvizë dhe ecën pa u ndalur, si kontekst i çdo gjëje, por që në të njëjtën kohë është edhe një proces qëndrimi dhe konstanteje.

Një poet arab thotë:

*Vërej se koha është si një anije,
Vërshon drejt vdekjes së bashku me ne
E lëvizjet e saj nuk mund t'i shquajmë*

Sa më shumë që kalon koha, aq më tepër njeriu i afrohet humbjes, nëse nuk plotëson katër kushte që kanë të bëjnë me përsosjen e tij personale dhe përsosjen e të tjerëve: besimi tek Allahu dhe te gjithçka që Ai ka urdhëruar të besohet; kryerja e veprave të mira, qofshin këto fizike apo shpirtërore; këshillimi i të tjerëve me këtë të vërtetë dhe këshillimi që të durojnë në përpjekjen e tyre për t’iu përmbajtur urdhërave të Allahut dhe për të duruar sprovat e dhembshme dhe të vështira që mund të ketë përcaktuar Ai.

Një Hadith

Transmetohet nga ibni Abbasi radijallahu anhu se

Resulullahu, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Ka dy mirësi përballë të cilave shumica e njerëzve qëndrojnë indiferent: Shëndeti dhe koha e lirë.”

(Buhari, Rikak 1. Gjithashtu shih Tirmidhi, Zuhd1; Ibni Maxhe, Zuhd 15)

Dy fjalë komenti:

Për të kryer adhurimet, për t'i shprehur Zotit përvulje, për të bërë mirë dhe për të qenë të dobishëm, rëndësia e shëndetit dhe kohës është e padiskutueshme. Dy mirësitë që njeriu mendon se ka për t'i pasur gjithmonë, por që një ditë do t'i merren, janë pikërisht shëndeti dhe koha. Shprehjet që përdorim në gjuhën tonë dhe fjalët e ndryshme popullore si “Kryet e çdo pune është shëndeti”, “me shëndet” etj, tregojnë rëndësinë e padiskutueshme të shëndetit. Kryesorja është që të mund ta vlerësojmë shëndetin jo thjeshtë me fjalë të bukura, por duke e shfrytëzuar atë ashtu siç duhet.

Në pikëpamjen e fesë dhe të punës, koha e lirë është një mirësi që humbet dhe është e vështirë të rigjehet. Sidomos në qytetet e mëdha, ku jeta është e zhurmshme, e shpejtë, e përfshirë në lëvizje të pareshtur dhe e lodhshme, njerëzit ia dijnë shumë më mirë vlerën kohës së lirë. Njeriu i këtij shekulli, i cili ditën e kalon duke ngarendur ndërsa natën e përqendron vëmendjen te televizioni, ka shumë nevojë ta shfrytëzojë kohën e lirë për zhvillimin e tij shpirtëror.

Aq sa shfrytëzohet koha e lirë dhe shëndeti, po aq është edhe rezultati në përpjekjen tonë. Në të kundërt, kauzën e kemi krejt të humbur. Le të mos harrojmë se asnjë prej sekondave që kalojnë nuk do të mund ta kthejmë më prapa. “Koha është si shpata”, nëse nuk tregohet kujdes i veçantë ndaj saj, ajo të pret. Gjithashtu edhe shëndeti bën pjesë në ato mirësi vlera e të cilave kuptohet vetëm pasi i humbasim.

Këto dy mirësi duhen përdorur me kujdes e përpikmëri në rrugën e afrimit me Allahun e Lartmadhëruar, sepse pikërisht këto janë dy kushtet bazike dhe themelore që na sjellin suksesin e sigurtë në kauzën tonë, duke na bërë diferencën me të tjerët.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi

1. Vlerësimi i kohës dhe i shëndetit e shpie njeriun në lumturinë e kësaj bote dhe në atë të botës tjetër.
2. Duke e shpërdoruar kohën dhe shëndetin, shumë njerëz e humbasin vlerësimin për to.
3. Islami kërkon që të vlerësohen në masën e duhur koha dhe shëndeti. Sepse kapitali i jetës përdoret vetëm një herë.

SHPËRDORIMI I KOHËS

Të gjitha mirësitë e dhëna njeriut, si të dhuruarat ashtu edhe ato që i fiton me mundin dhe djersën e vet, janë një dhunti e Zotit pasi është vetë Zoti që i krijon ato dhe i jep forcë njeriut për t'i fituar ato, si nevoja kryesore për të. Nisur nga kjo, njeriu nuk duhet të harrojë se mirësitë janë dhunti e Allahut. Ai duhet të jetojë me vetëdijen se këto janë çështje për të cilat nesër do të japë llogari. Në një ajet Kuranor thuhet:

“A menduat se Ne u krijuam kot dhe se nuk do ktheheni te Ne?” (Muminun, 115)

Për rrjedhojë, duhet të mendojmë dhe gjykojmë se nuk jemi plotësisht të lirë në përdorimin e mirësive materiale dhe shpirtërore dhe se këto jemi të detyruar t'i përdorim në përputhje me urdhëresat hyjnore.

Në një tjetër ajet Kuranor na bëhet e ditur përsëri llogaria e madhe dhe na theksohet përgjegjësia që kemi: **“Pastaj, në atë ditë do të**

pyeteni për të mirat (e dynjasë).” (Tekathur, 8)

Pra, ashtu siç ka përcaktuar rrugët e fitimit të mirësive të dhëna, Krijuesi i gjithësisë ka vendosur po ashtu disa rregulla dhe parime që duhen plotësuar në përdorimin e këtyre mirësive dhe dhuntive, të cilat i ka përmbledhur në “haramë dhe hallalle”. Edhe shpenzimi i tepërt është një nga këto haramë që të çon në humbjen e mëshirës së Allahut dhe të nxit të marrësh dënimin hyjnor. Në një ajet Kuranor thuhet:

“... Mos e teproni në shpenzim , pasi Allahu nuk i do ata që shpenzojnë tepër.” (Enam, 141)

Një nga gabimet më të mëdha që bën njeriu në mungesë të vetëdijes, është shpenzimi i t tepërt i kohës.

Jeta është një mirësi tepër e vlefshme, të cilën Krijuesi i gjithësisë ia jep qenies për ta jetuar një herë dhe në kohë të caktuar. Është kusht i domosdoshëm ta shfrytëzojmë kohën me veprimet më pozitive, në përputhje me vlerat e saj. Në çdo moment ka shumë punë që mund të bëhen në jetë. Por t'u japësh rëndësi atyre që janë më të rëndësishmet për momentin dhe t'i radhitësh të tjerat sipas shkallës së rëndësisë përbën një çështje me vlerë për të përdorur kohën ashtu siç duhet.

P.sh, të ushqyerit e fëmijës me qumësht është një veprim mjaft pozitiv i domosdoshëm për dhembshuri dhe mëshirë. Por të ushqyerit e fëmijës ndërkohë që në shtëpi bie flaka, është një veprim tepër negativ dhe ka

**“E kur ta kryesh (obligimin),
atëherë mundohu me adhurim
(Allahut). Dhe, vetëm te Zoti yt
përqendro synimin!”**

një përgjegjësi të madhe. Në atë moment ajo duhet të përpiqet të shuajë zjarrin qoftë edhe me një kovë ujë, pasi kjo detyrë ka një rëndësi shumë më jetike se ajo e mëparshme. Por nëse nuk tregohet e shkathët, pas një farë kohe do ta gjejë veten dhe fëmijën në zjarr.

Të vlerësosh fenë e Allahut më shumë se gjërat e tjera për hir të kohës, është një përgjegjësi e kohës.

Momentet më kuptimplote dhe më të bukura të jetës për sahabët, të cilët e vlerësuan kohën në mënyrën më të mirë të mundshme ishin ato kohë në të cilat ata transmetonin tek njerëzit mesazhin e tevhidit, njësisë. Një sahab i cili ishte në prag të dënimit me varje e falënderoi fatkeqin që i dha tre minuta kohë dhe i tha:

-Dmth kam edhe tre minuta kohë për të predikuar Zotin. Shpresoj të udhëzohesh.

Çdo besimtar e ka obligim moral dhe shpirtëror që t’ua transmetojë bukuritë e islamit një pjese të njerëzve në ditët e sotme, të cilët kanë humbur ne erozionin e imoralitetit dhe të mosbesimit, duke iu afruar atyre me një gjuhë mjaft të ëmbël.

Të shpenzosh me gjëra absurde kohën e cila është në vetvete një pasuri me vlera të pakontestueshme, do të thotë ta futësh në rrezik jetën e ahiretit. Prandaj koha është një dhunti me vlera ta pakrahasueshme me asgjë tjetër. Në suren Asr, Krijuesi i gjithësisë thotë:

“Pasha kohën! Nuk ka dyshim njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin

të jenë të durueshëm.” (Asr, 1-3)

Në këtë sure, e cila fillon me një betim për kohën flitet për një shpenzim të tepërt të kohës, e cila nuk është shfrytëzuar për ripërtëritjen e besimit, për punët e mira dhe këshillimin për të shkuar tek Zoti dhe se një gjë e tillë bëhet shkak për humbje të mëdha. Edhe fakti që flitet për raste të posaçme, për ata që nuk dinë ta vlerësojnë kohën me të drejtë është një e vërtetë e hidhur, gjë që tregon se ata janë të mashtruar në këtë drejtim.

Krijuesi i gjithësisë i këshillon robërit e vet që ta përdorin me kujdes kohën, në mënyrë që t’i shpëtojnë humbjes dhe të fitojnë shpërblimet hyjnore:

“E kur ta kryesh (obligimin), atëherë mundohu me adhurim (Allahut). Dhe, vetëm te Zoti yt përqendro synimin!” (Inshirah, 7-8)

Pra, sapo të përfundojmë një punë të mirë dhe një adhurim, të kalojmë menjëherë në një punë tjetër dhe mos t’ia lejojmë vetes të na kalojë asnjë pjesë e kohës pa u shfrytëzuar. Jeta është një mirësi e dhunti që na është dhënë për të fituar lumturinë shpirtërore. Ndërsa vdekja është si afati i pagimit të një fature huaje, e cila tregon kohën e kryerjes së veprimit. Një tregtar i jep blerësit një faturë si parapërgatitje për larjen e huasë. Afati i përcaktuar këtu është për të përgatitur sasinë që do të paguhet në këtë kohë. Jeta e kësaj bote është një kohë që na është dhënë për të fituar ahiretin dhe pëlqimin hyjnor. Ashtu sikurse një tregtar i cili nëse nuk e merr seriozisht kohën e pagesës që do të bëjë, nëse nuk përgatitet gjatë kësaj kohe dhe si përfundim në fund vihet



në siklet dhe telash, ashtu edhe njeriu është në humbje për sa kohë që nuk e përdor mirë kohën që i ka caktuar Allahu për të jetuar. Çdo njeri, që nga momenti kur vjen në jetë e ka një datë të vdekjes, koha e cila nuk dihet. Ky është pikërisht momenti i takimit me Azrailin. Edhe pse është e qartë data e pagesës, nuk dihet se kur do përfundojë jeta e njeriut. Kjo është një e vërtetë e hidhur që na bën të bëhemi gati në çdo moment për dhënien e llogarisë.

Një nga bazat themelore të etikës mistike shpreh qartë se është shumë e domosdoshme që koha si një mirësi e madhe që na është dhënë të përdoret sa më me kujdes. Çdo besimtar që dëshiron të pastrojë zemrën dhe shpirtin e tij duhet të mendojë që llogaria mund të vijë në çdo moment, përderisa nuk dihet ardhja e vdekjes (exhel) dhe nisur nga kjo kohën duhet ta shfrytëzojë me vepra të mira. Ti lërë punët e panevojshme dhe mos të flasë gjëra të pakuptimta, pra e thënë ndryshe me shprehjen e Mevlanës, duhet ta mbrojë gjuhën nga të qenurit "Maskara i fjalës". Kështu e shpreh Allahu i lartmadhëruar me shprehjen Kuranore cilësinë e besimtarëve "të shpëtuar"

"Ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë)" (Muminun, 3)

"(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet." (Furkan, 72)

Besimtari i devotshëm duhet të jetë në çdo moment në dijeni për botën e tij të brendshme dhe të gjykojë se në ç'shikallë ka arritur pendimi, falënderimi dhe pëlqimi. Ai duhet të pendohet



për ato kohë që ka kaluar ashtu në pavetëdije, duke bërë një përlllogaritje për mirësitë që i janë dhënë. Duhet të shpëtojë nga ankthet e panevojshme të së ardhmes duke i kushtuar kujdes vetëdijes dhe të merret me gjendjen e tij shpirtërore. Pra duhet të jetë një njeri i pjekur i cili ia di vlerën kohës që jeton, thënë ndryshe edhe "ibnu'l-vakt", dhe të jetojë i përgatitur për botën tjetër. Harxhimi pa kriter i kohës është një humbje shumë e madhe. Vetë i dërguari i Allahut ka thënë:


"Njerëzit e xhenetit nuk do ndjejnë mall për asgjë tjetër, por vetëm për kohën që kanë kaluar në këtë botë pa përmendur Allahun." (Hejthem, X, 73-74) Nëpërmjet kësaj thënieje na ka kujtuar se duhet ta vlerësojmë kohën me punë të dobishme, që do të jenë një pasuri e jona për jetën e përtejme. Nëse mirësitë të ikin nga dora, pendimi nuk ka më vlerë. Prandaj sa ta kemi mundësinë, le ta vlerësojmë jetën me punë të dobishme. Të përpiqemi t'i japim hakun çdo gjëje që kërkon falënderim. P.sh, mirësinë e të folurit le ta shfrytëzojmë me përmendjen e Zotit, si një shërim për zemrat tona.

Kështu e këshilloi Pejgamberi ynë Hafsanë:

-O Hafsa! Ki kujdes në të folurit e tepërt, pasi e folura e tepërt përveç përmendjes së Allahut e vret shpirtin. Përmende Zotin shumë! Kjo e ripërtërin zemrën! (Ali el Muttaki, 1, 439/1896)

Allahu i lartmadhëruar na këshillon të jemi të kujdesshëm në dy çështje:

"Dhe jepni nga ajo që Ne u kemi dhënë juve, para



“Ne nuk krijuam qiejt e tokën dhe çka ndërmjet tyre, pa një qëllim. Por, Ne i krijuam të dyja me qëllim të caktuar, mirëpo shumica e tyre nuk dinë.”

se ndonjërit prej jush t’i vijë vdekja, e atëherë të thotë: **“O Zoti im, përse nuk më shtyve edhe pak afatin (e vdekjes), që të jepja lëmoshë e të bëhesha prej të mira!”**” (Munafikun, 10)

Ajeti i mëposhtëm tregon qartë se si kthehen mbra-pa vajtimet dhe pretekstet e atyre që e shkatërruan jetën e tyre:

“Dhe ata do të klithin: “O Zot ynë, nxirrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që i bënim!” Po a nuk u dhamë juve jetë aq sa ai ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe, madje juve u ka ardhur edhe pejgamberi, pra shijoni, se për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar.” (Fatir, 37)

Një tjetër arsye e shpenzimit të tepërt të kohës, si kurse ndodh në të gjitha mirësitë e tjera në jetë është koshienca për të mos ta kuptuar vdekjen siç duhet apo për t’i qëndruar larg saj. Në një hadith thuhet:

“Kujtojeni shumë vdekjen e cila zhduk rrënjësisht të gjitha dëshirat” (Tirmidhi, Kijamet, 26) Ata të cilët vazhdojnë në të tyren pavarësisht këshillave Pejgamberore, padyshim që do të kenë një fund të dhembshur.

Një ditë, i dërguari i Allahut tha:

-Nuk ka asnjë njeri që do të vdesë dhe nuk do të pendohet.

Ashabët e pyetën:

-Për çfarë të pendohet, o i dërguari i Allahut?

I dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Do pendohet se një person bamirës nuk ka shpenzuar më shumë, ndërsa keqbërësi që nuk ka hequr dorë nga të këqijat.” (Tirmidhi, Zuhd, 59)

Kur njeriu sheh me syrin e zemrës rrjedhën e fuqisë hyjnore të pasqyruar në mbarë gjithësinë, e ndjen veten të detyruar të mendojë se si duhet të jetë në këtë jetë. E vërteta më e madhe që duhet ta lidh njeriun me jetën, është çështja e vdekjes. Sa pamje e mahnitshme për njeriun është ai moment lamtumire. Kush e njeh vdekjen dhe e kupton se është udhëtar i ahiretit, nuk bëhet pre e lojërave të kësaj jete dhe nuk humbet kohë me to. Në Kuran thuhet:

“Ne nuk krijuam qiejt e tokën dhe çka ndërmjet tyre, pa një qëllim. Por, Ne i krijuam të dyja me qëllim të caktuar, mirëpo shumica e tyre nuk dinë.” (ed-Duhan, 38-39)

Sikur të gjitha mirësitë e përkohshme të mblidhen tek një njeri, dhe sikur ky njeri të jetojë edhe një mijë vjet, ç’dobi ka! Në fund të fundit, vendi ku do të futet a nuk do të jetë kjo tokë të cilën e shkelim me këmbë?! Si nuk merr njeriu mësim, ndërkohë që këshillohet përherë gjatë gjithë kohës ku vepron çdo qenie e përkohshme. Sa mashtrim i frikshëm në emër të së ardhmes është të pandehësh se urimet që ushqejnë jetën shpirtërore të kësaj bote në të cilën jetohet në mënyrë të painformuar nga ahireti, janë të përhershme dhe se lojërat e kësaj jete janë të vërteta!.. Imam Shafiu thotë:

-A kanë leverdi karvanet të ndërtojnë shtëpi gjatë udhëtimit?

Një jetë e tillë nuk është



gjë tjetër vetëm se një lojë në fëmijëri, një kënaqësi në rini, një papjekuri në moshë madhore, një mall për të shkuarën në pleqëri dhe një mijë e një përpjekje. Kurse vdekja e pret njeriun në çdo çast në pritë. Sa shpenzim i tepërt në jetë është gjendja e atyre që lodhen me kënaqësitë e përkohshme deri në ditën e fundit, duke mos lënë mënjanë zbulimet e kësaj bote, vetëm e vetëm për të fituar qetësinë që të jep jeta larg mendimit për ahiretin!.. Sa mall do të ndjejnë një ditë për kohën e çuar dëm ata të cilët e shkatërruan kohën e tyre sikur nuk do të vdisnin asnjëherë!...

Ata të cilët e kanë dhënë veten e tyre pas kënaqësive epshore i shmangen vazhdimisht të menduarit për jetën e varrit dhe atë të përtejmen duke u përpjekur të jetojnë jetën e tyre mbi planin epshor. Prandaj vdekja për ta është një ankth për të ardhmen dhe një frikë e tmerrshme. Kjo pasi njeriu dëshiron të jetojë në një botë të cilën e ka imagjinuar dhe i ka dhënë shpirtin. A është e mundur që një njeri i cili ka shkatërruar ahiretin duke u përkujdesur për këtë botë, ta lërë vilën e tij luksoze dhe të kërkojë të jetojnë në një rrënojë? E kundërta e saj a mund të konceptohet një besimtar i cili mendon thëllësisht ahiretin dhe të trembet nga frika për varrin?

Kështu na e tregon Mevlana rrugën për të shpëtuar nga të fshehtat e kësaj bote dhe për të arritur lumturinë e përhershme:

-Mos e përqafo shumë pasurinë, ashtu që kur të vijë koha ta kesh të lehtë ta lësh! Edhe e lë lehtë edhe fiton sevape! Mbështetiu fort Atij që të qëndron më afër, Ai është i Pari dhe i Fundit!

Shumica e njerëzve frikësohen nga vdekja fizike e tyre. Në fakt ajo që duhet të frikësohen më shumë është vdekja e shpirtit.

Për çdo qenie të gjallë ka një frymë të fundit, e cila nuk mund të shtyhet më tutje. Koha ecën me hapa të shpejtë sipas përcaktimit të Zotit. Në jetën e kësaj bote pak a shumë është e mundur të marrësh çdo gjë dhe të kthesh prapa shumë gjëra, por kohën e kaluar kurrë... Askush nuk mund të qëndrojë indiferent kur një copëz e vogël floriri hidhet në kosh, por sa e habitshme është kur qëndrojmë indiferent ndaj kohës që kalojmë, për të cilën edhe po të japim miliona flori nuk mund ta marrim dot.



Feriduddin Attar thotë:

Janë katër gjëra që s'mund të të kthehen prapa pasi i ke humbur: fjala e dalë nga goja, shigjeta e gjuajtur, aksidenti i bërë dhe një jetë e harxhuar kot.

Një mik i ngushtë i Zotit për të kuptuar mirë vlerën e kohës dhe për ta vlerësuar atë sa më mirë jep këto këshilla:

Bëj vizita të herëpashershme në spital për t'u bërë vizitë të sëmurëve! Falëndero Zotin për gjendjen tënde shëndetësore dhe mendo edhe gjendjen e atyre të sëmurëve! Shko herë pas here në burgje dhe gjyko për jetën e përvuajtur të atyre njerëzve të burgosur! Mendoni për një çast se krimi është kryer për një moment të caktuar, në mënyrë të pavetëdijshme, nga ana tjetër ashtu i rrënuar shpirtërisht hyni në burg e mendoni që edhe ju mund të ishit në vendin e tyre! Falëndero Zotin që të mbrojti dhe ruajti për të mos rënë në këtë gjendje! Lutu edhe për shpëtimin e atyre që janë atje! Më pas shko në varreza, dije vlerën e kohës, duke menduar se nuk ka asnjë vlerë pendimi pasi të kesh humbur mirësinë e jetës! Lexo një Fatihë për të vdekurit dhe përpiqu ta shfrytëzosh këtë kohë të mbetur duke falënderuar Zotin tënd!

Kjo do të thotë që një besimtar duhet të përpiqet të bëjë një jetë të devotshme duke mos e harruar krijuesin e gjithësisë në asnjë kohë dhe vend. Allahu thotë:

“E mos u bëni si ata që harruan Allahun, pra (All-llahu bëri që ata) harruan vetveten! Të tillët janë fasikët.” (Hashr, 19)

“Bir! Mendo që sot ke vdekur. Sa do të mërzitësh për kohët që i ke kaluar ashtu i pavetëdijshëm. Ah sikur! Do të thuash, por pa kuptim.”

Pasi shpjegon se çuarja dëm e kohës dhe harxhimi i tepërt i saj me njerëz që nuk kanë preokupime të tjera në jetë është një nga turpet më të mëdha të nefsit, Ebu Abdurrahman Sulemi tregon se si mund të kurohet një dukuri e tillë:

Ta kuptosh kohën si gjënë më me vlerë në jetë dhe ta shfrytëzosh atë me punët më të vlefshme siç është ajo vetë, pra duke përmendur Allahun, duke e adhuruar përherë dhe duke forcuar devotshmërinë në shpirtin tënd. I dërguari i Allahut ka thënë: *“Lënia mënjanë e gjërave që nuk i interesojnë njeriut, është tregues i një myslimanizmi të mirë.”* (Tirmidhi, Zuhd, 11)

Hadithi njofton se është një detyrim moral i yni për ta ditur sa më mirë vlerën e kohës dhe më pas vijon:

“Dija vlerën pesë gjërave para se të vijnë pesë të tjera: vlerën e rinisë para pleqërisë, vlerën e shëndetit para se të sëmuresh, vlerën e pasurisë para se të varfërohesh, vlerën e kohëve të lira para se të vijnë kohët e zëna dhe vlerën e jetës para se të vijë vdekja.” (Hakim, el-Mustadrek, IV, 34, Buhari, Rikak, 3; Tirmidhi, Zuhd, 25)

Në ditën e gjykimit robi nuk lëviz nga vendi pa u pyetur për katër gjëra:

- 1 Për jetë, me çfarë e zhduku atë?
- 2 Për rininë, ku e kalbëzoi atë?
- 3 Për pasurinë, ku e fitoi dhe ku e shpenzoi?
- 4 Për diturinë, çfarë bëri me të? (Tirmidhi, Kijame, 1)

Ka dy mirësi të cilat shumica e njerëzve mashtrohen kur i përdorin: Shëndeti dhe koha e lirë. (Buhari, Rikak, 1)

Allahu na njofton në shumë ajete kuranore se në ahiret do të pyetemi për të gjitha mirësitë që na janë dhënë në materiale-shpirtërore. Dijetarët Islamë kanë dhënë mendime të ndryshme për sa i përket mirësive më të rëndësishme për të cilat do merremi në llogari ditën e gjykimit. Ibn Mesud thotë se këta janë “Siguria, shëndeti dhe koha e lirë” Muavije bin Kurre thotë: “Llogaria më e tmerrshme në ditën e gjykimit është ajo e kohës së lirë” (Bursevi, X, 504)

Kjo këshillë e Gazaliut në lidhje me shpenzimin e tepërt të kohës, ka shumë domethënie:

“Bir! Mendo që sot ke vdekur. Sa do të mërzitësh për kohët që i ke kaluar ashtu i pavetëdijshëm. Ah sikur! Do të thuash, por pa kuptim.”

Xhunejd Bagdadi thotë:

Një jetë e kësaj bote është më me vlerë se një mijë vite të ahiretit. Fitorja dhe humbja i përkasin kësaj bote. Në Ahiret nuk ka të fitosh apo të humbësh.

Koha e humbur është një humbje e madhe që nuk zëvendësohet. Kjo pasi të gjitha dosjet e të kaluarës janë mbyllur. Të paktën të përpiqemi t’i zëvendësojmë ato nëpërmjet anës shpirtërore, duke bërë lutje dhe adhurime për krijuesin tonë.

Lumi i jetës rrjedh shumë shpejt. Ditët e kësaj jete të përkohshme të kufizuara nga vullneti hyjnor, janë si pikat e ujit në një gotë. Të mos harrojmë se për çdo ditë që kalon ndodh një pakësim i ujit në gotë, largohemi një ditë më shumë nga kjo botë dhe i afrohem një ditë më shumë jetës tjetër. Meqenëse exheli nuk dihet se kur vjen, duhet të kujtojmë se në çdo moment mund të takohemi me Azrailin, në mënyrë që në frymën e fundit të mos shohim dramën tonë. Nexhip Fazël thotë:

Në atë moment të frymës së fundit, kur perdet e jetës ulen dhe ngrihen,

T’i themi Azrailit “Mirë se erdhe”!

Zoti na mundësoftë ta kalojmë këtë jetë të mbetur me adhurime ndaj Zotit dhe ta japim frymën e fundit si myslimanë. Zoti na e mundësoftë ta kuptojmë mirësinë e kohës që na është dhuruar, në të cilën jetojmë botën tonë të brendshme dhe të jashtme, për të bërë kështu një jetë larg shpenzimeve të tepërta.

Qëndrimi i shariatit islam ndaj klonimit të njeriut

Mr. sci. Flamur Sofu

Vërtet studimi dhe mësimi është një prej çështjeve primare që duhet të kryejë njeriu si krijesa më e përsosur, të cilit Allahu i dhuroi të menduarit dhe aftësitë e të studiuarit. Me këtë cilësi njeriu u veçua prej gjallesave tjera që krijoi Allahu i Lartësuar për t'i shërbyer krijesës më të përsosur, njeriut.

Studimet dhe gjurmimet bashkëkohore po arrijnë një nivel të lartë dhe shumë të përhapur, e si rrjedhojë në Botën Perëndimore u paraqit një zbulim shkencor i çuditshëm: **klonimi** i gjallesave dhe i njeriut. Është më së e vërtetë se bota sot është si një fshat në aspektin e informimit, ngase brenda disa minutash njeriu mund të informohet mbi çfarë ndodh në anën tjetër të botës, e pikërisht për këtë çështja e klonimit ka sjell huti në mendjen e njerëzve.

Sheriati islam është gjithëpërfshirës dhe si i tillë do të jetë deri në ditën e kiametit, prandaj dijetarët islam japin mendimet dhe qëndrimet e tyre rreth çështjes së klonimit, duke u bazuar në burimet dhe argumentet e shariatit.

Pa dyshim çështja e shpjegimit se çfarë qëndrimi ka sheriatit islam rreth **klonimit**, nuk është e thjeshtë dhe e lehtë, por kërkon një studim të thellë dhe shumë serioz. Prandaj ne nuk

jemi në gjendje të japim përgjigje për një çështje të tillë, por do të përpiqemi të paraqesim mendimet e dijetarëve të njohur myslimanë. Lidhur me këtë, po paraqesim përgjigjen e dijetarit të njohur bashkëkohor, prof. dr. Jusuf el-Karadaviu, kur që pyetur se çfarë mendonte për **klonimin**, që përgjigjur se për një çështje të tillë siç është **klonimi** kërkohet studim dhe hulumtim shumë serioz. Kështu që kjo çështje duhet studiuar dhe analizuar në hollësi. Ky dijetar thotë se Islami i mirëpret studimet shkencore dhe studimin në shkenca të ndryshme e konsideron si farzi kifaje (obligim kolektiv që, nëse dikush e kryen, liron të tjerët nga ai obligim). Kardaviu është i mendimit se **klonimi** është i papranuar sipas shariatit islam, ngase ai i sjell dëme shkencës, ekonomisë dhe politikës. Ky mendon se çdo gjë në këtë jetë duhet t'i nënshtrohet ligjeve të fesë dhe të pëlqehet me të. Ai shton: "Vërtetë natyrshmëria e shariatit islam, argumentet e tij, parimet dhe qëllimet e shariatit e konsiderojnë **klonimin** e njeriut haram, të ndaluar, ngase një veprim i tillë i sjell dëme qenies njerëzore. Kështu, vazhdon duke përmendur dëmet dhe pasojat e klonimit të njeriut, si f.v. klonimi është në kundërshtimi me llojlojshmërinë e krijimit të krijesave të Zotit, ngase Allahu e përmend në Kur'an llojlojshmërinë e krijimit të krijesave, e klonimi është jash-

të këtij procesi. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë: “A nuk e sheh se All-llahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës.”¹ **Klonimi**, përveç se është në kundërshtim me lloj-llojshmërinë e krijimit të krijesave, sjell probleme dhe telashe në jetën shoqërore të njerëzve. Përfytyroni sikur në një klasë mësimi kemi disa nxënës të klonuar, si do të mund t’i dalloj profesori se cili është njëri apo tjetri!? Si mund të verifikohet krimi i bërë, nëse ndodh që ta ketë bërë një person i klonuar!? Si mund ta njohë bashkëshorti gruan e tij, dhe anasjelltas bashkëshortja burrin e saj!?

Po ashtu Karadaviu përmend se prej pasojave dhe dëmeve të klonimit është edhe ajo se klonimi bije në kundërshtim me ligjin e martesës, ngase klonimi bën që më të mos kihet nevojë për martesë dhe se shumimi i njerëzve mund të bëhet edhe pa u martuar!!! E vërteta është se Allahu i ka krijuar çift njerëzit dhe të gjitha gjallesat e bimët, madje sipas zbulimeve shkencore edhe gjërat inorganike janë të përbëra prej dy elementeve të kundërta, si f.v. rryma ka pozitivin dhe negativin, e që pa dy këto komponente të ndryshme nuk mund të shfaqet. Për këtë arsye Kur’ani a.sh. e thekson në mënyrë shumë të qartë çështjen e krijimit të dy gjinive: “Dhe Ne u krijuam juve çift”², “Dhe Ai është që krijoi llojet-mashkullin dhe femrën. Nga pika e farës që hidhet”³, “I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë.”⁴, “Dhe Ne krijuam prej çdo sendi dy lloje (mashkull e femër) që ju të përkujtoni (madhështinë e Zotit)”⁵. Prandaj me klonim nuk ka nevojë të ekzistojnë dy llojet e gjinive, ngase vetëm me femrën mund të shumohen njerëzit e të dy gjinive.

Klonimi është kundër natyrshmërisë së krijimit të njeriut dhe se një veprim i tillë nuk është në interes të njeriut në asnjë aspekt të jetës. Pa dyshim, njeriu ka nevojë për gjininë e kundërt, jo vetëm për shkak të shumimit, por edhe për shkak se njëra gjini e plotëson tjetrën në shumë aspekte. Po të ishte njeriu i panevojshëm për gjininë tjetër, atëherë Allahu nuk do të krijonte gjininë e kundërt. Por kur e krijoj njeriu e parë (Ademin a.s.), Ai i krijoi atij edhe bashkëshorten, Havën, si prehje dhe qetësim për të. Nëse burri paska nevojë për qetësim me bashkëshorten e tij, po fëmija vallë, çfarë nevojë ka për të gjetur prehjen shpirtërore, prehjen prindërore? E nëse bëhet klonimi, atëherë nuk mund të ketë prehje dhe qetësi prindëro-

1. Fatir: 27-28

2. Nebe: 8

3. Nexhm: 45-46

4. Jasin: 36

5. Dharijat: 49

“Ai është i Cili e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo përsëritja është edhe me lehtë për Të (sipas mendimit tuaj)...”.

(Rum, 27)

re e bashkëshortore dhe se familja do të jetë e shpërbërë dhe pa harmoni.

Më tej Karadaviu vazhdon duke thënë se nëse ndodh klonimi, atëherë si do të jenë raportet në mes njeriut që është klonuar dhe i atij që i është marrë elementi i klonimit!? Pa dyshim kjo do të jetë një çështje konfuzë, edhe nëse i klonuari i ka të gjitha cilësitë e atij nga i cili është klonuar, ai mund të ndryshojë në aspektin e edukimit dhe të sjelljes, të aftësive dhe njohurive. Po ashtu lind pyetja: çfarë afërsie ka i klonuari me personin nga i cili është klonuar? E ka vëlla, baba apo çka!?! Të gjitha këto pasoja na obligojnë neve që të kundërshtojmë një veprim të tillë.

Disa nga dijetarët dhe juristët myslimanë janë të mendimit se studimi rreth klonimit si shkencë nuk është i ndaluar, veçse konsiderohet si zbulim shkencor, por, nëse ndodh që përdorimi i klonimit të sjell dëme dhe probleme në shoqëri, ai konsiderohet i ndaluar, haram.

Fetvaja e rektorit të Ez’herit rreth klonimit të njeriut

Rektori i Ez’herit, dr. Muhammed Sejidi Tantavi është i mendimit se klonimi i njeriut është veprim i ndaluar, ndërsa klonimi i bimëve dhe shtazëve me qëllim që të shtohet lloji i mirë i bimëve dhe shtazëve, është i lejuar. Sa i përket mënyrës së shumimit të njeriut, po qe se shumimi i tij nuk bëhet në mënyrën se si e ka caktuar Allahu, konsiderohet haram. Prandaj klonimi është në kundërshtim me natyrshmërinë e krijimit të njeriut si krijesa më e përsosur dhe më me përgjegjësi në tokë.

Fetvaja e ish myftiut të Egjiptit, dr. Naser Ferid Vasilit rreth klonimit të njeriut



Dr. Naser Ferid Vasili, ish myftiu i Egjiptit, konsideron se klonimi i njeriut është një prej bindjeve shkencore që refuzohet rreptësishtë prej Islamit, ngase me klonimin e njeriut nënkuptohet shumimi i njerëzve me të njëjtën fizionomi prej një njeriu, një veprim që prek efektin dhe rolin e formimit të familjes, që kërcënon të drejtat dhe obligimet e shoqërisë, që hap dyert e krimit, për shkak se ekziston mundësia e fshehjes (mospranimit) së krimit, ngase do të ekzistojnë shumë njerëz me të njëjtën fizionomi.

Po ashtu përdorimi i klonimit për të shëruar sterilitetin është haram, ngase edhe steriliteti është një prej caktimeve të Allahut të Lartësuar, gjë që shprehet në Kur'an: "Dhe e benë atë që do steril". Ndërsa sa i përket klonimit për t'i formuar (mbjellë) ndonjë gjymtyrë trupi njeriut që ka nevojë për të, kjo lejohet.

Dijetari i njohur dr. Zaglul Nexhari është pyetur se çfarë mendon për klonimin, e ai është përgjigjur: "Klonimi është një veprim që bie në kundërshtim me natyrshmërinë e krijimit dhe me ligjet e martesës. Prej argumenteve të Allahut xh.sh. është edhe argumenti se kjo jetë vazhdon me anë të martesës së dy gjinive dhe se nga ky ligj krijohet llojlojshmëria e krijesave; krijimi bëhet nga gjysma e kromozomeve të burrit dhe gjysma e kromozomeve të gruas dhe me bashkimin e dy gjinive pason krijimi i njeriut. Pa dyshim që klonimi si veprim i panatyrshëm, mund të bëjë që jeta e kësaj bote të shkatërrohet, ngase klonimi është shumë i dëmshëm dhe ka shumë anë negative, edhe pse mund të ketë diçka pozitive.

Komisioni për dhënien e fetvave me seli në Xhedë (Xhilde) të Arabisë Saudite, me datën 27.06.1997, pas një diskutimi të gjerë rreth çështjes së klonimit të njeriut, mori vendimin nr: 93 (2/10):

1. Ndalohet rreptësishtë klonimi i njeriut, pavarësisht se çfarë

rë mënyrash përdoren për klonim.

2. Klonimi i shtazëve dhe i bimëve lejohet, nëse vërtetohet se u sjell dobi njerëzve.

3. Duhet kërkuar që të gjitha shtetet islame të vendosin ligje të cilat ia mbyllin mundësin e klonimit të njeriut.

4. Që të gjitha organizatat islame dhe shoqatat islame të diskutojnë për të analizuar dhe sqaruar dëmet që sjell klonimi.

5. Të formohen komisione të specializuara nga ekspertë të shumtë dhe dijetarë islamë, për të vendosur se ç'duhet të studiohet në shkencën e biologjisë, por pa i tejkaluar kufijtë e sheriatit islam.

Përfundim:

Si përfundim, rreth klonimit të njeriut mund të përmendim dy gjëra shumë të rëndësishme:

1. Klonimi i njeriut nuk është ashtu siç mendojnë disa nga njerëzit, se gjoja është krijim i jetës, ngase edhe ky proces varet krejtësisht nga ajo që ka krijuar Allahu i Lartësuar: klonimi varet krejtësisht nga fara (sperma) dhe disa elemente kryesore që merren nga vetë njeriu dhe se të gjitha këto veprime nuk mund të jenë jashtë ligjeve e rregullave që ka krijuar Allahu xh.sh.

2. Ideja e klonimit lidhet me faktin që njeriu i bëhet me dije që kurrsesi nuk mund të mohojë ringjalljen, e madje tash mund të lindë edhe kjo pyetje: duke qenë se njeriu ka mundësi të bëjë klonimin e njeriut, si mund të dyshojë atëherë në ringjalljen e tij, gjë që do ta bëjë Krijuesi i Lartësuar Allahu xh.sh.? Andaj ky është një prej argumenteve që nuk i lë njeriut hapësirë për dyshim në ringjallje dhe se do të pranojë medoemos fjalën e Allahut të Lartësuar: "Ai është i Cili e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo përsëritja është edhe me lehtë për Të (sipas mendimit tuaj)..."(Rum, 27).

Hixhabi

Adelina Muça

Hixhabi - Akt i bindjes:

Hixhabi është një akt i bindjes ndaj Allahut. “Kur Allahu ose i dërguari i Tij ka vendosur për një çështje, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtarë dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër. E kush e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës.” (Kur’an, 33:36)

Po ashtu, Allahu thotë në Kur’an: “**Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre. Të mos zbulojnë stolitë e veta, përveç atyre që janë të dukshme, le të venë shamitë mbi kraharonin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmenden) dhe robërshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat, ose fëmijët që nuk janë të pjekur (për gra). Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të mos zbuluar fshehtesinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.**” (Kur’an, 24:31)

Hixhabi është Modesti:

Allahu xh.sh thote në Kur’an: “**O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve që të vënë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. All-llahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues.**” (Kur’an, 33:59)

Thotë Allahu në Kur’an: “**O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendturpësinë dhe petk zbukues. Po petku i devotshmërisë, ai është më i miri. Këto janë argumentet e All-llahut, ashtu që ata të përkujtojnë.**” (Kur’an, 7:26)

Hixhabi është simbol i islamit:

Një nga parimet themelore të Islamit është që besimi është një mesazh, deklaratë apo komunikim me anë të gjuhës, një besim në zemër, i cili manifestohet në çdo pjesë të trupit.

Prandaj, kur një besimtare muslimane dëshmon për besimin e saj në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, me siguri do të vendosë të manifestojë besimin e saj edhe në veshje, për t’u dalluar nga jo-besimtarët.

Rruga për tek Hixhabi:

Hixhabi nuk është diçka arabe apo turke. Por është një urdhër nga Allahu (xh.sh), e sqarimet për të janë dhënë në Kur’an si dhe në sunetin e Profetit Muhammed (a.s.), për t’i dhënë gruas mbrojtje dhe siguri.

Rruga për tek Hixhabi përsëkon këto 3 hapa:

1- Nijeti (apo qëllimi) është hapi i parë. Veshja e Hixhabit është përmbushje e një prej urdhërave të Allahut, prandaj mund të klasifikohet si një akt adhurimi. Hixhabi duhet të vishet vetëm e vetëm që të jesh në përputhje me urdhërin e Allahut (xh.sh), duke kërkuar kënaqësinë e Tij.

2- Dituria është hapi i dytë. Imam Buhari, dijetar i madh për hadithin, ka thënë: “**Dituria duhet t’i paraprijë çdo veprimi apo thënieje**”. Prandaj motra muslimane duhet të kërkojë dituri për çështjen e hixhabit në Kuran, sunetin e Profetit dhe në literaturën islame që të jetë sa më e qartë dhe e sigurtë.

3- Dashuria është hapi i tretë. Një nga shenjat e besimit të vërtetë është ta bësh adhurimin me dashuri. Dashuria për hixhabin që ka qenë tek brezat e parë të grave muslimane, duket sikur është dobësuar pak në zemrat e grave muslimane sot. Kur Aliu e pyeti gruan e tij Fatimen, vajzën e Profetit, se Cila është gjëja më e dashur për një grua besimtare?”, ajo iu përgjigj: Të mos shikojë asnjë burrë të huaj. Çfarë ndodhi me këtë dashuri për modestinë? Që të kthejmë dashurinë për hixhabin në zemrat tona, ne gratë muslimane duhet të largojmë nga zemrat tona frikën e pakuptimtë se gjoja hixhabi na bën inferiore dhe na kufizon jetën. Hixhabi i gruas muslimane është e drejta e saj dhe nderi i saj, të cilin ia ka dhënë Allahu, Zoti i të gjithë botërave. Është drita e saj që e dallon motrën muslimane nga errësira e jobesimtarëve.



MENAXHIMI I STRESIT

Dhurata Kazazi

Me këtë material dëshirojmë të tregojmë dëmet që shkakton stresi, sa i rrezikshëm është ai, dhe ajo që është më e rëndësishme si ta luftojmë, si ta kurojmë atë në mënyre që të jemi sa më të shëndetshëm psikologjikisht, sepse në këtë mënyrë jemi edhe me të shëndetshëm fizikisht.

ÇFARË DO TË THOTË STRES?

Stresi është një kompleks reagimesh që ju shfaqen sa herë ndesheni me ndodhi që prishin ekuilibrin tuaj dhe që sforcojnë apo kapërcejnë fuqitë tuaja përshtatëse. Pra, stres do të thotë një varg ndryshimesh biokimike që ndodhin dhe ndikojnë fuqishëm në çdo qelizë të trupit tonë.

SA I RREZIKSHËM ËSHTË STRESI?

Sot streset dhe ankthet janë ndër shkaktarët më të rëndësishëm të vdekshmërisë. Jo vetëm kjo, por në mënyrë direkte apo indirekte ato janë gjithashtu shkaktarët të rëndësishëm të sëmundjeve koronare, të cilat cilësohen sot si vrasësi numër një i njerëzimit.

Irritim, paqëndrueshmëri emocionale, pagjumësi, vështirësi në përqendrim, lodhje, mbindjeshmëri ndaj kritikave, humbje apo shtim në peshë, frikë nga dështimi, shtim i varësisë ndaj qetësuesve, janë simptomat aq të njohura të stresit.

Ankthi dhe çrregullimet psikike shkaktojnë një zinxhir ndryshimesh metabolike, të cilat nga ana tjetër, dëmtojnë një sërë indesh të trupit, duke shkaktuar ato që njihen me emrin sëmundje psiko-somatike. Stresi mund të shkaktojë ulcerën peptike, kancerin, infarktin, hipertension arterial, dobësim të sistemit imunitar, migrenën, diabetin, çrregullime të personalitetit, etj.

Shpesh lidhjet e stresit me sëmundjet janë te drejtpërdrejta. Por edhe kur nuk ka lidhje te drejtpërdrejta mes stresit dhe sëmundjes nuk duhet harruar që trupi funksionon si një i tërë. Një ndikim i tij në një pjesë të trupit, keqëson edhe funksionin e pjesëve të tjera.

ÇFARË E SHKAKTON STRESIN?

Ato që lindin stresin janë mendimet negative që ziejnë në mendjen tuaj, dialogët e brendshëm që zhvillo-

hen kur ndesheni me stresorin (ndodhia që shkakton këto reagime). Ato ju bëjnë të shqetësoheni për pasojat e veprimeve tuaja. Të lëkundeni mes mëdyshjeve për të zgjedhur këtë apo atë mënyrë veprimi. Të ankoheni në vend që të veproni. Të fajësoni veten se jeni të paaftë për të përballuar situatën.

Ka shumë urtësi në hadithin e Profetit, transmetuar nga Ebu Hurejra: *“I fuqishëm nuk është ai që i mund njerëzit me fuqinë e tij, por i fuqishëm është ai person që kontrollon veten e tij në zemërim.”* Në të vërtetë, qëndrimi me durim dhe qetësi është çelësi i forcës fizike. Duhet thënë se është vlerësimi juaj në lidhje me situatën që e bën atë stresuese. Pasi asgjë në vetvete nuk mund të quhet stresuese.

Çdo gjë ka potencialin për të qenë stresues, nëse ju do ta vlerësoni si të tillë. Sa më shumë të mendoni se kërkesa që ushtrohet ndaj jush është e rrezikshme, dhe sa më shumë të besoni se ju s’keni forcë për ta përballuar atë, aq më i madh është dhe niveli i stresit. Pra nuk ka rëndësi se në çfarë niveli janë realisht aftësitë tuaja për të bërë këtë apo atë gjë. Ajo që ka më shumë rëndësi është besimi që ju keni në aftësitë tuaja se mund ta bëni me sukses atë që ju kërkohet ose që ia keni vënë qëllim vetes në një situatë të caktuar. Kështu, çelësi i stresit është në mendjen tuaj. Ju mund ta hapni ose ta kyçni atë.

MENAXHIMI I STRESIT.

Në përpjekje për të gjetur mënyrën për parandalimin dhe kurimin e stresit dhe pasojave të tij, janë modeluar metoda të ndryshme. Ja disa prej tyre:

Metodat më efikase për arritjen e këtij qëllimi gjenden në një formë të përkryer në **praktikën islame**. Islami është një sistem i plotë jetese dhe si i tillë i përshtatet më së miri njeriut, sepse është ndërtuar sipas tipareve të tij, që me anë të praktikave të kujdeset për trupin dhe shpirtin e tij, si dhe për ekuilibrin dhe harmoninë mes tyre.

Trupi i njeriut mund të krahasohet në një farë mënyre me një makineri. Kështu p.sh. magnetofoni ka shumë



“Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin.”

(Feth: 4)

pjesë mekanike dhe elektrike, por ai nuk funksionon pa energji. Në të njëjtën mënyrë, në përbërje të njeriut nuk ka vetëm pjesë anatomike dhe fluide, por edhe një shpirt. Që trupi i njeriut të funksionojë sipas natyrës së tij të plotë duhet që, këto pjesë anatomike dhe shpirti të jenë në harmoni të plotë. Pikërisht kujdesi për shpirtin zë vend qendror në aktin e adhurimit të Zotit, në Islam.

Ky kujdes përbëhet nga

disa komponentë:

BESIMI (IMANI).

Besimi në Zot është nevoja e parë dhe më e domosdoshme për qetësi shpirtërore. Mungesa e besimit në Krijuesin e Plotfuqishëm është një nga shkaqet që e çojnë njeriun në çrregullime psikologjike. Njeriu është gjithmonë i ekspozuar ndaj stresorëve të shumtë dhe përpjekjet për t’u përshtatur me to janë po aq të shumta. Individit që beson Allahun e Plotfuqishëm dhe është i vetëdijshëm për praninë e Tij, ka një mbështetje të madhe morale, e cila do ta ndihmojë atë në situatat më të vështira të jetës. Rezultati i përshtatjes ndaj stresit varet më tepër nga natyra e njeriut se sa nga intensiteti i tij.

“Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin.” (Feth: 4)

Është logjike të mendojmë se besimi në një Zot jep një mbështetje të madhe morale dhe siguron kënaqësinë e zemrës dhe sigurinë shpirtërore.

Vetëm nën hijen e besimit në Zotin Fuqiplotë marrin kuptimin e vërtetë jeta e vdekja, gëzimi e hidhërimi, vështirësia e lehtësimi, e mangëta dhe e plota, e mira dhe e keqja, gjë e cila bën që njeriu të përballet me to me statusin shumëdimensional të besimtarit.

BESIMI NË JETËN E PËRTEJME DHE PRANIMI I SË PASHMANGSHMES.

Një njeri që beson se problemet e kësaj bote janë të

përkohshme dhe se ekziston një jetë tjetër pas vdekjes, do të jetë i kënaqur me gjithçka që do të marrë nga kjo jetë. Pranimi i të pashmangshmes është një mekanizëm i domosdoshëm i mbrojtjes psikologjike ndaj problemeve. Besimi në jetën e përtejme dhe në përcaktimin e Zotit, siç mëson Islami, është mbrojtja më e mirë për secilin. Myslimani beson se caktimi është në dorë të Zotit. Ai beson se vdekja as nuk vjen më shpejt e as nuk vonohet më shumë nga ç'është e përcaktuar nga Zoti. Nga kjo, tek myslimani rrjedh besimi se ajo që i ka ndodhur nuk mund të mos i ndodhte dhe ajo që nuk i ka ndodhur nuk mund t'i ndodhte kurrësi.

Në situata stresi apo paniku, jobesimtari sillet ndryshe nga besimtari. Ai nuk ka një pikë referimi ku të mbështetet, ku të kërkojë udhëzim, ndihmë e falje. Ai nuk di dhe nuk beson në një botë tjetër përveç asaj tokësore, mbi të cilën nuk ka asnjë kontroll. Njerëz të tillë do ta kërkojnë ndihmën apo ngushëllimin tek droga, alkooli, apo çdo lloj vesi, pasojat e të cilëve dihen. Duke mbajtur shpresën tek Allahu, njeriu minimizon stresin që ushtrohet ndaj tij.

“Ne do t’ju sprovovjmë me uri, frikë, humbje nga pasuria apo nga jeta, por ti jepu lajmin e mirë besimtarëve, të cilët kur i godet ndonjë e keqe thonë: “Ne jemi të Allahut, dhe tek Ai do të kthehemi. Të tillët janë ata që tek Zoti i tyre kanë mëshirë dhe të tillët janë ata, të udhëzuarit në rrugën e drejtë.” (Bekare, 155).

Kur njeriu është i vetëdijshëm që çdo gjë është në dorën e Allahut, do ta presë më me qetësi çdo problem. Mosbesimi përshkruhet si sëmundje që kryesisht shkaktohet nga arroganca dhe hezitimi në pranimin e së vërtetës.

“Zemrat e tyre janë të sëmura dhe Zoti e ka rënduar sëmundjen e tyre dhe i rëndë do të jetë ndëshkimi i tyre, sepse ata gënjejnë veten e tyre.” (Bekare, 10).



NAMAZI SI MJET RELAKSIMI.

S’ka dyshim në lidhjen që ekziston mes shëndetit mental e fizik me Krijuesin, i Cili di çdo gjë për njeriun më mirë se vetë njeriu. Çdo mësim dhe këshillë fetare ndikon në korrigjimin e ndjenjave dhe sjelljeve të njeriut. Besimi sjell dukshëm qetësi shpirtërore: **“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull apo femër, e duke qenë besimtar, Ne do ti japim atij një jetë të mirë e të bukur.”** (Nahl: 97)

Në namaz, njeriu përqendrohet në adhurimin ndaj Allahut, Të Gjithëmëshirshmit, të Gjithëpushtetshmit, ndaj të Pakufizuarit, i Cili i tillë do të jetë gjithmonë. Në namaz njeriu jo vetëm përqendrohet, por edhe i drejtohet Allahut, duke recituar fjalët e Kuranit. Njeriu qëndron në këmbë para Allahut, përkulet, bie në sexhde, duke e përmendur dhe lar-

tësuar Atë, me anë të verseteve madhështore të zbritura në Kuran.

Si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë mendor, namazi është mënyra më e mirë dhe më efikase e përqendrimit që mund të arrijë mendja njerëzore. Lëvizjet fizike në namaz janë të lehta dhe përfshijnë të gjitha muskujt dhe artikulationet. Shpenzimi kalorik ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit energjik.

Për të gjitha këto arsye e për shumë e shumë të tjera, myslimani këshillohet t’i shtojë përmendjen e Allahut dhe t’i praktikojë rregullisht ritualet islame. **“O ju që besuat, kërkonin ndihmë me durim e me të falur (namaz) se vërtetë Allahu është me durimtarët.”** (Bekare, 153).

KËNDIMI I KURANIT, gjithashtu ka një efekt shërues në trup, mendje dhe zemër. Studiuesit myslimanë kanë treguar se kur myslimani lexon Kuranin, mendimet, ndjenjat, frika dhe fajet e kaluara çlirohen dhe largohen, ndërsa presioni i gjakut bie, frymëmarrja normalizohet dhe stresi pakësohet. Ne duhet të themi:

“*Elhamdulillah*” për ato që kemi;

“*Insha'Allah*” për ato që duam të bëjmë;

“*Subhan'Allah*” kur shohim diçka tërheqëse apo të pazakontë;

“*Estagfiru'llah*” kur jepemi pas dëshirave dhe epsheve;

“*Allahu Ekber*” kur arrijmë suksese dhe rezultate.


Këto pesë fjalë të thëna rregullisht janë si një kompleks „multivitaminash“ për të gëzuar shëndet të plotë.

Një mënyrë tjetër për të parandaluar stresin është: **Ballafoqohuni guximshëm, mos ikni.**

Nuk ka zgjidhje më të lehte se ikja dhe mosballafaqimi me problemet në situata të rënda dhe problematike. Mos mendoni se duke bërë këtë po e zgjidhni problemin, ikja nga problemi nuk është zgjidhje e tij por dështim. Po qe se keni frikë të flisni me njerëz, a është zgjidhje të mos flasësh për tërë jetën tënde?! Shumë njerëz veprojnë kështu dhe këto “zgjidhje” rrënjosen në sjelljen dhe karakterin e tyre. Duhet t'i kaloni në mënyrë të shkallëzuar pengesat, mësojeni veten dhe largojeni frikën duke filluar të flisni me një grup të vogël njerëzish, pastaj kaloni para grupit më të madh. Me kalimin e kohës, teksa përshkallëzoni përpjekjet e tua, do të vëreni se kjo punë është më e lehtë nga sa e keni imagjinuar.

HAPJUNI NJË MIKU OSE NJË MIKEJE QË KENI.

Të flasësh për ndjenjat e tua është mënyra më e mirë për t'u ndjerë më i lehtësuar. Duke folur për ato që ndodhin në jetën tuaj, mund të mësoni shumë gjëra të reja rreth ndjenjave që keni, kjo ju jep mundësi ti shihni ndjenjat më qartë, në një këndvështrim tjetër. Kur i hapeni dikujt tjetër, ju nxirrni jashtë emocionet tuaja të dhimbshme, të fshehtat, gjë që ndihmon të çlirohesh disi prej tyre. Mund të mbani një ditar e të shprehni gjithë mllëfin që keni përbrenda, ose të vizatoni, të krijoni një poezi, do të shihni se do të ndjeheni më të lehtësuar. Shkruani përditë në ditar, jo vetëm në ditën kur jeni i mërzhitur. Shkruani edhe gjatë ditëve të lumtura. Në këtë mënyrë kur të jeni të mërzhitur do t'i lexoni ditët e lumtura që keni kaluar dhe do të ndjeheni më mirë.



MERRUNI ME AKTIVITET FIZIK.

Aktiviteti fizik është po aq i vlefshëm për trupin, sa është i vlefshëm edhe gjumi. Ushtrimet janë mënyra më e mirë për të kaluar gjendjen e keqe. Kur jeni të stresuar, mund t'ju duket shumë e lodhshme ideja e ushtrimeve, - e keni më të lehtë të shikoni TV, ose të merrni një sy gjumë - por fillojeni pak nga pak. Thuajini vetes se do të bëni ushtrime

vetëm për pesë minuta e kur të filloni ka të ngjarë të doni t'i vazhdoni ato. Fakti është se ushtrimet sportive përmirësojnë frymëmarrjen, qarkullimin e gjakut, çlirojnë muskujt e tensionuar, rritin aftësinë e sistemit kardiovaskular (zemrës dhe enëve të gjakut), për të transportuar oksigjen në muskuj.

Kjo ndihmon që ju ti përballoni më lehtë tensionet e stresit.

Aktiviteti fizik krijon edhe disa efekte **pozitive psikologjike**. Kur ju merreni me aktivitete fizike, truri juaj çliron disa substanca të ngjashme me morfinën, që quhen **endorfina**. Këto qetësojnë dhimbjet dhe krijojnë një ndjesi mirëqenieje në trupin tuaj.

Veç kësaj, ushtrimet fizike ushtrojnë edhe një efekt **ridrejtues në vëmendjen tuaj**. Ju e përqendroni vëmendjen në aktivitete fizike (p.sh. aerobi, not etj) dhe kjo bën që koka juaj të zbrazet nga mendimet e ndryshme që ju shqetësojnë. Ju mund të praktikoni edhe veprimtari të tjera si: të dilni shëtitje në natyrë, të bëni garë me motrat ose vëllezërit tuaj, të ngisni biçikletën, të merreni me gjimnastikë etj.

Duke praktikuar këto që përmendem me sipër, si ritet fetare dhe ushtrimet fizike, do të vëreni se stresi juaj do të zhduket pak e nga pak. Ndiqni këto këshilla që te jetoni më të lumtur; do t'ju duhet vetëm pak mund e vullnet në fillim.

Literaturë e shfrytëzuar:

KARAJ, Theodor: “*Psikologjia e stresit*”, Mokra, Tiranë, 2005.

PËRNASKA, Lajla: “*Antistres*”, Tiranë 2004.

WATSON. H.G: “*Të mposhtësh druajtjen*”, Shkolla e jetës, Tiranë, 1999.

Faleminderit PROFESOR!

Evans Drishti

*A*sokohë nuk ishim të vetëdijshëm se ç'kuptim kishte fjala "profesor", e për më tepër nuk e dinim se ç'kuptim kishte koha për të, ndonëse për ne përbënte një kënaqësi të shumëfishitë të lumbur në subkoshiencën e rrezatimit që ofronte koha e harxhuar në shoqëri me të. Megjithatë, edhe për ne koha nuk është se ishte krejtësisht e pavlerë, përkundrazi përbënte çastet më të paharrueshme që të ofronin të bëheshim pjesë e një përshpirtshmërie të panjohur më parë më parë. Ishim të shunta çaste të tilla që të mundësonin takimet me profesorin, ndonëse nuk përbënin përditshmëri, të jepnin kënaqësinë e një të përditshmeje krejtësisht ndryshe. Ai takim ishte takimi me diturinë, takim me jetën e dijetarëve, takim me plejada të mrekullueshme dijetarësh e studiuesish, të cilët në pjesën më të madhe të tyre kishin sakrifikuar njaft për kulturën, shkencën, universalitetin; kjo sepse profesori ynë ishte një studiues i denjë i kësaj fushe që në vetvete ishte erashkë e shndritshme e një botëkuptimi dhe vizioni njaft konkret e rrezatues. Ky takim ishte gjithashtu edhe një takim me durimin dhe sakrificën, modestinë dhe krenarinë, kthjelltësinë mendore dhe urtësinë e shumë e shumë virtyte të tjera të ngjashme, karakteristika këto që ishin ekzistenciale në natyrën e profesorit. Por ishte edhe një takim familjar, një takim miqësor, një takim zemrash, meqenëse profesori ynë ishte bërë tashmë një prind i dytë me afrimitetin dhe ngrohtësinë që dhuronte.

Bisedat e profesorit ishin njaft të këndshme, tepër qetësuese dhe çlodhëse, ishin biseda që ndikonin në formimin e individualitetit nëpërmjet një energjie që nuk shterroron kurrë. Nuk mërzi tej njeriu në biseda të tilla, përkundrazi nuk e kuptonte se si kalonte koha, madje kërkonte që koha të mos mbaronte asujëherë dhe shoqëria me profesorin të kishte një vijësi pa mbarim, të pakufizuar. Të krijonte një atmosferë me të vërtetë jashtë imagjinatës, të pakonceptueshme, të paimagjinueshme, një atmosferë përpirëse në strofkullën e saj ku kishte krijuar një ambient të qetë dhe inspirues.

Hyje në dhomën e tij dhe ndjeheshe sikur kishte hyrë në një tjetër botë, jashtë asaj të reales përjashta, jashtë realitetit të kohës. Hyje në botën e shkencës dhe të kulturës, në botën e librave ku çdo shkrim dhe shënim mbartte një mesazh për ne. Nuk gjeje vend për të kuptuar se ç'ngjyrë kishte muri, pasi në vend të mureve kishte rafte plot me libra, dije vërtetë e artë e një botëkuptimi të pafundëm. Një dhomë ku modestia zinte vend në çdo skaj, në çdo cep. Një tryezë pune ku natyrisht nuk mund të pretendojë të gjeje gjëra të jashtëzakonshme përveç përbërësve të dijes.

Kjo dhomë ishte bërë pjesë e jona, pjesë e një mijedisi familjar. Shumë herë kërkonim ta bënim për vete, ta kishim tonën, gjë e cila për momentin ishte e pamundur, por jo krejtësisht e pamundur, pasi

koha do ta tregonte se ç'fryte do merrnim në hapat vijues drejt rrugës së dijes.

Bisedat kryesore me profesorin ishin ato që kishim të bënim me formimin e identitetit individual dhe shoqëror. Dhoma e profesorit dhe bisedat me të ishin bërë për ne një simbol kulti i mendjeve të ndritura, një urë lidhëse mes dy a më shumë kulturave, një pedestal lunturie dhe harmonie, një vatër e ngrohtë ku ripërtëriheshim shpirtat e devotshëm të kësaj bote.

Natyrisht që asokohe e jashtëmja ofronte një atmosferë vetëkenaqësie ndoshta shumë herë më tërheqëse, një atmosferë që në panije të jashtme të ofronte një rrezatim shumëngjyrësh dhe shumëvizionesh, por që më vonë do ta kuptonim se nuk ishte gjë tjetër veçse lojë mashtruese e një identiteti krejtësisht të përkohshëm dhe të pavlerë. Por falë tij, falë punës kërkuese dhe dashamirëse, falë dashurisë që na kishte dhuruar, falë emocionit të zjarrtë, falë kërkesës së llogarisë jo ndërshtkuese por inkurajuese, ne ishim bërë pikërisht pjesë e tij dhe jo pjesë e atmosferës së jashtme.

Do ta kuptonim vonë se sa shumë kishte luftuar profesori me mëndjen dhe shpirtin tonë, sa shumë kishte luftuar me kohën, sa shumë ishte lodhur për të na bërë të qëndrueshëm dhe të përballeshëm në erashkën e kohërave. Çdo kohë dhe minutë, madje edhe sekondë që kalonim me të ishte më me vlerë se mijëra e miliona minuta që do kalonim qoftë në botën e jashtme. Nuk kuptonim për momentin, por në fund të fundit a nuk ishim edhe ne për atë qëllim, të kuptonim një dukuri të tillë?

Isim të brishtë para kthetrave të kohës, ishim çunakë përpara fortesave të hekurta prandaj edhe kishim ardhur pranë dijes dhe vizionit të tij, pranë botës së tij për të marrë sado pakëz nga dija dhe përvoja e fituar për vite me radhë. Në fakt nuk e kuptonim se na ishte dhënë një mundësi e paimagjinueshme të udhëtonim për një kohë të shkurtër në mijëra momente e çaste, në vite e vite të kaluara, duke formuar kështu një mendje të re në një botë të re. Profesori po ndërtonte jetë të reja dhe ne nuk e kuptonim; profesori i lidhte vazhdimisht dru zjarrit bubulak që të mos shuliej asnjë çast dhe ne përsëri silleshim si të pavetëdijshëm. Në fakt ishim të vetëdijshëm, sepse ia kishim dalë mbanë të mbërrinin deri aty, përmes një një pune që kërkonte vullnet dhe sakrificë, sado të vogla që të ishim ato.

Pas shumë e shumë mundimesh dhe sakrificash, përpjekjesh në rrugën e dijes, në rrugën e formimit të kosliencës, në rrugën për të kërkuar vetveten, koha na solli pikërisht këtu ku jemi sot. Tashmë jemi të vetëdijshëm se koha që profesori harxhoi me ne na solli pikërisht këtu, në shërbim të njerëzve, në rrugën e kërkimit të vlerave dhe dhuntive. U kthyem vite më parë për të kuptuar se ç'vlerë kishte dhoma e profesorit, ngrohtësia që na dluroi. Ç'kuptim kishim raftet plot libra që kishim penguar muret, ç'kuptim kishte modestia. Tashmë e kuptuam, edhe pse ndoshta jo plotësisht, që profesori kishte hapur themele të forta në përballje me stulitë e të kohërave, për të ndërtuar mbi to ndërtesa shumëkatëshe ku do gjenin prehje brezni të tëra. Profesori e kishte ditur se dhoma e tij nuk do njaftonte për vite më vonë, pasi të tjerë njerëz do kërkonin të bëheshin pjesë e asaj dhome, të tjerë njerëz do kërkonin të ishin pjesë e jetës së profesorit, por profesori ynë kishte përgatitur që me kohë terrenin e dulur për trashëgimtarët e tij, kishte përgatitur testamentin e jetës. Prandaj, mirënjohje profesorit për kohën që vuri në dispozicion, mirënjohje për vullnetin dhe sakrificën e pashtershme, për dashurinë që na dluroi, për gjithçka që na dha për t'u ndjerë krenarë që jemi vetvetja.

Faleminderit profesor

Myftijtë dhe myderizët e vilajetit të Janinës sipas regjistrit protokollar Janinë-Meshihatit Stambollit

Pas ndarjes të fundit administrative të vitit 1868 në rang perandorie tokat shqiptare u riorganizuan brenda kufijve të katër vilajeteve, Shkodrës, Janinës, Manastirit dhe Kosovës. Vilajeti i Janinës përbëhej nga katër sanxhaqe të cilat ishin sanxhaku i Janinës, i Gjirokastrës, i Beratit dhe i Prevezës. Sanxhaku i Janinës përfshinte kazatë e Paramithisë (Ajdonat), Filatit, Konicës, Leskovikut dhe Meçovës, ai i Gjirokastrës përfshinte kazatë e Pogonit, Përmetit, Tepelenës, Delvinës dhe Kurveleshit, ai i Beratit kazatë e Vlorës, Gosinckës, Skraparit dhe Lushnjës, ai i Prevezës kazatë e Lorosit, Margëlliçit dhe Filatit.

Përveç këtyre vilajeti i Janinës përfshinte edhe nahijet e Zagorisë, Korintosit, Frasharit, Sarandës, Himarës, Mallakastrës, Fierit, Çemernikës, Pargës dhe Fenarit.

Regjistri protokollar mes Meshihatit dhe vilajetit të Janinës, që ruhet në Stamboll, hedh dritë mbi lëtrëkëmbimin zyrtar mes njësiye kryesore të Meshihatit siç qenë Fetvahane, Mexhlisi Tetkikati Sherije, Mexhlisi Intihabi Hykam, Mexhlisi Idareji Emvali Ejtam me qendrën e vilajetit të Janinës dhe zyrat e mytesarifëve që vareshin prej saj.

Pjesa dërrmuese e informacionit protokollar ka të bëjë me mbarëvajtjen e personelit të gjyqeve fetare, ose mahkemeji sherije, të cilat mbulonin çështjet e të drejtës civile në sistemin ligjor otoman. Gjykatat fetare funksiononin sipas administrimit dhe burokracisë së stilit francez, i cili aplikohet në të gjithë administratën otomane që nga mesi i shek. XIX deri në fundin e perandorisë. Gjykatat fetare mbulonin çështjet e martesave, divorceve, prokurave, kujdesarisë së fëmijëve, akteve të trashëgimisë dhe mosmarrëveshje ordinere me të cilat nuk merreshin gjy-

katat e rregullta otomane (mahkemeji nizamije).

Që në periudhën pas Tanzimatit, gjykatat fetare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe duket se kanë pasur autoritet me vendimet e tyre, nisur nga fakti se këtu aplikonin për zgjidhje konfliktesh ose lidhje kontratash edhe persona të besimit jo mysliman. Kështu, në një shënim protokollar të vitit qershor 1306 R shkruhet se Dhimitri Kaldemos i besimit protestant, me banim në Korfuz, paraqitet në gjykatë në lidhje me divorcin që ka me të shoqen, apo rasti i aplikimit në këtë gjykatë i një çifuteje.

E njëjta situatë duket edhe në Shkodër. Kështu në një akt blerjeje të vitit 1813 banorët e krishterë të lagjes Perash, Koli dhe Lazri i shisnin kujdestarit të kishës së Irmanjit në Shkodër Tom Pjetër Gurakuqit banesën e tyre në këtë lagje. Ky akt lidhet në praninë e gjykatësit të fesë, kadiut dhe mbante vulën e tij.

Regjistrat protokollar kanë si kufinj të skajshëm vitet 1885 dhe 1912, por shënimet protokollare të shumë viteve mes tyre nuk kanë mbërritur deri në ditët e sotme, duke bërë që të mos kemi një informacion të plotë për periudhën në fjalë.

Përkrah informacionit në lidhje me emërimet, zëvendësimet, shkarkimet, daljen në pension, çështjet e rrogave dhe të pensioneve që merrte familja e gjykatësit fetar pas vdekjes së këtij të fundit, në regjistrin protokollar gjenden të dhëna interesante edhe për çështje të tjera si për myftinjët, myderizët, objektet e kultit, por në numër të vogël.

Nga jeta shoqërore në regjistrin protokollar të Janinës kemi një përshkrim për rrugicat e ngushta të Gjirokastrës dhe pamundësinë që krijojnë ato për



kapjen e grabitësve që hidhen nga njëra shtëpi në tjetrën, rastin e vendimit të gjykatës së Beratit për djegien e një shtrige (xhadë) që ndodhet në lagjen Murat Çelebi, vendim që zyra e Fetvave (Fetvahanë) e ka cilësuar të pavlefshëm, apo rasti kur kërkohet të verifikohet nëse gjykatësi fetar (naib) i Beratit, Sezaiu ka lejuar një lidhje martesore mes një çifuti të quajtur Jehodha Ajoa dhe një vajze myslimane Fatimesë, bijës së Osmanit nga një fshat i Beratit, zhvleftësim të këtij vendimi në rast se është dhënë, dhe marrje mase të rreptë ndaj gjykatësit në qoftë se vërtetohet se ka dhënë një vendim të tillë.

Regjistri i protokollit mes vilajetit të Janinës dhe Meshihatit në pjesën dërrmuese trajton çështje lidhur me institucionin e gjykatave fetare, më saktë me veprimet administrative në lidhje me personelin e këtyre gjykatave me në krye gjykatësit fetarë (nai-

bët).

Megjithatë, mes protokollit të mbajtur mund të gjenden në mënyrë të vogël krahasuar me totalin e shënimeve protokollare edhe të dhëna në lidhje me myftinjtë, myderrizët dhe me ndërtime të kultit në vilajetin e Janinës.

Në periudhën e fundit të sundimit Osman në Ballkan, duket se institucioni i myftiut qëndron mes dy të vërtetash së skajshme. Përveç vendit të veçantë që zinte në rangun fetar, myftiu kishte vend të caktuar me ligj edhe brenda administratës osmane, pa përmendur detyrat e përkohshme zyrtare në të cilat ai angazhohej herë pas here, duke u vlerësuar si person i besueshëm dhe i drejtë. Kështu, myftiu ishte anëtar i drejtpërdrejtë, për shkak të postit, jo me votim, në këshillin e përgjithshëm të vilajetit në të cilin trajtohe-

shin çështje shumë të rëndësishme dhe merreshin vendime të cilat më pas i komunikoheshin qendrës së perandorisë. Gjithashtu, ai ishte anëtar i këshillit të arsimit për vilajetin. Por përkundrejt posteve të rëndësishme që kishte brenda administratës, shohim se ai paguhej me rroga pak sipër rrogës së ultë. Krahasuar me pagën e gjykatësit të fesë (naib), paga e myftiut ishte disafish më e ulët. Kështu, nëse rroga e myftiut të vilajetit të Janinës ishte 500 kurush, rroga e naibit të Janinës ishte 4500 kurushë, nëse rroga e myftiut të Gjirokastrës qe 100 kurush, rroga e naibit të Gjirokastrës ishte 2000 kurush. Kjo bënte që herë pas here, këshilli administrativ i vilajetit të kërkonte nga Meshihati rritje rroge për myftinjtë që ishin në nevojë. Rroga e ulët bënte njëkohësisht që myftinjtë të qëndronin për një kohë të gjatë në këtë post.

Shënimet protokollare të vilajetit të Janinës lënë të kuptohet qartë se në këtë periudhë detyrat e myftiut dhe të myderrizit, në mënyrë të veçantë për kazatë e Janinës si Tepelena, Delvina, Vlora etj. Mbuloheshin nga një person. Më saktë, detyrën e mbetur bosh të myderrizit e kryente myftiu dhe e kundërta myftiu përzgjidhej nga myderrizët e zonës. Kjo bënte që zyra e financës së kazave të ndryshme të pyesnin shpesh herë qendrën nëse në këto raste duheshin paguar dy rroga apo vetëm një.

Nga regjistri i protokollit mes vilajetit të Janinës me Meshihatit, kemi gjetur këto të dhëna për myftinjtë dhe myderrizët.

Në datën janar 1894 si myderriz në Vlorë caktohet Ahmet Rifat efendiu, të cilin në shkresën e datës shtator 1910 e gjejmë tashmë myfti të në këtë vilajet.

Në Paramithi qenë myfti Mehmet Tevfik efendiu, siç përmendet në shkresën me datë 26 korrik 1891, hafiz Mustafa efendiu që u emërua në këtë post me datë gusht 1899 dhe Nakësh efendiu, për të cilën në shkresën me datë qershor 1908 kërkohet që t'i shtohet rroga për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike që gjendej.

Paramithia, ose siç e quanin osmanët në dokumentacionin zyrtar Ajdonati, së bashku me Beratin, Nartën dhe Shkodrën janë kazatë, medresetë e të cilave përmenden që në shekullin e XVI në ruznamet e kazaskerit të Rumelisë. Kështu, në medresenë Hasan Çelebi të Paramithisë gjejmë si myfti Himet efendinë, Muslihudin efendinë dhe Dervish efendinë në vitet 1581 dhe 1588, ndërsa në medresenë Piri Reis të Paramithisë myderriz qe Mustafa efendiu në

vitin 1590.

Mes viteve shkurt 1909 dhe shkurt 1911 si myderriz në Paramithi ishte Musa Qazimi, i cili më parë kishte kryer të njëjtën detyrë në Margariti.

Në Berat gjejmë në detyrën e myftiut që nga viti qershor 1884 Mehmed Esad efendiu. Në shkresën e datës shtator 1889 kërkohet që atij t'i lidhet një rrogë e mirë, pasi që "e kryen në mënyrë të përsosur detyrën e dhënies së fetvave dhe i shpjegon shumë qartë çështjet e fesë". Ky person qëndroi në këtë detyrë për një kohë të gjatë. Për të flitet të paktën deri në vitin 1900.

Me datë tetor 1909 vilajeti njoftonte qendrën se Ragip efendiu i zgjedhur në postin e myftiut nuk përfaqësonte dëshirën e masave, informacioni i cili u vlerësua me sa duket nga Meshihati pasi që me datë janar 1910 në këtë post gjejmë të zgjedhur Esat efendinë.

Në muajin gusht të vitit 1888 në Berat përmendet Ragip efendiu, i cili megjithëse është marrë edhe me punë të tjera administrative si anëtar i gjykatës së shkallës së parë dhe anëtar i bashkisë, të shumtën e kohës e ka kaluar me detyrën e myderrizit.

Nga viti 1879, detyrën e myderrizit në medresenë e kasabasë së Beratit e mbulonte Mehmet Esat efendiu, të cilit me datë dhjetor 1899 i caktohet rroga 500 kurush me ferman të sulltanit, me motivacionin "për punën e palodhur që kryen për të mësuar çdo ditë në medrese mbi 80 fëmijë, nga 5-6 orë lëndë të ndryshme, duke përhapur kështu diturinë në një vend aq të rëndësishëm si Berati."

Organizimi i fundit i rëndësishëm që osmanët kryen brenda vilajetit të Janinës, qe krijimi i sanxhakat të Çamërisë, krijuar me fermanin sulltanor të datës 7 korrik 1910. Në dokumentacionin osman, ky sanxhak herë quhet Çamllëk (Çamëri), herë Reshadije. Myftiu i parë i këtij sanxhaku ishte Jusuf Zijaudini nga familja Myderizi, të cilit ju caktua rroga 250 kurush. Ai e vazhdoi këtë detyrë të paktën deri në muajin prill të vitit 1911, sepse në regjistrin protokollar përmendet se ka zëvendësuar naibin e këtij sanxhaku, kur ky ka qenë me leje pune.

Në Delvinë mësojmë se në detyrën e myftiut ka qenë në muajin shkurt të vitit 1911 Harun efendiu, i cili vlerësohet nga organet e administratës osmane për punën efektive që po kryente me vaazët që mbante kundër frymës hurufi të bektashinjve të kë-

tyre zonave.

Në Gjirokastrë, me datë korrik 1886 caktohet ish-naibi i Prilepit Mehmet Nuri efendiu, por nga shkresa e datës dhjetor 1886 mësohet se ai është kthyer në Stamboll, pasi nuk ka pranuar të kryente njëkohësisht edhe detyrën e myderrizit në Gjirokastrë. Kështu, me datë mars 1887, si myfti i Gjirokastrës caktohet myderriz Abdulhamit efendiu, i cili gjendet në këtë post të paktën deri me datë 6 nëntor 1893.

Prej datës 26 korrik 1908, në këtë detyrë gjendej Bajezit efendiu.

Me datë 22 maj 1911, si myfti të Gjirokastrës ndodhej Hysen efendiu, i cili në këtë vit duhet të ketë qenë në moshë shumë të shtyrë, sepse nisur nga rasti i tij, vilajeti i drejton Meshihatit pyetjen nëse mund të lihet në detyrën e myftiut një person që është shumë në moshë, megjithëse mendjen dhe fizikun e ka në rregull.

Në muajin tetor 1909, si myderriz të Gjirokastrës punonte Hasan Tahsin Efendiu, ndërsa me datë maj 1910 mësojmë se myderrizi i Gjirokastrës Mustafa efendiu ka shkuar në vendlindjen e tij në Mersin, por nuk është kthyer, prandaj një muaj më pas në qershor 1910 kërkohet që në vend të tij të caktohet një myderriz tjetër. Me datë mars 1911, vilajeti i kërkon Meshihatit të rishikojë vendimin për caktimin në detyrën e myderrizit të Ismail efendi Bakrit, sepse ai njihet si person i paaftë, por kjo kërkesë duket që nuk u morr parasysht se me datë gusht 1911 Ismail efendiu u caktua në këtë post.

Me datë shtator 1884, në Filat qe myfti Mustafa Hajriu, të paktën deri më datë 11 dhjetor 1890.

Në vitin 1894, në këtë myftini caktohet Davut Efendiu, ndërsa në vitin 1911 këtu myfti qe myderriz Mehmet Efendiu.

Në vitin 1909, myftiu i Skraparit ishte Ahmet Muh-tar Efendiu.

Me datë mars 1899, në detyrën e myftiut të Lorosit qe Mehmet Nuri Efendiu, me datë janar 1911 hafiz Abdullah efendiu, rroga e të cilit kërkohet të lidhet nga të ardhurat e xhamisë së kasabasë së Lorosit, ndërsa me datë mars 1912 në këtë detyrë caktohet Nabi efendiu.

Mes datave qershor 1909 dhe korrik 1912 në detyrën e myftiut ndodhet Adem efendiu.

Në vitin 1894 myfti i Pargës qe Adem Feraizi.

Nga viti 1895, deri në vitin 1912 myfti i Përmetit qe Xhelal efendiu nga Gjirokastra.

Para muajit shkurt të vitit 1911 myfti i Prevezës ka qenë Ismail Hakki efendiu, por fakti që në muajin shkurt të vitit 1911 mësohet se ai ka shkuar në portin Pire të Greqisë, bën që ndaj tij të miratohet urdhëri i shkarkimit nga detyra. Në datën prill 1911, në këtë detyrë caktohet myderrizi i Paramithisë Musa Qazimi, i cili në muajin korrik 1912 jep dorëheqjen nga kjo detyrë.

Në datën shtator 1910, njoftohet qendra se myderrizi i Prevezës Ahmet Zaim efendiu është larguar pa marrë leje nga vendi i punës, por në shkresën e datës dhjetor 1911 që qendra i dërgon vilajetit njoftohet se ai është larguar për në Izmir, për shkak se gjendja shëndetësore e së shoqes ka qenë tepër e rëndë dhe se do të kthehet sërish në detyrë.

Data 16 gusht 1910 qe dita e parë e punës si myfti i Tepelenës për Shuajp efendiu, sipas regjistrit të protokollit. Ai ishte njëkohësisht edhe myderrizi i medresesë së Ali pashë Tepelenës, që gjendej në këtë qytet.

Me datë shtator 1883 myfti i Janinës qe Mustafa efendiu për të cilin ka ardhur ankesa se "bashkëpunon me persona interesaxhinj dhe organizon protesta të ndryshme", por me sa duket kjo ankesë nuk u vërtetua, pasi që në muajin qershor të vitit 1887 ai dekorohet nga ana e Meshihatit. Me datë 14 shkurt 1895, si myfti i Janinës caktohet Mehmet Ali efendiu. Në muajin shtator të vitit 1897, myfti i Janinës qe Abdurrahman efendiu, ndërsa në muajin nëntor të vitit 1909 kërkohet të hiqet nga detyra myftiu Emin efendiu, i cili ka kaluar moshën 70 vjeçare. Në muajin mars 1911, si myfti i Janinës caktohet Mehmet Fuat efendiu që ishte njëkohësisht edhe kryesekretari i gjykatës fetare.

Me datë 24 gusht 1910, si myderriz qendror në vilajetin e Janinës ndodhej Safet efendiu.

Me datë korrik 1910 kërkohet që rroga e myderrizit të Meçovës t'i kalojë myderrizit të Pargës, haxhi Hysen efendiut, meqenëse popullsia myslimane e atjeshme është në numër më të madh se ajo e Meçovës.



Cilat janë gabimet më të mëdha TË PRINDËRVE?

*N*ë lidhje me fëmijët ekzistojnë tre gabime të mëdha:

Ende nuk kuptohet shkaku i mungesës së durimit të rriturve karshi fëmijëve si dhe tendenca për t'i fajësuar ata sa më tepër. Edhe pse ndoshta nuk jemi të vetëdijshëm për këtë, fëmijët jetojnë në një realitet tërësisht të tyrin, andaj duhet të kemi kujdes ndaj përdorimit të fjalëve fyese dhe tallëse.

Në edukimin e fëmijëve, roli shoqëror është shumë i rëndësishëm. Në rastet kur ata sillen mirë, një përkëdhelje e juaja, një urim apo një fjalë e ëmbël mund të ndikojë shumë te ato; në rast të kundërt një sjellje e ftohtë e juaja përsëri do të ndikonte në

mirëorientimin e tyre. Nëse familjet s'e përdorin këtë rol shoqëror në mënyrën e duhur, padyshim që shfaqja e rezultateve negative do të jetë e pashmangshme.

SJELLJET FAJËSUESE

Gjatë procesit të rritjes, fëmijët mund të shfaqin sjellje pozitive apo dhe negative. Në rastet kur fëmija shfaq sjellje negative, nëse ne luajmë rolin e orientuesit për të, duke i shpjeguar me durim arsyen pse ajo sjellje nuk duhet shfaqur, padyshim që ne kemi kapur në kohë një rast të volitshëm për ta edukuar fëmijën. Në këtë mënyrë, ai edhe do të mësojë të vërtetën, edhe do jetë i aftë për jetën.

Fatkeqësisht, në shumicën e rasteve ne shfaqim sjellje fajësuese ndaj fëmijëve, biles shumë prindër shfrytëzojnë rastin t'i qortojnë fëmijët e tyre në prani të të tjerëve. Kuptohet që edhe shkalla e shqetësimit të fëmijës është në raport të drejtë me dy rastet e mësipërme. Fëmija asnjëherë nuk duhet të zhvlerësohet dhe të injorohet, veçanërisht në prani të të tjerëve. Në vend të kësaj, duhet të ndërtohet një dialog i ngrohtë këshillues: "Shih biri im, kjo mua më mërzi shumë, nuk duhej ta kishe bërë...", një dialog ku synohet të kuptohet shkaku i veprimt. Mbase fëmija ka një arsye të drejtë për veprimin e bërë, mbase nuk është fare i vetëdijshëm për gabimin e bërë.

Hz. Esmaja shembulli i sakrificës dhe vetmohimit

Hz. Esmaja është vajza e shokut të ngushtë të Profetit (s.a.s) Hz. Ebu Bekrit (r.a) i cili u zgjodh edhe halifja i parë pas vdekjes së tij. Është motra e "nënës së besimtarëve" Hz. Aishes (r.a) dhe gruaja e Zybejr ibn Avvomit.

Ajo njihej për nderin, durimin dhe kontributin e pasqor për përhapjen e islamit. Shpenzonte shumë në rrugë të Allahut dhe ndihmonte gjithnjë njerëzit në nevojë.

Shërbimi i parë i Hz. Esmasë u shfaq në kohën e hixhretit. Kur Allahu (xh.sh) lejoi Profetin (s.a.s) të emigronte nga Meka në Medine ai u drejtua menjëherë tek shtëpia e Hz. Ebu Bekrit për t'i treguar sihariqin e ardhur nga Allahu. Hz. Ebu Bekri gëzohet shumë nga ky lajm, ndërsa Hz. Esmaja fillon menjëherë të përgatisë plaçkat dhe ushqimet për udhë të Dërguarit të Allahut (s.a.s) dhe babait të saj, Hz. Ebu Bekrit (r.a). Pasi përgatiti çdo gjë, nuk arriti të gjente një lidhëse për bidonin e ujit dhe për trashën e ushqimeve. Menjëherë hoqi brezin që kishte në bel dhe e ndan në dy copa. Me njërin lidh bidonin e ujit, ndërsa me tjetrën lidhi trashën e ushqimeve. Duke qenë i pranishëm në kryerjen e një gjesti të tillë vetmohimi dhe sakrifice, Profeti (s.a.s) iu drejtua Esmasë duke i thënë: "O Esmaja, në xhennet ti do të zotërosh dy breza". Dhe që nga kjo



Të dish të falenderosh...

Kur ishit 1 vjeç ju lante dhe ushqente me duart e saj, ndërsa ju e falenderuat duke qarë gjithë natës e duke e lënë zgjuar...

Kur ishit 2 vjeç ju mësoi të ecnit, ndërsa ju e falenderuat duke mos e dëgjuar kur ju kërkonte t'ju kishte pranë...

Kur ishit 3 vjeç ju përgatiste ushqimin me aq dashuri, ndërsa ju e falenderuat duke derdhur përherë pjatën poshtë tavolinës...

Kur ishit 4 vjeç ju blinte lapsa ngjyra ngjyra, ndërsa ju e falenderuat duke zhgaravitur të gjithë muret e shtëpisë...

Kur ishit 5 vjeç ju zbukuronte me rroba aq të bukura, ndërsa ju e falenderuat duke u zhytur nëpër gropa balte...

Kur ishit 6 vjeç ju përcolli deri tek oborri i shkollës, ndërsa ju e falenderuat duke bërë të rrugës : “nuk dua të

shkoooj!...”

Kur ishit 7 vjeç ju dhuroi një top për të luajtur, ndërsa ju e falenderuat duke thyer xhamat e komshinje...

Kur ishit 9 vjeç ju mësoi dua e lutje të shumta, ndërsa ju e falenderuat duke i harruar ato shumë shpejt...

Kur ishit 11 vjeç ju shoqëroi në kinema bashkë me shokët tuaj, ndërsa ju e falenderuat duke i thënë : “ tani ti mos u ul pranë nesh...”

Kur ishit 12 vjeç nuk dëshironte të shihnit programe të dëmshme televizive, ndërsa ju e falenderuat duke i ndjekur ato sapo ajo largohej nga shtëpia...

Kur ishit 18 vjeç u kujdes për shpenzimet tuaja të shkollës, ndërsa ju e falenderuat duke u përqaftuar me të tek dera e shkollës që shokët të mos ju shihnin...

Kur ishit 25 vjeç u kujdes për shpenzimet tuaja të dasmës, ndërsa ju e falenderuat duke u shpërngulur në anën tjetër të botës...

Kur ishit 30 vjeç dëshiroi t'ju jepte ndonjë mendim për fëmijët tuaj, ndërsa ju e falenderuat duke i thënë : “lëri këto këshilla të prapambetura...”

Kur ishit 50 vjeç ajo u sëmur shumë, ju gjetët kohë vetëm në fundjavë për ta vizituar. Ajo u lumturua aq shumë sa qau nga gëzimi, ndërsa ju e falenderuat duke i thënë : “ këto pleqt bëhen nazeli si fëmijët...”

NJË DITË AJO VDIQ...

Dhe gjithë çka nuk kishit për të bërë deri atëherë, ra si një shigjetë në zemrën tuaj...



ditë, Hz. Esmasë do t'i thuhej “ dhatu'l-nitakaj” “ zotëruesja e dy brezave”.

Gjatë Hixhretit, teksa Profeti (s.a.s) dhe babai i saj Hz. Ebu Bekri u detyruan të qëndronin për tre ditë me radhë në shpellën Thevr, duke u bërë ballë gjithë kërcënimeve të politeistëve, Hz. Esmaja arriti t'u dërgonte atyre ushqime si dhe lajme të reja nga Meka.

Hz. Esmaja karakterizohej edhe nga zgjuarsia dhe mendjeprehtësia. Gjatë Hixhretit, Hz. Ebu Bekri i kishte marrë me vete gjithë paratë, me mendimin se do t'iu duheshin gjatë udhës. Babai i tij, Ebu Kuhafe, i cili nuk e kishte pranuar akoma islamit, ishte nervozuar shumë nga akti i të birit. Për ta qetësuar gjyshin e saj, Hz. Esmaja kishte marrë një enë, e kishte mbushur me gurë të vegjël, dhe sipër i kishte hedhur një copë pëlhure dhe, duke ia vënë para duarve gjyshit të verbër, e kishte ngushëlluar me fjalët: “ Gjysh i dashur, babai na ka lënë gjithë këtë pasuri”.

Hz. Esmaja ishte një grua dorëlëshuar, me një zemër të pasur, ndihmonte shumë të varfërit dhe gjithnjë iu gjendej afër jetimëve, sepse një ditë Profeti (s.a.s) i kishte thënë: “ O Esmaja,

harxho shumë në rrugë të Allahut, jep shumë sadaka dhe bëju mirë të tjerëve, sepse çdo veprim i kryer për pëlqimin e Allahut shpërblehet me sevape të shumta”. Me t'i dëgjuar fjalët e Profetit (s.a.s), Hz. Esmaja kishte filluar t'i praktikonte.

Ashtu siç karakterizohej nga një besim i fortë dhe i palëkundur, ajo shquhej edhe për virtytet më të vyera të një nëne. Në martesën me Hz. Zybejr, Allahu i kishte falur 8 fëmijë. Gjithnjë interesohej për edukimin e tyre me frymë islame, duke iu ngulitur atyre thellë në zemër moralin e bukur dhe edukatën e lartë fetare, ashtu si Abdullah Ibn Zybejr i cili është cilësuar ndër sahabet më të mëdhenj sakrificues. Hz. Esmaja ishte nënë e dhembshur. Padyshim mundimi më i madh për një nënë, është të përjetojë vdekjen e të birit. Ndërsa Hz. Esmaja, si mishërim i durimit dhe i sakrificës, i ishte drejtuar Haxhaxhit i cili kishte vrarë të birin e saj, duke i thënë: “ Ju ja shkatërruat atij këtë botë, ndërsa ai ju shkatërroj juve ahiretin”.

Ajo u bë shembull i gjallë vetmohimi, sakrifice dhe durimi, duke u bërë shembull i këtyre virtyteve të vyera për gjithë brezat e mëvonshëm. Vdiq në moshën 100 vjeçare në vitin 73 hixhri.



Kuroni diabetin, duke rregulluar gjumin



Të kurosh diabetin duke zgjidhur problemet që mund të keni me gjumin. Kjo është këshilla më e fundit që japin shkencëtarët, pas një sërë ekzaminimesh dhe analizash pa fund, të cilat bëjnë një lidhje mes sëmundjes dhe gjumit jo të mirë që bëhet gjatë natës.

Ky zbulim i bërë në një studio të madhe të ADN-së, mori në shqyrtim më shumë se 36 mijë evropianë, diabetikë ose jo-diabetikë, të të gjitha moshave.

Ndihmuan për këtë studim Imperial College në Londër, këshilli kombëtar i kërkimeve franceze CNRS, Lille University dhe McGill University në Kanada. Te gjitha u publikuan në revistën “Nature Genetics”.

Ekspertët zbuluan një lloj mutacioni në gjenin “MTNR1B”, që u etiketua nga shkencëtarët si “hormoni i gjumit”. Melatonina është një rregullues i rëndësishëm i ritmit gjumë/zgjim, dhe prodhohet gjatë natës, duke

arritur një lloj kulmi gjatë kësaj kohe, ndërkohë që kur afrohet mëngjesi nis të pakësohet.

Përkundër kësaj, insulina, hormoni që rregullon sheqerin në gjak prodhohet gjatë ditës, ndërkohë që gjatë natës prania e saj vjen duke u zvogëluar.

Prej kohësh dihej se të flije pak bën keq për shëndetin, dhe kjo ishte e lidhur me rrezikun e diabetit, por deri më tani nuk dihej arsyet.

BB: Shqipëria e para për konsumimin e barnave

Studimi i Bankës Botërore pohon se farmacistë shkelin ligjin duke dhënë barna pa recete.

Shqipëria ka kapur kreun e top listës për përdorimin e tepruar të medikamenteve. Studimi i fundit i Bankës Botërore bën një krahasim lidhur me shpenzimet që bën vendi ynë për barnat (përqindjen që ato zënë në shpenzimet në total për shëndetësinë), krahasuar me vende si Sllovakia, Hungaria, Çekia, Japonia, Mesatarja e Bashkimit Evropian, Greqia, SHBA dhe Holanda.

Krahasimi i këtyre të dhënave tregon qartë tendencën se Shqipëria kërkon t'i zgjidhë problemet shëndetësore më së shumti përmes medikamenteve. Deri në 32% të shpenzimeve të përgjithshme për shëndetësinë në të harxhojmë për barna.

“Vlerësimet e shpenzimeve farmaceutike përllorësit në 23-32% të shpenzimeve të përgjithshme për kujdesin shëndetësor në Shqipëri”, thuhet në studimin e Bankës Botërore, ku shtohet se mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian për barnat është 14% e totalit të fondit për shëndetësinë.

Po sipas studimit, në SHBA shpenzohet për barnat vetëm 12% e totalit për shëndetësinë, duke pranuar se këto vende gjejnë të tjera rrugë që e shmangin “dendjen” me barna të pacienteve, ose së paku nuk fillojnë direkt me alternativat e fundit, siç ndodh rëndom në vendin tonë.

Arsyen se përse ndodh hipermedikalizimi në vendin tonë, Banka Botërore e lidh me faktin e marrjes së barnave pa recetë në farmaci.

Ligji nuk e lejon marrjen e barnave pa recete nëpër farmaci, me përjashtim të një liste të vogël barnash, të miratuar nga OBSH-ja. Mirëpo realiteti flet ndryshe. Megjithëse ligji nuk e lejon, në farmacistë tona mund të marrësh çfarëdolloj medikamenti, me çfarëdo risku dhe efektsh anësore që ai paraqet, mjafton të kesh aftësinë pague për të.

Niveli profesional jo i mjaftueshëm i mjekëve të praktikës së përditshme klinike është një tjetër faktor që ndikon në hipermedikalizimin, i cili vjen si pasojë e nevojës për të mbyllur deficitin e tyre me një mbingarkim të recetës me sa më shumë barna.

Një faktor tjetër është edhe mungesa e një organizmi që do të mbronte pacientët nga gabimet e mundshme mjekësore dhe nga abuzimi me ta. Në këtë kontekst, mjeku asnjëherë nuk përgjigjet për dëmet shëndetësore që mund t'i shkaktohen pacientit nga përshkrimi i tepërt i barnave.

Shoqëria shqiptare mbetet ende një shoqëri jo dhe aq e ndërgjegjësuar, që kërkon të zgjidhë gjithçka me barna, meqenëse mungojnë mekanizma të tjera që rregullojnë e plotësojnë njëra-tjetrën.



Shpikjet më të mëdha të vitit 2009

NJU JORK-Revista amerikane Times publikoi 50 shpikjet më të mira të vitit. Kush ishin shpikjet më të mira të 2009? E surprizat nuk mungojnë... Në këtë listë gjenden objekte të të gjitha kategorive të mundshme, si p.sh. makina me avull më e shpejta në botë, që renditet në vendin e 50, e para digicamera 3D, helikopteri Sikorsky X2 Technology që udhëton me shpejtësinë 467 km/orë, makina për Formula 1, e realizuar me materiale ekologjike, pinguini robot që fluturon e flet, ferma vertikale në qytet etj. Po kush gjendet në Top Ten?

Në vendin e 10 renditet syri elektronik MIT, i cili i dhuron të verbërve një shikim të pjesshëm. Në vendin e 9 është sistemi i komunikimit me anë të mendimit, i përdorur në Twitter; në vendin e 8 vaksina e re kundër SIDA-s; teleskopi Herschel Space Observatory, që arrin të shikojë të gjitha yjet e padukshme zë vendin e 7; në vendin e 6 renditet eksperimenti i realizuar në University of Maryland, me anë të të cilit u telettransportua një atom; në vendin e 5 renditet projekti revolucionar Project Natal Xbox; sistemi EnergyHub Dashboard, i përdorur për të kontrolluar dhe zvogëluar



konsumin energjetik në shtëpi renditet në vendin e 4. Podiumin me tre vendet e para në listën e shpikjeve më të mira të viti 2009 e zënë: llamba inkandeshente LED me një konsum shumë të ulët e me një jetë shumë të gjatë (25.000 orë) në vendin e 3; sistemi Tnak Brend në vendin e 2; ndërsa në vendin e parë gjendet raketa Ares e NASA-s, e cila do të zëvendësojë Shuttle dhe do të mund ta çojë qenien njerëzore në Hënë e në Mars.

Shpikjet e vitit 2008

Viti që po lëmë pas ka parë zhvillime të reja edhe në fushën e shkencës, por ai që ka bërë më shumë përshtypje është “Riprogramimi i qelizave”. Zbulimi tregon aktivizimin e një grupi genesh që bëjnë të kthehet pas “ora” e qelizës deri në gjendjen embrionale. Ky është zbulimi më i madh i vitit 2008, pasi për mjekësinë dhe kurimin e sëmundjeve të Alzheimerit dhe Parkinsonit hap një rrugë të re shprese.

Edhe kësaj radhe revista shkencore më prestigjioze “Science” ka publikuar 10 zbulimet më të mëdha të vitit dhe ka parashikuar edhe zbulimet më të mundshme për

12 muajt që na presin. Klasifikimi vijon si më poshtë;

Vendi 2. Në vendin e dytë të kësaj renditjeje vjen i ashtuquajtur “exoplanets”, vëzhgimi i dy planetëve jashtë sistemit diellor. Për herë të parë në vitin 2008, astronomët vëzhguan drejtpërdrejt planetet orbitalë përtej sistemit diellor, falë teknikave të avancuara teleskopike, që janë në gjendje të dallojnë dritën e dobët të planetëve.

Vendi 3. Katalogu i geneve tumorale. Ky është një zbulim që do të ndikojë shumë në mjekësi, pasi zbulohet për herë të parë katalogu i geneve të lidhura drejtpërdrejt me tumoret.



Vendi 4. Gjatë vitit 2008 janë zbuluar materiale të reja, në gjendje të mbajnë energji dhe temperatura të larta.

Vendi 5. Gjatë vëzhgimit të proteinave, shkencëtarët kanë zbuluar shumë të reja për proteinat “në gjendje pune”, të cilat lidhen me qelizat dhe modifikojnë metabolismin.

Vendi 6. Ky zbulim ka të bëjë me rëndësinë e teknikave të reja për të depozituar energjinë elektrike të prodhuar

nga energjia diellore dhe burime të tjera natyrore.

Vendi 7. Pamje mbresëlënëse vijnë nga fotot e marra gjatë fazës së zhvillimit të embrionit. Shkencëtarët kanë mundur të analizojnë zhvillimin e një kafshe që nga faza më fillestare e deri në kompletimin e organizmit. Ky studim është bërë nëpërmjet mjeteve shumë të përparuara.

Vendi 8. Në luftën kundër obezitetit është arritur shumë gjatë 12 muajve të fundit, pasi janë marrë shumë të dhëna për karakteristikat e të ashtuquajturit “E shëndetshmja e mirë”, shumë e ndryshme nga e ashtuquajtura “E shëndetshmja e bardhë”

Vendi 9. Hapa të mëdhenj përpara janë bërë edhe në modelet matematike për të studiuar masën e neutroneve dhe të protoneve.

Vendi 10. Shkencëtarët nuk kane ngelur prapa as në studimin e geneve që nga mamuthët e deri tek pacientët e prekur nga kanceri. Teknikat janë bërë më të shpejta në krahasim me shume vite më parë.

Shpikjet e pavlefshme të shek. 19 dhe 20

Cili është mekanizmi apo aparati më i pavlefshëm që keni parë, blerë apo ju kanë dhuruar gjatë 12 muajve të fundit? Kjo ishte tema në zemër të konkursit të parë të këtij lloji, “Landfill prize”, i cili tërhoqi me qindra nominime nga e gjithë bota. Ndër krijimet e shumta ishte qeruesja automatike e kastravecit, aromatikët elektrikë dhe një furçë dhëmbësh me një vlerë prej 150 paundësh.

Të gjithë kemi artikuj të tillë të fshehura në ndonjë sirtar, të cilat me siguri s’duhet t’i kishim blerë. E vërteta është se askush s’mund ta përcaktojë me saktësi përkufizimin e saktë të një aparati të vërtetë, diçka që duhet ta keni medoemos, por që nuk ju duhet. Sido që të jetë e vërteta, duhet ta ngushëlloni veten me mendimin se “pajisja mund të kishte qenë edhe më e keqe”, vetëm në rast se nuk keni blerë një prej shpikjeve në listën e artikujve më të pavlefshëm të shekullit të 19-të dhe 20-të. Shokëria konsumatore e ditëve të sotme është jashtëzakonisht e aftë në krijimin e artikujve të pakuptimtë. Që nga epoka viktoriane, mendjet më krijuese të njerëzimit kanë qenë të zënë me përgjigjet e nevojave që s’ekzistonin dhe zgjidhjet janë më të pavolitshme se problemet që premtinin të ndalonin. Për të frymëzuar lexuesit që kanë ndër

mend të shpikin diçka për qejfin e tyre, lexoni listën e shpikjeve më të panevojshme në botë.

Parmendë dhe automatik së bashku, Numri i patentës: 35600, Viti 1862

Në vend që ta ktheni shpatën në plor, pse të mos e kombinoni plorin me një artilleri të mesme? Do të ishte më efikase në vend që të bërtisni “Hiq nga toka ime”. Përdorimi i saj vihet në pikëpyetje, veçanërisht nëse përdoret në lokalitetet kufitare, ku grindjet mes feudalëve dhe guerrilasve janë të zakonshme. Në kohë rreziku mund të përdoret në fushë, e mbushur me fara ose topa.

Pajisja për të zgjuar nga gjumi, Numri i patentës: 256265, Viti 1882

Ndonjëherë alarmi i orës nuk mjafton për të zgjuar gjumashët në orën 12. Prandaj, pse të mos rreshtoni një varg peshash mbi kokën e personit që gërhet dhe me ndihmën e një makineri me kurdisje t’i hidhni mbi kokën e tyre derisa ata të zgjohen? “Kur të bien do të shkaktojnë një tronditje, aq sa mjafton për ta zgjuar, por jo dhe aq të rëndë sa ta lëndojë”, siguron shpikësi.

Presidenti turk Abdullah Gyl viziton Shqipërinë



Presidenti Bamir Topi ftoi kompanitë turke të investojnë në Shqipëri, ashtu sikurse kanë vepruar deri tani me arritje të suksesshme. Topi iu drejtua përfaqësuesve të biznesit turk në forumin e biznesi që u mbajt në Tiranë, ku ishte i pranishëm edhe kreu i shtetit turk, Abdullah Gyl. “E kanë dhënë provën shumë kompani turke, ashtu si kompani të tjera nga vende të tjera. Ne ju ftojmë sërish të vini në Shqipëri, të investoni, duke pasur konfidencën e plotë të komunikimit dhe duke pasur sigurinë”, tha Topi. “Kompanitë turke janë mjaft të pranishme në tregun shqiptar, siç është rasti i telefonisë, i bankave, i prodhimit të hekurit etj. Forume të ngjashme biznesi mes dy vendeve janë zhvilluar çdo vit”, tha presidenti Gyl. Ndërsa ministri i Ekonomisë, Dritan Prifti i ka garantuar firmat turke për mbështetje maksimale, politika probiznes dhe taksa të ulëta. Biznesi turk në Shqipëri operon në fusha të tilla si telekomunikacioni, sistemi bankar, miniera etj., me shifra investimi mbi 1 miliard USD.

Presidenti turk Abdullah Gyl mori pjesë në inaugurimin e punimeve për ndërtimin e kampusit të universitetit turk, “Epoka”. Të ftuar në ceremoninë e djeshme ishin rektori i universitetit, drejtori i përgjithshëm i institucioneve arsimore turke, si dhe Presidenti

turk, Abdullah Gyl. “Falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre në hapjen e kolegjeve turke në Shqipëri. Këto nuk janë shkolla të shtetit turk, por shkolla që populli dhe biznesmenët turq ia kanë dhuruar Shqipërisë”, deklaroi Presidenti turk. Sipas tij, studentët do të jenë ura e përsosmërisë së bashkëpunimit të këtyre dy popujve. Nga ana tjetër, rektori i këtij universiteti, Hasan Kaplan, tha: “Një nga shkaqet kryesore që ndikoi në hapjen e këtij kampusi universitar është miqësia e palëkundur ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë, e cila mbështetet në historinë e përbashkët 500-vjeçare të dy popujve tanë”.

Zvicra thyen parimet të cilat pretendon se i mbron!

Qytetarët e Zvicrës në referendum vendosën të pengojnë ndërtimin e minareve të xhamive në territorin e Zvicrës. Mbi 57 për qind të votuesve dhe 22 nga 26 kantonet e Zvicrës (si njësi federale) mbështetën propozimin për të ndaluar ndërtimin e minareve, që referendumi i jep forcën e një amendamenti kushtetues. Me fjalë të tjera, norma e krijuar nga qytetarët merr karakter obligues. Kjo ngjarje për Zvicrën (dhe Evropën) parashtron dy dilema.

Liria e fesë përfshin në vete më tepër elemente, përveç tjerash edhe ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve fetare dhe kryerjen e ritualeve fetare në këto objekte. Xhamitë (dhe minaret si pjesë përbërëse të tyre) janë padyshim objekte fetare dhe si të tilla gëzojnë mbrojtje nga interference e jashtme.

Po të kthehemi te pengesa për ndërtimin e minareve të xhamive. Së pari duhet të thuhet se rregulla nuk është neutrale por i godet vetëm pjesëtarët e fesë islame; ndalesa ekziston vetëm për minaret e xhamive, por jo edhe për objektet tjera fetare. Për “arsye të paarsyeshme”, Zvicra po shkon shumë larg në kufizimin e lirisë së praktikimit të fesë dhe hyn “de facto” në sferën që në drejtësi quhet diskriminim. Zvicra diskriminon qytetarët e vet mysliman, sepse pengon ndërtimin e objekteve fetare, ndërtim që është pjesë përbërëse e lirisë së besimit. Dhe për këtë nuk ka asnjë arsytim.

Qytetarët zviceran votuan në referendum në frymën e jo tolerancës dhe frikës së paarsyeshme nga minaret e

xhamive. Ato nuk rrezikohen nga ekzistimi i minareve, por thjeshtë minaret ju pengojnë sepse janë pjesë e një kulture tjetër, të cilën ato duket se nuk e njohin mirë.

Qeveria Zvicerane nuk e përkrahte referendumin sepse llogariste që ndalesa e ndërtimit të minareve është në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare të Zvicrës, sidomos me obligimin të respektojë lirinë e fesë dhe praktikimit të saj. Por, tani pas referendumi të suksesshëm, qeveria doemos ta respektojë sepse referendumi ka karakter obligues. Zvicra është shembull shkollor i një shteti ku qytetarët në mënyrë direkte vendosin për çështje me relevancë shoqërore.

Zvicra e ndaloi ndërtimin e minareve. Në këtë formë ajo shkeli obligimet ndërkombëtare të ndërmarra me traktatet që garantojnë liritë dhe të drejtat e

njeriut. Sipas të drejtës ndërkombëtare mbi traktatet, një shtet nuk mund të thirret në të drejtën e brendshme me qëllim që t’ju shmanget obligimeve ndërkombëtare të ndërmarra me traktate. Solucioni juridik për Zvicrën është që të iniciohet procedurë me aplikacion individual përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në procedurë Gjykata do të konstatojë që ndalesa e ndërtimit të minareve cenon lirinë e besimit dhe fesë të garantuar me Konventën Evropiane. Gjykata në vazhdim do të kërkojë nga shteti-palë i Konventës (Zvicra) të bëjë ndryshim të legjislacionit për shkak se ekzistimi i një legjislacioni të tillë është pengesë permanente për gëzimin e lirisë së praktikimit të fesë. Dhe parimi në drejtësi vlen edhe këtu, se kthimi në gjendje të mëparshme është mire të bëhet sa më herët me qëllim që pasojat të jenë sa më të vogla.

